


VEPRA E ZGJEDHUR 6 VEPRA E ZGJEDHUR 6

FRIEDRICH
NIETZSCHE

GJENEALOGJIA
E MORALIT

UEGEN



Titulli në origjinal:
Nietzsche - Genealogie der Moral

© Në shqip, UEGEN

Redaktorë: Xhevair Lleshi
Taulant Hatia

Shtëpia Botuese UEGEN, Tiranë 2011
Design: Studio UEGEN

www.uegen.com

uegen@gmail.com.al
uegen@pronet.com.al

© Shtëpia Botuese UEGEN

ISBN: 978-99956-52-77-7

Friedrich Nietzsche

GJENEALOGJIA E MORALIT

Përktheu:

Armand Dedej
(parathënia, dhe eseja I)

Astrit Cani
*(eseja II, eseja III, shënimet, pasthënia dhe
redaktimi final)*

BIBLIOTEKA "HIVZI SULEJMANI"
PRISHTINË-PRISHTINA

Sektor, dega Y. Kulturave
Nr. 13441-10

SHTËPIA BOTUESE
UEGEN

Parathënie

1.

Ne që kërkojmë njohjen, jemi të panjohur, të panjohur edhe ndaj vetes sonë dhe një gjë e tillë ka arsyet e veta. Kurrë s'e kemi kërkuar veten - e si mund të ndodhte, që një ditë të bukur ta gjenim atë? Me të drejtë kanë thënë: "Aty ku është thesari juaj, është dhe zemra juaj",¹ thesari ynë gjendet aty ku janë zgjojet e njohjes sonë. Prandaj jemi gjithmonë në lëvizje, mu si kafshë të lindura me flatra, si mbledhëse të mjaltit të shpirtit, me synimin e vetëm në zemër: "të çojmë në shtëpi" diçka. Mandej, sa i takon jetës me të ashtuquajturat "përvoja", cili prej nesh ka pasur qoftë dhe vetëm seriozitetin e nevojshëm për to? Ose kohën e nevojshme? Druhem, se lidhur me këto gjëra, kurrë nuk "kemi qenë në brendi" vërtet: në fakt zemra jonë qëndron përtej - po ashtu dhe veshët tanë! Ashtu si dikush, hyjnisht i habitur dhe i kredhur brenda vetes, veshët e të cilit janë trandur nga tingulli i kambanës që me gjithë forcën e saj ka lajmëruar mesditën me dymbëdhjetë goditje, e që zgjohet papritur dhe pyet veten "çfarë qe ky tingull?", kështu pra ne, në një farë mënyre, më pas, fërkojmë veshët të befarsuar e tërë siklet dhe pyesim "çfarë përjetuam vallë në të vërtetë?", ose më tej "cilët jemi ne në të vërtetë?", dhe vetëm më pas i numërojmë, siç edhe u tha, të dymbë-

dhjetë fragmentet e goditjeve të përvojës sonë, të jetës sonë, të të qenit tonë - ajme - dhe ngatërrojmë llogarinë... Në fakt mbetemi medoemos të panjohur ndaj vetes, nuk e kuptojmë veten, duhet të dukemi tjetër nga ç'jemi, për ne vlen në përjetësi shprehja "çdokush është për vetveten gjëja më e largët"²; po të na pyesësh, ne nuk jemi njerëz që "kërkojnë njohjen"...

2.

Mendimet e mia mbi *originën* e paragjytimeve tona morale - me qenë se për këto bëhet fjalë në këtë vepër polemike - janë shprehur për herë të parë, në mënyrë të esëllt e të përkohshme, tek përmbledhja me aforizma që mban titullin *Njerëzor, tepër njerëzor. Një libër për shpirtin të lirë*, hartimi i të cilit do të niste në Sorrento gjatë një dimri kur i lejova vetes pak prehje, siç ndalet për t'u prehur udhëtari, madje edhe për të rrokur me shikim truallin e gjerë e të rrezikshëm që shpirti im kishte përshkuar deri atëbotë. Kjo ndodhi në dimrin e 1876 - 1877-ës; ndërkohë mendimet e shprehura qenë më të hershme. Në thelb ishin po këto mendime të cilave po iu kthehem te këto përsiatje - dhe shpresojmë që periudha e gjatë t'u ketë vyer për mirë, që të jenë bërë më të matura, më të qarta, më kompakte e më të plota. Por *fakti që* unë ende sot e kësaj dite nuk i kam braktisur këto mendime, ndërkohë që ato janë zhvilluar dhe bashkërenduar njëri me tjetrin duke u lidhur gjithmonë e më fort mesveti, e përforcon tek unë besimin se, qysh në krye, ato nuk lindën tek unë në mënyrë të izoluar, arbitrarisht dhe vetiu, por lindën

nga një rrënjë e përbashkët, nga një *vullnet themelor* për njohje, i cili ushtron sundimin e vet në thellësi, që flet në një mënyrë gjithnjë e më të thellë, që mëton gjëra gjithmonë e më të përcaktuara. Në fakt vetëm kjo i ka hije një filozofi. Nuk kemi asnjë të drejtë të jemi të *izolu- ar* kurrfarësoj, nuk na lejohet as të gabojmë as të mbërrijmë tek e vërteta në mënyrë të veçuar. Porse pikërisht me të njëjtën domosdoshmëri që pema jep frytet e veta, rriten tek ne mendimet tona, vlerat tona, *po-të* dhe *jo-të* tona, *nëse-të* dhe *ndoshta-t*, të afërta njëra me tjetrën dhe të gjitha në përkëmbyeshmëri të ndërsjellë, dëshmi të një vullneti, të një shëndeti, të një mbretërie tokësore, të një dielli të vetëm. A iu pëlqejnë vallë këto frytet tona? - E ç' rëndësi ka kjo për pemën! E ç' rëndësi ka kjo *për ne*, për ne filozofët!...

3.

Me një sedër që nuk e rrëfej me dëshirë - siç do të shohim, i referohet *moralit*, gjithçkaje që është brohoritur mbi tokë deri më sot si moral - një sedër që hyri tepër herët në jetën time, krejt e pakërkuar, krejt e papërmbajtshme, po aq në kundërshtim me mjedisin, moshën, shembujt, origjinën, sa gati më jep të drejtën ta quaj si "*a priorinë*" time - kurioziteti im, njëherit me dyshimin tim, u desh të ndalen me kohë mbi çështjen se *çfarë origjine* kanë në të vërtetë *e mira* dhe *e keqja* jonë. Faktikisht problemi i origjinës së të keqes më ka përndjekur qysh trembëdhjetë vjeç: atij dhe i kushtova, në një moshë në të cilën njeriu e ndan zemrën "*mes lodrave fëmijërore dhe Perëndisë*",³ lojën time të parë letrare,

sprovën time të parë të shkrimit filozofik - dhe për sa i përket "zgjidhjes" sime të atëhershme të problemit, siç është logjike, ia lashë atë nder Perëndisë dhe e bëra atin e të keqes. A ishte pikërisht *kjo*, ajo çka kërkonte nga unë "*a prioria*" ime; ajo "*apriori*" e re, imorale, ose të paktën imoraliste, dhe ai *imperativ kategorik* që prej saj fliste, medet, në mënyrë kaq antikantiane, kaq enigmatike, të cilën ndërkohë unë po e dëgjoja gjithnjë e më shumë, madje jo vetëm e dëgjoja?... Fatmirësisht mësova shpejt të dalloj paragjykimin teologjik nga ai moral dhe nuk e kërkova më origjinën e së keqes përtej botës. Pak edukim historik e filologjik dhe më tepër një delikatesë e lindur ndjeshmërie për problemet psikologjike në përgjithësi, e shndërruan rrufeshëm problemin tim në një tjetër: në cilat kushte i ka shpikur njeriu gjykimet mbi vlerën e mirë dhe e keqe(?) dhe ç'vlerë kanë në vetvete? Deri më sot a e kanë penguar apo e kanë ndihmuar mirëqenien e njeriut? A janë shenjat e të gjendurit ngushtë, e varfërimit, degjenerimit të jetës? Apo në të kundërt, tek ato shpërfaqet plotësia, forca, vullneti i jetës, kuraja, siguria, e ardhmja e saj? - Për të gjitha këto pyetje gjeta dhe mora në sy përgjigje të shumta e të ndryshme brenda vetes, dallova epoka, popuj, rangje hierarkike individësh, e specifikova problemin tim; nga përgjigjet lindën pyetje të reja, qëmtime, hamendësime, gjasa: derisa arrita të siguroj një territor timin, një truall vërtet timin, një botë të heshtur që rritet e harliset, e ngjashme me ato kopshtet e fshehta për të cilat askujt nuk i lejohet të ketë dijeni... Oh sa të lumtur jemi ne njerëzit e njohjes, mjaft të dish të heshtësh për tërë kohën e nevojshme!...

4.

Shtysa e parë që më bëri të shpalos disa nga hipotezat e mia mbi *origjinën e moralit*, më erdhi nga një libërth i qartë, i pastër dhe inteligjent, madje edhe pak pedant, në të cilin hasa për herë të parë, në mënyrë të qartë, një tip të kundërt dhe pervers hipotezash gjenealogjike, domethënë tipin *anglez*, që më grishi me atë forcën tërheqëse që ka çdo gjë që është diametralisht e kundërt e anti-etike me idetë e tua vetjake. Libërthi titullohej *Origjina e ndjenjave morale*, autori ishte doktor Paul Ree; viti i botimit 1877. Mund të them se kurrë mbase nuk kam lexuar një gjë që të më ketë ngjallur prirjen për të mohuar çdo fjali, çdo konkluzion, siç më ka ndodhur me këtë libër; e prapë pa më shkaktuar bezdi dhe padurim. Në veprën për të cilën punoja atëherë dhe që e përmenda më sipër, iu referova rastësisht parimeve të këtij libri pa i mohuar këto të fundit - mohimet nuk kanë vend tek unë! - por, siç i ka hije një shpirti pozitiv, duke vënë në vend të së pamundurës diçka më të mundshme dhe, hera-herës, në vend të një gabimi, një gabim tjetër. Asokohe, siç thashë, nxora në dritë për herë të parë, në mënyrë ende të ngathët, këto hipoteza gjenealogjike të cilave u janë dedikuar këto pjesë; këtë mungesë zhdërvjelltësie do të doja t'ia fshihja vetes, një paaftësi që kishte të bënte me mos-pasjen e një gjuhe timen të denjë për këto lloj argumentesh, me kërcitje dhe luhatje të shumta. Le të krahasohen veçanërisht ato që kam thënë rreth prehistorisë së dyfishtë të *së mirës* dhe *së keqes* (domethënë duke u nisur nga sfera e padronëve dhe skllëvërve) tek *Njerëzor tepër*

njerëzor: mbi vlerën dhe origjinën e moralit asketik; ose më tej mbi "etikën e zakoneve", që është ai lloj morali shumë më i lashtë dhe primitiv që largohet *toto coelo** nga kriteri i vlerësimit altruist (në të cilin doktor Ree, ashtu si të gjithë gjenealogjistët e tjerë anglezë të moralit, sheh kriterin e vlerësimit moral *në vetvete*); ose tek *Udhëtari*, tek *Agu i mëngjesit*, mbi origjinën e drejtësisë si marrëveshje ndërmjet atyre që kanë fuqi pothuajse të barabartë (baraspeshë që presupozon çdo pakt dhe po kështu çdo të drejtë), dhe më tej mbi origjinën e dënimit tek *Udhëtari*, qëllimi frenues i të cilit nuk është as thelbësor as zanafillor (siç beson doktor Ree - ai është më tepër i induktuar, në rrethana të caktuara, gjithmonë si diçka anësore, si shtojcë).

5.

Në thelb, pikërisht atëherë kisha për zemër diçka shumë më të rëndësishme se një bashke hipotezash të mijat apo edhe të të tjerëve rreth origjinës së moralit (ose, për ta saktësuar, çështjen e origjinës së moralit e shihja jo si qëllim në vetvete, por si një mjet për të mbërritur diku tjetër). Për mua bëhej fjalë për *vlerën* e moralit, madje lidhur me të mund të krahasohesha thujse vetëm me mjeshtrin tim të madh Shopenhauer, të cilit i referohej ai libër me gjithë pasionin dhe kontradiktën e fshehtë që përmbante (në fakt edhe ai libër është një "vepër polemike"). Bëhej fjalë në mënyrë të veçantë për vlerën e "jo-egoistes", për instinktin e mëshirës, vetëmohimit

* Lat: aq larg sa qielli, shumë larg

dhe vetëflijimit, të cilat pikërisht Shopenhaueri i kishte veshur me ar, si dhe i pat hyjnizuar, duke i tejbartur në të pëртеjbotshmen deri në atë pikë sa i mbetën si të vetmet “vlera në vetvete”, mbi bazën e të cilave ai përfundoi duke i thënë jo jetës dhe vetes. Por shí kundër këtyre instinkteve u shfaq tek unë një mosbesim gjithnjë e më radikal, një skepticizëm që gërmonte gjithnjë e më në thellësi! Bash aty e shihja rrezikun e *madh* të njerëzimit, tundimin dhe joshjen e tij më sublime – ndaj çfarë gjëje fundja (?) ndaj hiçit? – pikërisht këtu shihja fillimin e fundit, ndalimin, lodhjen që i kthen sytë mbrapa – vullnetin që kthehet kundër jetës, sëmundjen e sprasme që shpallet në një melankoli të ëmbël: pashë në moralin e mëshirës që përparonte gjithnjë e më shumë, e që prekte dhe filozofët duke i sëmurur, simptomën më të mbrapshtë të kulturës sonë evropiane, që u bë dhe vetë e mbrapshtë, pelegrinazhin e saj të rrëpirët drejt një budizmi të ri, një budizmi evropian: pra ... nihilizmit? Kjo përzgjedhje e ky mbivlerësim modern i mëshirës nga ana e filozofëve është në të vërtetë diçka e re: se bash lidhur me *mungesën e vlerës* së mëshirës filozofët qenë pajtuar deri më sot. Mjafton të përmendim për këtë Platonin, Spinozën, La Roshëfukonë dhe Kantin, katër shpirtra këta, tepër të ndryshëm nga njëri-tjetri, por të ngjashëm në një gjë: në përçmimin e mëshirës.

6.

Ky problem i *vlerës* së mëshirës dhe i moralit të mëshirës (unë jam kundërshtar i zbutjes skandaloze moderne të ndjenjave), duket pikësëpari si një dukuri e izoluar, si

një çështje më vete, por atij që do ndalet dhe do *më-sojë* të shtrojë pyetje mbi të, siç më ka ndodhur mua, do t'i hapet para syve një horizont i ri i pakufishëm. Një mundësi do ta mbërthejë si një marramendje dhe do të dalë në dritë çdo lloj mosbesimi, dyshimi e frike. Besimi te morali, te çdo lloj morali, do të lëkundet dhe së fundi do t'i bëhet e ndjeshme një nevojë të re. Le ta shpallim këtë *nevojë të re*: kemi nevojë për një *kritikë të vlerave morale, të fillojmë të trajtojmë më në fund pikërisht vlerën e këtyre vlerave*, madje për këtë punë kemi nevojë të njohim kushtet dhe rrethanat prej të cilave ato janë prodhuar, zhvilluar dhe modifikuar (moralit si pasojë, simptomë, maskë, tartufizëm, sëmundje, keqkuptim; por edhe morali si shkak, si kurë, si *stimulans*, si mpirës, helm), pasi kjo njohje nuk ka ekzistuar deri më sot, por as nuk është dëshiruar. *Vlera e këtyre "vlerave"* është pranuar si e mirëqenë, si diçka faktike, përtej çdo diskutimi; deri më sot askush nuk ka ngurruar as dyshuar minimalisht në përcaktimin e një vlere më të madhe "të mirit" se sa "të ligut", vlerë më të madhe në kuptimin e përparimit, të dobishmërisë, të një begatie në lidhje me njeriun në përgjithësi (përfshi këtu edhe të ardhmen e njeriut). Po sikur e kundërta të ishte e vërtetë? Po sikur tek "e mira" të ishte rrënjosur një simptomë regresi, ose një rrezik, një joshje, një helm, një *narcotium*, përmes së cilës e tashmja të jetonte *në kurriz të së ardhmes*? Ndosh-ta me më shumë nge, me më pak rrezik, por edhe me stil dhe me thellësi më të ulët?... Kësodore morali qenka fajtori për faktin që nuk është arritur kurrë një *fuqi e madhësliti e mundshme* e llojit njeri? Kësodore morali qenka rreziku i rreziqeve?...

7.

Ja pra, pasi m'u hap ky horizont, pata arsye të mjaftueshme për të kërkuar rreth meje (çka ende vazhdoj ta bëj) shokë të ditur, të guximshëm dhe punëdashës. Duhet përshkuar territori i largët, i paanë dhe tepër i fshehtë i moralit – i moralit që ka ekzistuar dhe është përjetuar realisht – me pyetje të reja si të ishin sy të ri: a nuk domethënë kjo pikërisht *zbulimin* e këtij territori për herë të parë?... Në qoftë se këtu kam menduar për të lartpërmendurin doktor Ree, këtë e kam bërë ngaqë nuk dyshoja se ai do të mbërrinte i shtyrë nga natyra e vetë problemeve të tij te një metodologji më e saktë për të gjetur disa përgjigje. Më gënjeu mendja vallë? Dëshira ime ishte gjithsesi që t'i jepja me çdo kusht një drejtim më të mirë një këndvështrimi të mprehtë dhe të drejtë, domethënë ta adresoja drejt *historisë së vërtetë të moralit*, kundër një sërë hipotezash angleze të ndërtruara mbi *ré*. Sigurisht që gjithkush mund ta ketë të qartë se ekzistojnë ngjyra njëqind herë më të rëndësishme se e bardha e reve për gjenealogjistin e moralit: në krye të herës *grija*. Kur them këtë, e kam fjalën për fakte autentike të mbështetura në prova dhe që kanë ekzistuar realisht, ose e thënë shkurt, e kam fjalën për tërësinë e hieroglifëve (që është e vështirë të deshifrohen) me të cilat është shkruar historia e shkuar e moralit njerëzor. Kjo tërësi hieroglifesh mbeti e panjohur për Dr. Reenë, por ai kishte lexuar Darwinin - dhe kështu që në filozofinë e tij shtaza darviniane dhe qenia morale modeste që "nuk kafshon më", i japin dorën njëri-tjetrit gjithë

edukatë, me një shprehi mirësjelljeje dhe një plogështi të lehtë, e përzier kjo më një grimë pesimizmi dhe lodhjeje në fytyrë, thua sikur të mos ia vlente të merreshin seriozisht të gjitha këto gjëra, domethënë problemet e moralit. Në të kundërt, unë mendoj se nuk ka asgjë tjetër që ia *vlen* të merret kaq seriozisht sa problemet e moralit; e sigurisht akoma më mirë do të ishte sikur të vinte ndonjëherë dita që ato të merreshin në mënyrë *lojcake*. Në fakt të qenit lojcak, ose e thënë me gjuhën time, kjo *dije gazmore*, është një shpërblim për një seriozitet të gjatë, të nëndheshëm e të zellshëm, që normalisht nuk është diçka që e merr përsipër kushdo. Por në ditën që ne do të themi me gjithë zemër “Hajt, edhe morali ynë i vjetër është tashmë material *për komedi!*”, ne do të kemi zbuluar një intrigë të re dhe një mundësi të re për dramën dionisiake të titulluar “Fati i shpirtit” – dhe ai do ta shfrytëzojë më së miri, ai komediografi i madh antik e i amshuar i ekzistencës sonë!...

8.

Në qoftë se ky shkrim do të jetë i pakuptueshëm dhe do t’ia vrasë veshin ndokujt, nuk besoj se më duhet vënë medoemos faji mua. Ky shkrim është mjaft i qartë, me kusht që lexuesi i kësaj vepre të ketë lexuar edhe veprat e mia të mëparshme, jo pa mund, pasi thelbi i të tyre nuk është i lehtë për t’u rrokur. Le të marrim për shembull *Zarathustrën*; nuk mund të quhet njohësi i atij libri ai që nuk është herë lënduar dhe herë ngazëllyer thellësisht nga fjalët që janë shkruar aty; vetëm kështu ai do të ketë privilegjin të marrë pjesë në elementin këndellës prej të

cilit ka lindur ajo vepër, të marrë pjesë në kthjelltësinë e saj diellore, në largësinë e saj, në gjerësinë dhe sigurinë e saj. Në raste të tjera paraqet vështirësi forma aforistike e të shprehurit, pikërisht se sot kësaj forme *nuk* i jepet *rëndësia e duhur*. Një aforizëm, të modeluar dhe të prerë mirë, nuk do të thotë se mjafton ta lexosh dhe e ke “deshifruar”; por qysh kur e lexon gjëja e parë që kërkohet është *interpretimi*, gjë për të cilën nevojitet një art i interpretimit. Pjesa e tretë e këtij libri përmban një shembull të asaj që unë e quaj “interpretim”: kësaj pjese i paraprin një aforizëm dhe vetë pjesa është komenti i këtij aforizmi. Pa dyshim, për të ushtruar kësisoj leximin si *art*, nevojitet mbi të gjitha një *veti*, që në ditë të sodit është harruar krejtësisht – çka është dhe arsyeja kryesore pse duhet ende kohë të vijë dita që shkrimet e mia të bëhen të lexueshme – një veti për ta ushtruar të cilën nevojitet thujse të jesh një lopë, dhe *kurrsesi* “njeri modern” - dhe pikërisht vetia e *ripërtypjes...Sils-Maria, Engadina e Sipërme*
Korrik 1887

ESEJA E PARË

“E MIRË DHE E LIGË”, “E MIRË DHE E KEQE”

1.

Psikologët anglezë, të cilët deri më sot janë të vetmit që duhen falënderuar për të vetmet përpjekje, për t’i dhënë jetë një historie të origjinës së moralit - mbartin një enigmë jo të vogël në lidhje personalitetin e tyre; për të qenë të sinqertë, si enigma të gjalla që janë, ata kanë një avantazh kundrejt librave të tyre – *ata edhe si njerëz janë interesantë!* Po çfarë duan në fund fare këta psikologët anglezë? Ne gjithmonë i gjejmë të angazhuar me hir a me pahir në të njëjtën detyrë, në detyrën e nxjerrjes në pah të *partie honteuse** të botës sonë të brendshme dhe i gjejmë duke kërkuar për parime të frytshme, normative dhe të zhvilluese, pikërisht aty ku vetërespekti intelektual i njeriut kurrë nuk do donte t’i gjente (për shembull, tek *vis inertiae*** të zakonit, ose tek *mos-mba-mendja*, ose tek hallkëzimi dhe mekanika e verbër dhe rastësore e ideve, ose tek ndonjë faktor tërësisht pasiv, reflektiv, molekular, a thelbësisht budalla). Cila është fuqia e vërtetë motivuese që i shtyn këta psikologë pikërisht në këtë drejtim? A mund të jetë vallë një instinkt për denigrimin njerëzor, diçka ogurzezë, vulgare dhe e mbrapshtë, a ndoshta diçka që s’e pranojnë as vetë? Ose ndoshta njëfarë dyshimi pesimist, një mosbe-

sim idealistësh të zhgënjyer, të cilët janë bërë të trishtë, të helmuar, dhe të vretë? Ose një armiqësi dhe mëri e vogël e pavetëdijshme kundër Krishterimit (dhe Platonit), që në mënyrë të kuptueshme nuk e ka kapërcyer pragun e ndërjegjes? Ose thjesht një shije libidinoze e së çuditshmes, e asaj çka është paradoksale deri në dhimbje, e asaj çka është problematike dhe absurde tek ekzistenca? Ose, për ta mbyllur, një grimë nga secili prej këtyre motiveve – një fije vulgaritet, një fije anti-krishterim, një fije nevojë gudulisëse për ngacmim?...

Por me sa më thonë, na qenkan thjesht ca bretkosa gjakftohte, ngordhalaqe dhe të mërzitshme që zvarriten e hidhen përpjetë përreth njerëzve dhe brenda njerëzve, sikur të ishin në habitatin e tyre, njëlloj si në *moçal*.

Këto i dëgjoj me ndot dhe, për më tepër, as që i besoj; dhe nëse lejohet të dëshirosh kur e ke të pamundur të njohësh, uroj nga zemra që të jetë e kundërta - që këta hulumtues e mikroskopistë të shpirtit të jenë si përfundim, kafshë të guximshme, zemërgjera dhe eprane, që dinë si të zotërojnë edhe zemrën edhe zgjuarsinë e tyre, madje që e kanë stërvitur veten sidomos të flijoj-në gjithçka që është ideale në favor të asaj që është e vërtetë, në favor të *çdo* të vërtete, edhe ndaj asaj më të thjeshtës, të hidhurës, të shëmtuarës, të neveritshmes, jo të krishterës dhe imorales... Pasi ekzistojnë edhe nga këto lloje të vërtetash. -

2.

Gjithë nderimi ynë u shkon shpirttrave fisnikë, të cilët mund të mbizotërojnë te këta historianë të moralit.

Sidoqoftë është e sigurt, për fat të keq, se ata vuajnë pikërisht nga *demoni historik* dhe janë lënë në baltë shi nga të gjithë demonët e historisë. Të gjithë këta, si është sifati i vjetër i filozofëve, mendojnë në mënyrë *thelbësisht* antihistorike; kjo është më se e sigurt. Qysh në krye të herës del në pah karakteri i palatuar dhe kollajzia e gjenealogjisë së tyre të moralit, sidomos ku bëhet fjalë për të përcaktuar origjinën e konceptit dhe të gjykimit të "së mirës". "Në zanafillë - pohon mendësia e tyre - u lëvduan dhe u quajtën të mira disa veprime jo egoiste, nga ana e atyre kundrejt të cilëve kryheshin, domethënë për të cilët këto veprime ishin të *dobishme*: më vonë kjo origjinë e lavdërimit ra në *harresë* dhe veprimet jo egoiste që, për forcë *zakoni*, konsideroheshin gjithmonë si të mira, filluan të përjetoheshin sikur të ishin të mira në vetvete." Përmjeherësh vihet re se ky deduksion i parë i përmban sakaq të gjitha tiparet karakteristike dhe idiosinkratike të psikologëve anglezë - këtu kemi "dobishmërinë", "harresën", "zakonin" dhe së fundi "gabimin", ku të gjitha të vëna në bazë të një vlerësimi, për të cilin njeriu superior është ndjerë e pran, si me njëfarë privilegji të njeriut në përgjithësi. Kjo krenari u *dashka* poshtëruar, ky sistem vlerash u *dashka* zhvlerësuar; vallë kemi mbërritur deri në këtë pikë?

Argumenti i parë që më vjen tani në mend, është se kjo pikëpamje e vendos konceptin e të mirës në vend të gabuar: gjykimi "e mirë" nuk buron prej atyre të cilëve u jepet një provë "mirësie". E vërteta është se kanë qenë vetë të mirët, aristokratët, të fuqishmit, superiorët, ata që e ndjenë veten të mirë dhe që si të tilla (të mira) i përjetuan dhe veprimet e tyre, pra të dorës

së parë, në kundërshtim me çdo gjë të pafisme, vulgare dhe plebeje. Duke u nisur nga ky *pathos i distancës* ata të parët i dhanë vetes të drejtën për të krijuar vlera dhe për të sendërgjuar emërtimin e vlerave: për dobishmërinë as që donin t'ia dinin! Pikëpamja e dobishmërisë është maksimalisht e huaj dhe e dështuar, kur kemi të bëjmë me këtë farkëtim në të nxehtë të vlerave supreme, të cilat krijojnë dhe strukturojnë hierarkinë e tyre të brendshme. Shpërthim vullkanik i tyre na bën të kuptojmë, se ai ka kapërcyer çdo temperaturë të ulët që shënojnë kalkulimet utilitare dhe ky nuk është thjesht një rast i përkohshëm, por diçka e përherëshme. Siç e thashë dhe më lart, është *pathosi* i aristokracisë dhe distancës, ndjenja jetëgjatë dhe mbizotëruese themelore dhe totale e një skote eprane hegjemone ndaj një "poshtëranie" - kjo është origjina e antitezës mes të mirës dhe të keqes. (E drejta aristokrate për të vënë emra shtrihet aq larg sa që mund t'ia lejojmë vetes ta konceptojmë vetë origjinën e gjuhës si shprehje e fuqisë së atyre që ushtrojnë sundimin: janë ata që thonë "kjo është kështu dhe ashtu", dhe që me anë të një fjale i vënë vulën e tyre një gjëje apo një ngjarjeje, dhe përmes kësaj e bëjnë atë gjë të vetën). Është pikërisht kjo arsyeja pse fjala "e mirë" nuk ka aspak *medoemos* lidhje me veprimet "jo egoiste": siç mëtojnë në mënyrë besëtyte këta gjenealogjistë të moralit. Në të kundërt ndodh që vetëm me vlerëdhënien aristokratike, është imponuar gjithnjë e më fort, në ndërgjegjen njerëzore, kjo antitezë totale ndërmjet "egoistes" dhe "jo egoistes" - e thënë me gjuhën time, ajo çka gjen shprehjen e vet në shumë mënyra tek kjo antitezë, është *instinkti i kopësë*.

Dhe prapë duhet goxhà kohë që ky instinkt të bëhet dominues në atë masë sa që dhe sistemi i vlerave të varet së brendshmi prej kësaj antiteze (si në rastin e Evropës së sotme): në ditët e sotme, paragjykimi se “moralit”, “jo egoistja” dhe “désintéressé”* janë koncepte ekuivalente, mbizotëron me forcën e një “ideje fikse”, e cila të jep përshtypjen e një sëmundjeje mendore.

3.

Së dyti, përpos faktit se kjo hipotezë mbi origjinën e vlerësimit si “e mirë” nuk qëndron historikisht, ajo bie vetë viktimë e një kontradikte të karakterit psikologjik. Nëse dobia e veprimit jo egoist qenka origjina e vlerësimit të tij dhe kjo origjinë paska rënë në *harresë* - atëherë si është e *mundur* një *harresë* e tillë? Mos ka ndodhur që dobishmëria e këtyre veprimeve një ditë të bukur ka pushuar së qeni e tillë? Në fakt, e vërtetë është e kundërta: kjo dobishmëri ka qenë diçka e përvojës së përditshme dhe si e tillë e theksuar vazhdimisht; prandaj, në vend që të qërohej nga ndërgjegjja, në vend që të bëhej e harrueshme, ajo është ngulitur në ndërgjegje gjithnjë e më qartazi. Dhe sa më e logjikshme teoria e kundërt (pa qenë, për këtë arsye, më e vërtetë-), që mbrohet për shembull nga Herbert Spenseri, i cili vendos analogjinë thelbësore të konceptit të “së mirës” me atë të “së dobishmes” e “të funksionale”, ku në gjykimet “e mirë” dhe “e keqe” njerëzimi thjesht përmbledh dhe pohon pikërisht përvojat e tij të *paharruara*

* Fr.: e çinteresuar.

dhe të *paharrueshme* që kanë të bëjnë me “e dobishme - funksionale” dhe “e dëmshme - jo funksionale”. Sipas kësaj teorie, “e mira” është ajo që ka rezultuar e dobishme prej kohësh që s’mbahen mend: për këtë arsye ajo mund të pretendojë të vlejë si “e çmueshme në shkallën më të lartë”, “e çmueshme në vetvete”. Edhe kjo metodë shpjegimi është gjithaq e gabuar, por vetë shpjegimi në fjalë është të paktën koherent dhe ka baza psikologjike.

4.

Treguesi i parë që më çoi drejt rrugës së *duhur* ishte pyetja se cili është kuptimi etimologjik i vërtetë i idesë së “të mirës”, e cila ka pothuajse të njëjtin kallëp në gjuhë të ndryshme? Më tej zbulova se të gjitha ato të çonin tek një *metamorfozë konceptuale identike* – se gjithandej “aristokratja”, “fisnikja” (në kuptimin e rangut shoqëror), përbën themelin e idesë “e mirë” prej të cilave rrjedh domosdoshmërisht kjo e fundit, në formën e “shpirtit aristokrat”, “fisnik”, në formën e “shpirtit të nivelit të lartë”, e “shpirtit të privilegjuar” - një zhvillim ky që ecën paralel me evolucionin përmes të cilit “vulgarja”, “plebeja”, “e ulëta”, shndërrohen në “e keqe”. Shembulli më i qartë lidhur me transformimin e fundit është fjala gjermane “schlecht” [e keqe], identike me “schlicht” [e thjeshtë] – le të krahasohen edhe me “schlechtweg” [thjesht], “schlechterdings” [thjeshtësisht] – e cila në origjinë të saj nënkuptonte njeriun e zakonshëm e të thjeshtë, në antitezë me njeriun e fisëm. Kjo do të ndryshonte gjatë periudhës së Luftës tridhjetëvjeçare,

domethënë tepër vonë, duke marrë kështu kuptimin që ka dhe sot e kësaj dite. Nga pikëpamja e gjenealogjisë së moralit ky zbulim rezulton të jetë *thelbësor*: shkaku pse është arritur kaq vonë në një përfundim të tillë, është ndikimi frenues që ka pësuar bota moderne prej paragjykimeve demokratike lidhur me çështjen e origjinës. Një ndikim i tillë është shtrirë edhe në territorin, në dukje më objektiv, të shkencave të natyrës dhe fiziologjisë, siç do ta prek shkurt këtu. Katrahura e këtij keqkuptimi të shkaktuar prej paragjykimit (i cili ka shkuar deri në atë pikë sa ka prodhuar edhe urrej-tje), veçanërisht në etikë dhe histori, është e qartë tek rasti famëkeq i Baklit,⁴ tek i cili *plebeizmi* i shpirtit modern, që ka origjinë angleze, shpërtheu përsëri në gjirin e atdheut të tij me arrogancën e një vullkani llumrash të retorikës boshe, të padurueshme dhe vulgare, me të cilën kanë folur deri më sot të gjitha vullkanet.

5.

Në lidhje me problemin *tonë*, që me të drejtë mund të konsiderohet si një problem *i heshtur*, dhe që është i kapshëm vetëm nga pak veshë, është me interes të pohojmë se në ato fjalë dhe rrënjë që nënkuptojnë vlerën “e mirë” ne vëmë re, qoftë dhe në mënyrë të sfumuar, fuqinë që i jep të drejtën aristokratëve për ta konsideruar veten qenie të një rangu më të lartë se pjesa tjetër. Është e vërtetë se në pjesën më të madhe të rasteve të tyre ata e përkufizojnë veten me terma që rrjedhin nga superioriteti i tyre në fuqi (si “të fuqishmit”, “heronjtë”, “udhëheqësit”), ose duke u bazuar në treguesit më të

dukshëm të këtij superioriteti, si për shembull, "të pasurit", apo "zotëruesit" (ky është dhe kuptimi i *arya*; që në mënyrë analoge gjendet ne gjuhën iraniane dhe atë sllave). Por gjithashtu ata e përkufizojnë veten edhe në bazë të një *tipari idiosinkratic*, dhe është pikërisht ky i fundit ai që na intereson. Ata e quajnë veten, për shembull, "pohuesit e të vërtetës"; forma e parë e një gjëje të tillë është aristokracia greke, zëdhënës i së cilës ishte Theognidi, poeti nga Megara. Fjala *εσθλοζ* që përdorej për të treguar atë që thamë më lart, nënkupton, sipas rrënjës së saj, dikë që është, që ka realitet, që është real, që është i vërtetë; dhe më pas, me një nënrendim subjektiv "të vërtetën" si predikat: në këtë stad të evoluimit të kësaj ideje kjo fjalë bëhet motoja dhe parulla e aristokracisë dhe kalon plotësisht në kuptimin e "faristokracisë" si dallim nga njeriu i zakonshëm, nga *gënjeshitari*, siç e konsideron atë Theognidi; derisa në fund termi në fjalë, me rënien e fisnikërisë, mbetet vetëm për të shënjuar fisnikërinë e shpirtit dhe vjen e maturohet duke u ëmbëlsuar simethënë. Në fjalën *κακός* ashtu si tek fjala *δειλός* (plebejania në të kundërt me *ἀγαθός*) nënkuptohej vitaliteti, dhe kjo mund të sugjerojë se në çfarë drejtimi duhet kërkuar origjina etimologjike e një termi që ka pasur shumë interpretime, termi *ἀγαθός*. Tek *malus* e latinëve (të cilën unë e vendos përkrah *μέλας*) mund të përfaqësohej njeriu i zakonshëm, një individ me ngjyrë të errët, veçanërisht me flokë të zinj ("hic niger est")*, aborigjeni paraarian banues i territorit italian që dallohej shumë qartë për shkak të ngjyrës

* Lat: ky është i zi.

së tij prej racës bionde tashmë në pushtet, domethënë prej racës së pushtuesve arianë; pak a shumë të njëjtën gjë më ka bërë të mendoj dhe rasti i galëve - *fin* (për shembull në emrin *Fin-Gal*), term ky që emërtonte aristokracinë dhe së fundi të mirën, fisniken, të kulluarën, por në origjinë të tij presupozonte njeriun biond të dallueshëm prej aborigjenit flokëzi. E thënë paraprakisht, keltët ishin padyshim një racë bionde; dhe është e gabuar të lidhen ato breza të një popullsie thelbësisht flokëzezë që vihen re në hartat më të përpunuara etnografike të Gjermanisë, me një origjinë kelte ose me një kryqëzim me gjakun kelt, siç vazhdon të bëj ende Virhovi; në ato zona ajo që ka qenë dominuese është popullsia *paraariane* e Gjermanisë. (E njëjta gjë vlen në thelb për të gjithë Evropën: në fakt, subjekti racë së fundmi ka dalë në plan të parë, në ngjyrën dhe formën e kafkës dhe ndoshta edhe në cilësitë intelektuale dhe sociale; kush na garanton se demokracia moderne, një lloj anarkie më moderne që është në të vërtetë një prirje drejt të "*zakonshmes*", formës më primitive të shoqërisë që e gjejmë tashmë në mënyrë të përbashkët tek të gjithë socialistët e Evropës, nuk është në thelb veçse një rikthim i tmerrshëm mbrapa dhe që për shkak të kësaj raca e *padronëve*, raca ariane, nuk po bëhet gjithashtu psikologjikisht më inferiore?) Besoj se mund ta interpretoj fjalën latine *bonus* si "*luftëtar*"; hipoteza ime është se nuk gaboj nëse e derivoj *bonus* nga forma më e vjetër *duonus* (krahaso *bellum-duellum* = *duen* - *lum*, në të cilën më rezulton të përmbahet fjala *duonus*). *Bonus* si një njeri i mospajtimit, i dallimit (*duo*), si një luftëtar; kështu pra shihet se çfarë nënkuptonte "e mira" për

njeriun e Romës së lashtë. A nuk nënkupton dhe fjala jonë e gjermanishtes së sotshme *gut* "hyjnoren, njeriun e një race hyjnore"? Dhe identifikimi i gjermanit tonë me emrin e popullit të cilit i përket, atë të "gotëve", a nuk dëshmon prejardhjen e tij hyjnore? *Fillet* e një supozimi të tillë nuk i përkasin kësaj vepre.

6.

Para së gjithash, nuk ka përjashtime (megjithëse ekzistojnë mundësitë për përjashtime), ndaj rregullit se ideja e epërsisë politike kalon në një ide epërsie psikologjike, edhe në ato raste kur kasta e lartë është një kastë *priftërore*, dhe në përputhje me karakteristikat e saj të përgjithshme i akordon vetes privilegjin e një titulli që të kujton funksionin e saj priftëror. Dhe ja që na del përpara, për herë të parë, në kuptimi "e pastër" dhe "e papastër" si shenjë e diferencimit klasor: përsëri në këtë rast zhvillohet një "e mirë" dhe një "e keqe", në një kuptim i cili pushon së qeni thjeshtë social. Për më tepër, duhet bërë kujdes që mos merren shumë seriozisht konceptet e "së dëlirës" dhe të "së padëlirës", apo të merren shumë gjerësisht, apo me karakter shumë simbolik: përkundër kësaj prirjeje, të gjitha konceptet e njeriut antik kuptoheshin prej tij në trajtën e tyre parake, në një kuptim i cili ishte i ashpër, i trashë, fizik dhe i ngushtë, e mbi të gjitha jo simbolik. "Njeriu i pastër" është në thelb veçse një njeri që lahet, që nuk përdor ushqime që mund të shkaktojnë sëmundje të ndryshme të lëkurës, që nuk fle me gra të papastra të shoqërisë së ulët, që ka

tmerr nga gjaku – e asgjë më shumë se kaq! Nga ana tjetër, është pa mëdyshje e qartë, nga krejt tipi i një aristokracie priftërore, arsyeja përse kundërshtitë në vlerësim mundën të merrnin pikërisht këtu një trajtë dhe intensitet të rrezikshëm; faktikisht përmes këtyre kundërshtive janë hapur përfund hone të tilla sa as edhe një Akil i i mendimit të lirë nuk do t’i kapërcente pa u ngjethur. Ka diçka të *pashëndetshme* në këto aristokraci priftërore e në zakonet që mbizotërojnë në shoqëri të tilla, zakone që duke qenë kundër veprimit, formojnë konstruksione *introspeksioni* dhe *emotionalizmi* shpërthyes, si rezultat i të cilave shfaqen sëmundja introspektive dhe nevrastenia, e cila është karakteristike tipike e priftërinjve të të gjithë tipave; po ashtu edhe për ilaçin që kanë shpikur ata vetë për këtë sëmundje – filozofit nuk i ngelet gjë tjetër veçse të tregojë që ky ilaç ka rezultuar të jetë njëqind herë më i rrezikshëm se sëmundja, prej të cilës ai presupozohet të shëronte. Vetë njerëzimi është ende i prekur nga këto naivitete kuruese priftërore! Për shembull, le të marrim disa lloje dietash (kreshma), agjërimi, dëlirësia seksuale, ikja “në shkretëtirë” (izolimi i tipit *Uajr Miçell*⁵, megjithëse sigurisht pa një sistem të ushqyeri të bollshëm që përbën kundërhelmin më të mirë ndaj histerisë së idealit asketik); dhe e gjithë metafizika e priftërinjve, me luftën e saj kundër shqisave, ligështimin e saj; me atë autohipnozën e tyre si fakirë e brahmanë (brahman, e përdorur në kuptimin e sferës së kristalit dhe idesë fikse), veljen e përgjithshme që për pasojë vjen në mënyrë të natyrshme, me atë kurën e vet radikale, *hiçin* (ose, e thënë ndryshe, Zoti

– aspirata për një *unio mystica** me Zotin dhe aspirata e budistëve kah hiçi, Nirvana, dhe asgjë më tepër!). Ndër priftërinj gjithçka bëhet më e rrezikshme, dhe jo vetëm mjetet terapeutike e ilaçet, por gjithashtu edhe krenaria, hakmarrja, dinakëria, ekzaltimi, dashuria, ambicia, virtyti, sëmundja; – mund të shtojmë po ashtu, dhe jo pa njëfarë paanësie se vetëm në truallin e kësaj forme njerëzore të ekzistencës, *thelbësisht të rrezikshme*, pra në formën priftërore, njeriu është bërë në përgjithësi një *kafshë interesante*, dhe vetëm këtu shpirti njerëzor ka fituar *thellësi* të nivelit më të lartë dhe është bërë i *keq* – dhe janë pikërisht këto dy format themelore të epërsisë që ka pasur deri më sot njeriu ndaj kafshëve të tjera!...

7.

Lexuesi duhet ta ketë pikasur me sa lehtësi mund të diferencohen kriteret e vlerësimit të priftërinjve nga ato kalorësiako-aristokrate, e të zhvillohen më tej sa të bëhen e kundërta e tyre; kësaj kundërshtie do t'i jepet një nxitje e veçantë, në çdo rasti kur kasta e priftërinjve dhe ajo e luftëtarëve të hyjnë në kundërshti me njëra-tjetrën për arsye xhelozie pa rënë dakord mbi vlerësimin. Vlerat kalorësiako-aristokrate nënkuptojnë një konstitucion fizik të fuqishëm, një shëndet të lulëzuar, të pasur, shkumëzues deri në atë pikë sa të vërshojë, dhe bashkë me të, atë që e kushtëzon ruajtjen e tij, pra luftën, aventurën, gjahun, kërcimin, udhëtimin – në fakt, gjithçka që thërret të vepruarin e fortë, të liri dhe

* Lat.: bashkim i mistik.

plot shend. Mënyra e të vlerësuarit e aristokracisë priftërore – siç e kemi thënë – bazohet mbi premisa të tjera: për këtë klasë është keq puna kur bëhet fjalë për luftë! Priftërinjtë janë, dhe kjo është e kuptueshme, *armiqtë më të këqij*. Pse? Sepse ata janë më të dobëtit. Kjo dobësi e tyre shkakton një urrejtje që përhapet deri sa merr përmasa të përbindshme dhe të djallëzore, më dituraket dhe më të helmatisura që mund të ekzistojnë. Priftërinjtë kanë qenë urryesit më të mëdhenj të historisë botërore – përballë me gjeninë e hakmarrjes priftërore, zor se mund vihet në krahasim ndonjë lloj tjetër gjenie. Historia njerëzore do të kishte qenë tepër e trashë pa gjeninë që kanë futur brenda saj të dobëtit – për të kuptuar këtë le të marrim shembullin më të përkryer. Asnjë prej gjithë përpjekjeve të tjera kundër “aristokratëve”, “të fortëve”, “padronëve”, “mbajtësve të pushtetit”, nuk mund të krahasohet me atë që kanë bërë kundër kësaj klase çifutët – çifutët, ky komb priftëror të cilët kuptuan se metoda më e mirë e mundshme kundër armiqve dhe tiranëve të tyre ishte padyshim një përmbysje rrënjësore në matjen e vlerave, që ishte njëkohësisht akti *më gjenial i hakmarrjes*. Kjo metodë ishte e përshtatshme vetëm për një popull priftërinjsh, popullit me një etje priftërore për hakmarrje. Ishin çifutët, që në kundërshtim me ekuacionin aristokrat (e mirë = aristokrate = e fuqishme = e bukur = e gëzueshme = që e duan zotat), guxoi me një logjikë të tmerrshme të sugjeronte ekuacionin e kundërt, dhe të mbante të shtrënguar ndër dhëmbë urrejtjen më të thellë (urrejtjen e të dobëtëve); ky ekuacion i kundërt, i quajtur, “vetëm

të mjerët janë të mirë"; të varfrit, të dobëtit, të ulëtit, pra vetëm këta janë të mirë; vetëm të vuajturit, të sëmurët, të neveritshmit janë të respektuar, të vetmit që janë të bekuar, që vetëm për ata është shpëtimi – por ju, nga ana tjetër, ju aristokratët, ju njerëzit e fuqishëm, ju jeni përjetësisht vetë e keqja, e tmerrshmja, të korrumpuarit, të pangopurit, të këqijtë; ju do të jeni gjithashtu përjetësisht të nëmur, të mallkuar!... Ne e dimë se kush e trashëgoi këtë përmbysje çifute të vlerave... Lidhur me këtë nismë fatale të përbindshme që çifutët e shndërruan në deklaratën më të përbindshme të luftës, më kujtohet një pasazh që e kam shkruar diku tjetër (*Përtej të mirës dhe të keqes*) – se bash me çifutët pra do të fillonte *revolta e skllevërve në moral*; një revoltë që fsheh pas vetes një histori dymijë vjeçare, e cila në ditët e sotme thjesht na ka shpëtuar pa e vënë re pasi - ajo ka fituar.

8.

A nuk e kuptoni? Nuk keni sy për këtë gjë së cilës iu deshën dymijë vjet që të fitonte?... Nuk ka asgjë për t'u çuditur: të gjitha proceset e *gjata* janë të vështira për t'u parë dhe për t'u kuptuar. *Kjo* ishte ajo që ndodhi: mbi trungun e asaj peme të hakmarrjes dhe urrejtjes, urrejtjes çifute – urrejtjes më të thellë e më sublime, pra krijuese idealesh, jo përçmuese vlerash, që kurrë në tokë s'pati të dytë – çeli diçka po aq e pakrahasueshme, *një dashuri të re*, më e thella dhe më sublimja e të gjitha llojeve; - dhe mbi cilin trung tjetër mundi të çelte ajo?... Por mos mendoni se mbase është ngritur si një mohim i vërtetë i etjes për hakmarrje, si një antitezë e urrejtjes

çifute! Jo, është e vërtetë e kundërta! Kjo dashuri çeli prej asaj urrejtjeje, si kurorë e saj, si kurora triumfuese e saj, duke e zgjeruar gjithmonë e më shumë rrethin e vet drejt kthjelltësisë dhe plotësisë së diellit, duke kërkuar në mbretërinë e qiellit dhe të lartësive fitoren, prenë, joshjen e saj, me të njëjtin intensitet me të cilin rrënjët e asaj peme të urrejtjes u shtrinë në çdo gjë të thellë dhe të keqe sa më shumë që rritej qëndrueshmëria dhe dëshira. Jezusi prej Nazareti, mishërimi i vërtetë i dashurisë, ky "shpëtimtar" që u sjell lumnimin dhe fitoren të varfërve, të sëmurëve, mëkatarëve - a nuk ishte pikërisht joshja në formën më të frikshme dhe më dhe të pandalshme, joshja dhe shtegu i shkurtër drejt atyre vlerave *çifute* e atyre risive *çifute* të idealit? A nuk arriti vallë Izraeli përmes shtegut të shkurtër të këtij "shpëtimtari", të këtij kundërshtari e shpërbërësi në dukje të Izraelit, skajin e fundmë të etjes së vet për hakmarrje? A nuk është pjesë e magjisë së zezë së një politike realisht *të madhe* të hakmarrjes, të një hakmarrje largpamëse, të nëndheshme, që fiton terren ngadalë dhe është parashikuese në llogaritë që bën, fakti që vetë Izraelit i është dashur ta mohojë dhe ta vërë në kryq përpara gjithë botës si njëfarë armiku për vdekje, instrumentin e mirëfilltë të hakmarrjes së tij, në mënyrë që *mbarë bota*, pra gjithë armiqtë e Izraelit të binin në këtë karrem? Nga ana tjetër, kush mund të imagjinohte, sado mendjehollë të ishte, një karrem më të rrezikshëm se sa ky? Diçka që të jetë e ngjashme me fuqinë hipnotike, intoksikuese, trulllosëse dhe korruptuese, që ka "kryqi i shenjtë", me paradoksin e një "Zoti në kryq", me misterin e mizorisë së pahamendësueshme,

të fundme, të skajshme të vetëkryqëzimit të një Zoti për shpëtimin e njeriut?... Është e sigurt se *sub hoc signo** Izraeli, ka triumfuar gjithmonë deri më sot mbi të gjitha idealet e tjera, mbi të gjitha idealet *më fisnike*, me hakmarrjen e tij dhe me përmbysjen e të gjitha vlerave.

9.

«Por pse të na flasin akoma për ideale *më fisnike*? Le t' u përmbahemi fakteve: populli ka fituar – ose “skllëverit”, “plebenjtë”, “kopeja” quajini si të doni – në qoftë se kjo ka ndodhur nëpërmjet çifutëve, e pra kështu ka ndodhur! Asnjë popull në krahasim me ta, nuk ka luajtur një rol kaq të madh në historinë botërore. “Padronët” janë hequr qafe; morali i njeriut vulgar ka triumfuar. Kjo fitore mund të konsiderohet edhe si një helmim i gjakut (ajo ka përzier racat ndërmjet tyre) – kësaj nuk ke ç' i diskuton; por padyshim që ky intoksikim ka qenë i suksesshëm. “Shëlbimi” i llojit njerëzor (shëlbim ky prej padronëve) po përparon; çdo gjë po çifutizohet, kristianizohet, ose vulgarizohet (ç' rëndësi kanë fjalët?). Duket e pamundur të ndalohet rrjedha e kësaj helmatisje të përhapur në të gjithë trupin politik të njerëzimit; madje përparimi i saj mund të jetë tani e tutje gjithnjë e më i ngadaltë, më i pakapshëm e më i kujdesshëm – vetëm koha që s' mungon për një gjë të tillë... Në këtë kontekst, a ka të drejtë Kisha të ekzistojë në kohën e sotme? A mund të bëhet edhe pa të? *Quaeritur**. Duket

* Lat. - nën këtë shenjë, nën këtë flamur.

* Lat.: Shprehje e gjuhës ligjore që do të përkthehej “Këtu qëndron çështja” ose “As që bëhet fjalë”.

se ajo e ndal dhe frenon një prirje të tillë në vend që ta përshpejtojë atë. Epo mirë pra, pikërisht kjo mund të jetë dobia e saj. Sigurisht që kisha është një institucion i vrazhdë, prej të cilës ka ndot inteligjenca më delikate, ajo me gusto vërtetë moderne. A nuk do duhej të rafinohej pak? Sot ajo më shumë të largon sesa të bën për vete. Cili prej nesh do të ishte “mendimtar i lirë” sikur të mos ekzistonte kisha? Ajo që na ngjall neveri është kisha, jo helmi i saj – po ta lëmë mënjanë kishën, ne e kemi qejf helmin...»

Ky është epilogu i një “mendimtari të lirë” ndaj diskutimit tim, i cili është një kafshë e nderuar (siç e ka provuar plotësisht një gjë të tillë), e që për më tepër është dhe demokrat; deri më tani qe bërë gjithë sy e veshë dhe nuk po arrinte më ta duronte heshtjen time. Pasi për mua, këtu ku jemi, ka shumë gjëra që duhen kaluar në heshtje lidhur me këtë çështje.

10.

- Revolta e sklleverve në moral fillon qysh kur *ressentiment** bëhet krijuese dhe prodhon vlera; *ressentiment** i atyre kensave të cilëve reagimi i vërtetë, pra veprimi, iu është ndaluar dhe ngushëllohen vetëm me një hakmarrje imagjinare. Teksa çdo moral aristokrat lind nga një pohim triumfues i vetvetes, morali i sklleverve i thotë “jo” çdo gjëje të jashtme që është “jashtë vetes së tij”, “i ndryshëm nga vetja e tij” dhe që është një “një tjetër”: dhe kjo “jo” është forca e tij krijuese. Kjo

* Fr.: mëri. Në të gjitha botimet evropiane, fjala është lënë si tek origjinali, në frëngjisht.

përmbysje e gjykimit që përcakton vlera - ky drejtim i detyrueshëm kah e jashtëmja në vend të kthimit tek vetvetja - i vjen përshtat pikërisht *ressentiment*-it: morali i skllëvërve për të lindur ka nevojë, po të shprehemi në terma psikologjikë, për shtysa të jashtme për të vepruar, - veprimi i tij është thelbësisht reagues, kundërveprues. E kundërta ndodh me mënyrën aristokrate të vlerësimit: kjo vepron dhe zhvillohet vetiu, e kërkon të kundërtën e saj vetëm me qëllim për t'i thënë "po" vetes me mirënjohje e hare edhe më të madhe - koncepti aristokrat negativ, për "të ulëtën", "vulgaren", "të keqen", është thjesht një imazh i zbehtë dhe artificial në kontrast me konceptin themelor dhe plot jetë e pasion të "neve aristokratëve, neve të mirëve, neve të mrekullueshmëve, neve të lumturve"!

Kur morali aristokratik gabon dhe mëkaton ndaj realitetit, kjo ndodh në raport me një sferë të caktuar të cilën ky moral *nuk* e njeh mjaftueshëm - një sferë kjo, prej njohjes së të cilës ai e mbron veten në mënyrë shpërfillëse. Në disa raste, ky moral keqkupton sferën të cilën ai përbuz, sferën e njeriut të zakonshëm e vulgar dhe të njeriut të ulët; nga ana tjetër, duhet pasur parasysh që, në një mënyrë a në një tjetër, ndjenja e përbuzjes, e të parit nga lart poshtë, edhe nëse e pranojmë se e *falsifikon* objektin të cilit i referohet, prapëseprapë ajo nuk krahasohet me shkallën e falsitetit që karakterizon urrejtjen hakmarrëse me të cilën të dobëtit sulmojnë në armiqtë e tyre. Si pasojë e kësaj, ndodh të ngatërrohen me njëra-tjetrën shpërfillja, sipërfaqësorja, bezdisja dhe padurimi, dhe në këtë pikë vetëkënaqësia bën që viktima të shndërrohet në një karikaturë,

ose në një gogol. Vëmendje duhet përsëri t'i kushtohet *nuancave* pothuajse dashamire, që fisnikëria greke i vishte fjalëve përmes të cilave dallonte popullin e zakonshëm prej vetes; vini re se si pothuajse tek të gjitha fjalët që përdoren për njeriun vulgar kemi shprehjen e një lloj ndjenje përkujdesjeje, mëshire, të cilat duken tek shprehjet si "fatkeqët", "ata që kanë nevojë për mëshirë" (krahaso δειλός, δειλαιός, πονηρός, μοχθηρός, ku dy termat e fundit i referohen njeriut të zakonshëm si skllav-pune dhe kafshë transporti) – dhe ashtu si nga ana tjetër, "i keq", "i ulët", "fatkeq", nuk ka reshtur kurrë së tingëlluari në veshin grek me një ton në të cilin "fatligu" ishte nota bazë: kjo është një trashëgimi e moralit të vjetër aristokrat, i cili nuk e përgënjeshtrohet veten as në përbuzje (le të kujtojnë filologët kuptimin në të cilin përdoren οϊζυρός, άνολβος, τλήμων, δυστυχείν, συμφορά). "Të mirëlindurit" thjesht e ndjenë veten "fatlumë"; ata nuk kishin nevojë ta ndërtonin artificialisht lumturinë e tyre duke hedhur shikimin nga armiqtë e tyre, as t'ia impononin vetes me kandisje, me gënjeshtër (siç bëjnë zakonisht të gjithë njerëzit e *ressentiment-it*); dhe kështu, si njerëz të plotësuar që janë, të tejmbushur me forcë, dhe për pasojë domosdoshmërisht aktivë, ata nuk dinin ta ndanin lumturinë nga të vepruarit – të qenit bërës e llogarisin si lumturi (kjo është etimologjia e εὖ πράττειν) – e gjitha kjo në kontrast të plotë me "lumturinë" e të dobëtëve dhe të shtypurve, me dashakeqësinë dhe armiqësinë e tyre helmatisëse, mes të cilëve lumturia shfaqet si një narkozë, trulllosje, qetësi, paqe, si një "sabbath", shtendosje e mendjes dhe relaksim i trupit – e thënë shkurt në *formë pasive*. Teksa

njeriu i fisëm jeton me besim dhe troçësi para vetvetes (γενναίος, “i lindur fisnik”, që thekson nuancën “i sinqertë”, e mbase edhe “naiv”), njeriu i *ressentiment-it* nuk është as i sinqertë dhe as naiv, as i ndershëm me vetveten. Shpirti i tij *shan*; mendja e tij pëlqen birucat, shtigjet e tërthorta, skutat, çdo gjë e fshehtë e tërheq si të ishte bota e *tij*, siguria e *tij*, streha e *tij*; është ekspert kur bie fjala për heshtur, për të mbajtur mend, për të pritur, për t’u tutluar dhe për ta ulur veten. Një këso race njerëzish të *ressentiment-it* do përfundojë medoemos duke u bërë më e zgjuar se çdo racë aristokrate, ajo do ta nderojë zgjuarsinë në një mënyrë krejt tjetër, domethënë si një kusht të shkallës së parë, ndërsa zgjuarsia te njerëzit aristokratë ka shpesh herë një shije të hollë luksi dhe finese – mes tyre në fakt, ajo nuk është asfare aq thelbësore saç është funksionimi perfekt dhe i sigurt i instinkteve të *pavetëdijshme* rregullatore, ose sa është një lloj spontaniteti, që karakterizohet nga guximi për t’u hedhur me gjithsej si ndaj rrezikut qoftë ndaj armikut, apo ato shpërthimet e befta të ngazëllvera të jetës, të dashurisë, të jetëdhënies, të mirënjohjes e të hakmarrjes, tek të cilat janë njohur kurdo shpirtrat aristokratë. Vetë *ressentiment-i* i njeriut aristokrat, kur ngjallet brenda tij, shpërfaqet dhe konsumohet në formën e një reagimi të menjëhershëm që *nuk helmatis*: gjë që është e pashmangshme tek të gjithë të dobëtit dhe të pafuqishmit. Paaftësia për të mos e marrë seriozisht gjatë armikun, fatkeqësinë, edhe *keqbëmat* vetjake – kjo është veti e natyrave energjike, të plota, ku ekziston një tepri force plastike, që rigjenerohet plotësisht dhe prodhon harresë (një shembull i mirë për këtë, marrë

në botën moderne, është Miraboja, i cili nuk kishte kujtesë për fyerjet dhe poshtërsitë e bëra kundër tij dhe që i nuk ishte në gjendje të falte për faktin e thjeshtë se - harronte). Një këso burri, me një të shkundur të trupit hedh përtokë të gjithë krimbat që i janë ngjitur, të cilët tek trupi i ndonjë tjetri do të kishin bërë fole; vetëm te ky rast është e mundur, gjithë nëse përgjithësisht është e mundur mbi tokë, - "dashuria e vërtetë edhe për armikun". Sigurisht, sa shumë respekt ka për armiqtë e tij njeriu aristokrat! - dhe ky respekt është sakaq një urë drejt dashurisë. Madje e do për vete armikun e tij, si shenjë të vetën dalluese, nuk duron asnjë armik tjetër në mos atë ku s'ke ç'të përçmohsh dhe ke shumë për të nderuar! Le të mendojmë anasjelltas për konceptin që ka për "armikun" njeriu i *ressentiment*-it - dhe pikërisht tashti do e gjejmë veprimin e tij, mënyrën si krijon: ky koncepton "armikun e keq", "të keqin" pikërisht si ide bazë duke u nisur prej të cilës imagjinohen të kundërtën dhe antiteza e tij, pra një "të mirë", veten!...

11.

Pra krejt në të kundërt me njeriun e fisëm, i cili e koncepton paraprakisht dhe vetiu idenë themelore të "të mirit", duke u nisur pra nga vetja, dhe vetëm mbi këtë bazë krijon më pas një imazh të "të keqit"! Ky "i keq" me origjinë aristokrate dhe ai "i ligu" që ka dalë prej kazanit të urrejtjes së pangopur - e para një krijim i ndajshuar, një ngjyrë përplotësuese, një aksesori; ndërsa e dyta, origjinali, gjeneza, akti i mirëfilltë i një morali skllavëror - sa ndryshim kanë nga njëra-tjetra këto dy

fjalë, “i keq” dhe “i mirë”, që në dukje i kundërvihet po atij koncepti të “së mirës”. Por koncepti i “të mirit” nuk është i njëjti: më mirë le të shtrojmë pyetjen, se cili është “i ligu” sipas kuptimit të moralit të *ressentiment*.

Me një përgjigje rigoroze do të themi: pikërisht “i miri” i moralit tjetër, pikërisht i fismi, i fuqishmi, ai që bën ligjin, vetëm se pikturohet me ngjyra të tjera, interpretohet në kuptimin e kundërt, shihet me tinëzi nga syri i dritështrembër i *ressentiment*. Këtu ka diçka që ne do ishim të fundit që do ta mohonim: ai që i ka njohur ata “të mirë” vetëm si armiq, nuk do njohë asgjë tjetër veç *armiqsh të ligj*, dhe vetë këta njerëz që mbahen rreptësisht brenda kufijve prej dokeve, prej respektit, prej zakonit, e akoma më shumë prej vigjilencës së ndërsjellë prej xhelozisë *inter pares**, dhe nga ana tjetër, në marrëdhëniet mesveti tregohet kaq të përpiktë në të respektuarit, në vetëkontrollin, në delikatesën e të ndjemit, në besnikëri, krenari dhe në miqësi, këta njerëz në raport me atë që është jashtë rrethit të tyre (atje ku fillon bota e huaj, *të huajt*), s’janë më të mirë se bishat e egra. Ata i gëzohen atëbotë lirisë së tyre prej kontrollit social, gjejnë shpagë në gjendjen e egër prej tensionit të prodhuar nga ngujimi i gjatë në paqen e komunitetit, ata *kthehen prapa* në pafajësinë e ndërgjegjes së kafshës pretare, si përbindësja festivë që mbase sa kanë dalë prej një maratone të lemerishme vrasjesh, flakëvëniesh, poshtërsish, torturash me aq krekosje dhe ekuilibër të brendshëm, sikur të paskej qenë thjesht një sherr mes studentësh, të bindur se poetët do të kenë tashmë për

* Lat.: mes të barabartësh

shumë kohë diçka të re për të kënduar dhe celebruar. Në fundin e të gjitha këtyre racave duhet dalluar bisha e egër, të mrekullueshmen të çarturën *bishë bionde*, të babëzitur për pré dhe për fitore; dhe herë pas here nevojitet një shfrim për këtë fundërrinë të fshehur, bisha duhet të dalë përsëri në pah, të kthehet në jetën e egër, - aristokracia romake, arabe, gjermane dhe japoneze, heronjtë homerikë, vikingët skandinavë, te kjo nevojë ngjajnë të gjithë me njëri-tjetrin. Kanë qenë racat fisnike ato, që në të gjitha shtigjet që kanë shkelur, kanë lënë në gjurmët e tyre konceptin "barbar"; niveli i tyre e pran i kulturës kallëzon akoma vetëdijen e këtij fakti dhe madje krenarinë në lidhje me të (për shembull, kur Perikliu u thotë athinasve fjalimin e tij të famshëm mortor: "guximi ynë i ka hapur rrugën vetes mbi çdo tokë e det, duke ngritur kudo tempuj të pavdekshëm të *së mirës dhe së keqes*").⁶ Ky "guxim" i racave të fisme, i çmendur, absurd, i papritur, mënyra sesi shpaloset, paparashikueshmëria, vetë ana e pagjasë sipërmarrjeve të tyre - Perikliu nënvizonte veçanërisht *παθούια* të athinasve⁷ -, indiferenca dhe përçmimi i tyre ndaj sigurisë, trupit, jetës, komo-diteteve, qetësia e tyre e tmerrshme dhe thellësia e shijimit në çdo shkatërrim, në çdo epsh fitoreje dhe mizorie - e gjitha kjo, kristalizohet për ata që e pësojnë në imazhin e "barbarit", e "armikut të ligë", për shembull të "gotëve", të "vandalëve". Mosbesimi i thellë gjakngrirës që shkakton gjermani edhe sot e kësaj dite, posa e vendos pushtetin e vet - është gjithsesi prapë një jehonë e atij tmerr të pashuar me të cilin Evropa e ka parë gjatë shekujve tërbimin e bishës bionde gjermanike (edhe pse ndërmjet gjer-

manëve të lashtë dhe neve të sotmit mezi ekziston një afërsi konceptuale dhe aq më pak një afërsi gjaku). Dikur kam pasë tërhequr vëmendjen te sikleti i Hesiodit, kur ai hamendësoi vijimësinë e epoka të qytetërimit dhe u përpoq t'i shprehte ato në terma si ar, argjend dhe bronz: ai nuk diti ta zgjidhte kontradiktën që paraqiste bota e Homerit aq e shkëlqyer e njëkohësisht aq e tmerrshme dhe e dhunshme, përveçse duke e ndarë të njëjtën epokë në dy faza të veçanta, të njëpasnjëshme - e para, ajo e heronjve dhe e gjysmëzotave të Trojës dhe të Tebës, ashtu siç kjo ishte ruajtur në kujtesën e fiseve aristokrate që shihnin tek ata paraardhësit e tyre; më pas, epoka e bronzit, ashtu siç u qe dukur ajo pasardhësve të të shtypurve, të plaçkiturve, të përdhosurve, të gjithë atyre qenë marrë zharg dhe shitur: një epokë prej bronzi, si u tha, e ashpër, e ftohtë, e tmerrshme, pa ndjenja dhe pa ndërgjegje, që shtrydh gjithçka dhe e lan në gjak. Ta zëmë se ka qenë e vërtetë ajo që sot besohet si "e vërtetë", pra që *kuptimi i çdo qytetërimit është pikërisht ai që të disiplinojë me anë të edukimit bishën grabitqare "njeri", për ta bërë kësodore një kafshe të zbutur dhe të qytetëruar, një kafshë shtëpiake, duhen marrë në shqyrtim pa dyshimin më të vogël të gjithë ato instinkte reagimi dhe *ressentiment*, përmes të cilave racat aristokrate janë poshtëruar në fund dhe janë mposhtur bashkë me idealet e tyre, si *instrumentet tipike të qytetërimit*; megjithëse me kaq nuk kemi thënë ende se bartësit e këtyre instrumenteve *përfaqësojnë gjithashtu vetë qytetërimin*. Përkundrazi, e kundërta e kësaj jo vetëm që është më e mundur, por madje tashmë është tepër e qartë! Këta bartës të instinkteve të*

shtypura dhe të djegur për shpagë, pasardhësit e çdo skllavërie evropiane e jo evropiane dhe veçanërisht të çdo popullsie para-ariane - këta përfaqësojnë *kthimin prapa* të njerëzimit. Këto "instrumente të qytetërimit" janë një fatkeqësi për njeriun dhe janë më shumë një dyshim, një argument i kundërt me "qytetërimin" në përgjithësi! Edhe mund të kihet e drejta për të mos u çliruar nga frika prej bishës bionde që është në themelin e të gjitha racave aristokrate dhe që për t'u qëndruar vigjilentë: por cili është ai që nuk do të parazgjidhte njëqind herë më mirë të kishte frikë diçka që në të njëjtën kohë mund ta admironte, se sa të mos kishte frikë, pa mundur ndërkaq të çlirohej dot prej të pamit krupndjellës të qenieve të lindura keq, prej meskinëve, prej të trishtuarve dhe të helmatisurve? Dhe a nuk është kjo fataliteti *ynë*? Çka e përcakton sot ndotin *tonë* prej "njeriut"? - sepse nuk diskutohet se për njeriun *vuajmë*. - Jo drashtja, porse fakti se nuk ka më asgjë për t'u pasur frikë nga njeriu; se krimbori "njeri" i ngrohtë është në plan të parë dhe gëlon; se "njeriu i zbutur", njeriu pashërueshmërisht mediokër dhe i bezdisshëm është mësuar ta ndjejë veten si qëllim final e si kulm, si kah i historisë, si "njeri superior" - se ky ka pikërisht njëfarë të drejte që ta mbajë veten si i tillë, përderisa e ndjen veten si të distancuar nga tërësia e qenieve të deformuara, gjytyrime, të dërrmuara, të zhbëra, prej të cilave po zë të infektohet sot Evropa, pra si diçka që të paktën krahasimisht është e arrirë, të paktën është ende e zonja për të jetuar, të paktën ia thotë jetës "po-në" e saj.

12.

Këtu nuk arrij ta përmbaj një psherëtimë dhe një shpresë të fundit. Çfarë është pra për mua pikërisht gjëja absolutisht më e patolerueshme? E vetmja gjë të cilës nuk i dal në krye, që ma merr frymën dhe më mpak? Ajri i keq! Ajri i keq! Afrimi i diçkaje të dalë keq; kur detyrohem të ndjej kutërbimin e një shpirti të deformuar së brendshmi!... Në fund të fundit, çfarë nuk arrijmë të durojmë nga brenga, privimet, bunacat, sëmundjet, mundimet dhe vetmisë? Fundja, arrijmë t'ia dalim mbanë këtyre dhe të tjerave, pasi jemi të lindur për një ekzistencë të nëndheshme lufte; gjithmonë dalim prapë në dritë, gjithmonë e përjetojmë prapë çastin tonë të praruar të fitores – dhe ja ku jemi të patundur, ashtu siç kemi lindur, të pashkatërrueshëm, të tendosur, gati për të renë, për atë çka është edhe më e vështirë, edhe më e largët, si harqe të të cilëve çdo angështrim i jep prorë veç si një tendosje edhe më të fortë. - Por më lejoni herë pas here – gjithë nëse ka, përtej së mirës dhe së keqes, perëndi të shpagimit – një pamje, një shikim të vetëm lejomëni, të diçkaje të përsosur, plotësisht të arrirë, të lume, të fuqishme, triumfuese, të diçkaje që mbart akoma një shkas për frikë! Pamja e një njeriu që justifikon ekzistencën e *njeriut*, pamja e një shorti fatlum, integrues dhe shëlbyes, falë të cilit mund të ruhet *besim tek njeriu!*... Pasi kështu qëndron e gjitha: meskinizmi dhe nivelimi i njeriut evropian fsheh rrezikun *tonë* më të madh, duke parë lodhjen që na shkakton ky spektakël... Sot nuk shohim asgjë që dëshiron të bëhet më e madhe, kemi parandjenjën se gjithçka vijon të fundo-

set, të fundoset duke u bërë më e hollë, më e mirë, më e matur, më e përshtatshme, më mediokre, më indifereente, më kineze, më e krishterë – njeriu, padyshim – bëhet gjithmonë e më “i mirë” ... Pikërisht këtu qëndron fataliteti i Evropës – të frikësuar për njeriun kemi humbur edhe dashurinë për të, nderimin e tij, shpresën tek ai, madje edhe vullnetin e tendosur kah ai. Të pamët e njeriut tashmë na lodh - e çfarë është tjetër nihilizëm sot përveç kësaj?... Ne jemi të lodhur nga njeriu...

13.

Por le të kthehemi mbrapa: problemi i origjinës tjetër të “së mirës”, të së mirës siç e ka konceptuar njeriu i *resentiment*, është një problem që kërkon zgjidhje. - Fakti se qengjat nuk duan asnjë zog të madh grabitqar, nuk është ndonjë çudi e madhe; por një gjë e tillë nuk na autorizon t’i qortojmë grabitqarët e mëdhenj për faktin se bëjnë zap qengja. Dhe nëse qengjat thonë mesveti: “Këta grabitqarë janë të ligj; dhe ai që është më pak grabitqar, e madje ai që është i kundërt me këtë, domethënë qengji, a nuk duhet të jetë i mirë?”, kësaj mënyre për të ngritur një ideal nuk ke ç’ti thuash, përpos fakti se zogjtë grabitqarë do e shohin këtë gjë me një lloj shpotie dhe mbase do thonë: “Ne nuk i urrejmë aspak këta qengja të mirë, përkundrazi i duam, s’ka gjë më të shijshme se një qengj i butë”. Të kërkosh prej forcës që ajo të mos e shpërfaqë veten si forcë, që ajo të mos jetë dëshirë për të mposhtur, dëshirë për të shembur, dëshirë për të qenë padron, etje për armiq dhe antagonizma e triumfe, është po aq absurde sa t’i kërkosh

dobësisë që të shpërfaqet si forcë. Një *quantum* force s'është veçse një *quantum* lëvizjeje, vullneti, aktiviteti – madje nuk është gjë tjetër veçse kjo lëvizje, ky vullnet, ky aktivitet, dhe vetëm iluzionet e gjuhës (dhe gabimet themelore të arsyes, të ngurtësuar në të) që nënkuptojnë dhe keqkuptojnë çdo veprim si të ishte i kushtëzuar nga një veprues, nga një “subjekt”, mund të bëjnë që kjo të duket ndryshe. Pikërisht ashtu si populli e ndan në fakt rrufenë nga vetëtimia e saj dhe mëton se kjo e fundit është një *veprim*, produkt i një subjekti i cili quhet rrufe, po kështu dhe morali popullor e dallon fuqinë nga shpërfaqja e fuqisë, a thua se pas njeriut të fortë ekziston një nënshtresë asnjënjë, të cilës iu *lejokërka* ta shpërfaqë forcën ose jo. Por nuk ekziston kurrfarë *nënshtrese* e tillë: nuk ekziston kurrë një “qenie” përpos të bërit, të vepruarit, të ndryshuarit; “bërësi” është thjesht diçka që i është ndajshuar të bërit – të bërit është gjithçka. Në fund të fundit, populli e dublon të bërit, kur ai e bën vetëtimën të vetëtijë, kjo është një “bërje e bërjes”; e bën të njëjtën dukuri në fillim shkak dhe pastaj pasojë të shkakut. Nuk sillen më mirë natyralistët kur thonë : “Forca lëviz, forca shkakton” e kështu me radhë – e gjithë shkenca jonë, për turpin e gjithë ftohtësisë së saj dhe të distancës së saj nga pasionet, është akoma nën joshjen e gjuhës dhe nuk është çliruar akoma nga këta bastardë të supozuar, “subjektet” (atomi, për shembull, është një prej këtyre bastardëve, ashtu si “sendi në vetvete” i Kantit). Nuk kemi pse habitemi që pasionet e strofulluara që ngrohen fshehurazi nën hi, të urrejtjes dhe hakmarrjes e shfrytëzojnë në dobi të vet këtë besëtytë duke mbërritur si përfundim që të mos mbajnë në

këmbë asnjë bindje tjetër përpos asaj “që i forti ka *lirinë* për të qenë i dobët, dhe zogu grabitqar lirinë për të qenë qengj.” Kësodore ata i njohin të drejtën vetes që ta akuzojnë zogun grabitqar pikërisht pse është grabitqar... Nëse të shtypurit, të poshtëruarit, të nënshtruarit, nën shtysën e dinakërisë që digjet për hakmarrje, në pafuqi, thonë: “Na lini të jemi të ndryshëm nga të ligjtë, pra të mirë! Dhe i mirë është çdokush që nuk shtyp, që nuk lëndon askënd, që nuk sulmon, që nuk kërcënon, që ia lë hakmarrjen Zotit, e që ashtu si ne rri në fshehtësi, që shmang çdo të keqe, që kërkon pak nga jeta, i ngjashëm me ne të duruarit, të përulurit, të drejtët”. E gjitha kjo, po të dëgjohet në mënyrë të ftohtë e pa asnjë masë mbrojtëse, nuk do të thotë veçse këtë: “Epo, ne të dobëtit jemi veçse të dobët dhe asgjë tjetër; e mira është *të mos marrësh përsipër të bësh asgjë për të cilën nuk ke forcën e duhur*”; por ky realitet shqeto, ky kujdes i rangut më të ulët, të cilin e kanë edhe insektet (që në fakt në rast rreziku të madh shtiren sikur kanë ngordhur, për të mos bërë asgjë “të tepërt”) falë artit të kamuflimit dhe kapacitetit për të mohuar veten, tipik për pafuqinë, hedh petkun pompoz të virtytit të dorëheqjes, heshtjes, pritjes, a thua se vetë dobësia e të dobëtit, domethënë *esenca* e tij, produktiviteti i tij, i gjithë realiteti i tij i plotë, unik, i pashmangshëm e i pakthyeshëm, të ishte një efekt i vullnetshëm, diçka e dëshiruar, e zgjedhur, një *veprim*, një *meritë*. Këta lloj njerëzish kanë nevojë të besojnë në një subjekt që është i lirë të zgjedhë pa dallim, çka rrjedh nga instinkti i ruajtjes, i vetëpohimit, në të cilin është normale që të shenjtërohet çdo gënjeshtër. Mbase prej kësaj subjekti (ose e thënë në mënyrë më

popullore, *shpirti*) ka qenë deri më sot artikulli më i mirë i besimit mbi tokë, sepse u ka lejuar shumicës së vdekatarëve, të dobëtëve dhe të shtypurve të çdo lloji, atë mashtrimin sublim të vetes që e interpreton edhe dobësinë si liri, të qenin e saj kështu ose ashtu, si *meritë*.

14.

A gjakon njeri të kuturisë pak me sytë e tij thellë në fund të sekretit si *fabrikohen idealet në tokë*? Kush ka kurajë për këtë?... Përpara! Ja, kjo oficinë e errët hapet para shikimit tonë. Prisni vetëm një çast i dashur zoti Kureshtar dhe Kokëkrisur; më parë sytë tuaj duhet të mësohen me këtë dritë të rreme luhatëse... Kështu! Fort mirë! Flitni tani! Çfarë po ndodh aty poshtë? Na thoni çfarë shihni, o njeri me kuriozitet të rrezikshëm – tani do të jem *unë* dëgjuesi.

“Nuk shoh asgjë, por që dëgjoj më mirë. Nga çdo cep dhe nga çdo skutë vjen një lllomotitje djallëzore dhe e dyshimtë që mezi dëgjohet, një pëshpërimë e përgjithshme. Më duket se të gjithë nëpërdhëmbin gënjeshtër, çdo tingull duket sikur është i damkosur me një ëmbëlsi prej mjalti. Dobësia duhet falsifikuar në *meritë* – nuk ka fé dyshimi – është pikërisht ashtu si thatë ju.”

- Jepi!

- “Dhe impotenca që nuk merr shpagë, duhet falsifikuar në “mirësi”, burracakëria e frikur në “përvujturi”, nënshtrimi para atyre që urrejmë në “bindje” (bindje, pra, ndaj dikujt që sipas tyre e imponon këtë nënshtrim - e quajnë Zot). Pasiviteti i të dobëtëve, burracakëria me të cilën është bërë i pasur, me atë qëndrimin e tij

gjithmonë në dritare, vetia e tij e pashmangshme për të qëndruar në pritje, përfton kësodore emër të mirë, si "durim", dhe mbërrin të nënkuptojë vetë "virtytin"; pamundësia për t'u hakmarrë shndërrohet në mospasje dëshirë për t'u hakmarrë, madje ndoshta dhe në falje ("sepse *ata* nuk dinë se ç'bëjnë⁸ - vetëm ne e dimë çfarë bëjnë ata!"). Flitet edhe për "dashurinë ndaj armiqve tuaj"⁹ - dhe djersa shkon çurg."

- Jepi!

"Janë mjeranë, pa dyshim, gjithë këta pëshpëritës e falltarë skutash, anipse kllaçiten ngrohtë pranë njëri-tjetrit - e prapë më thonë se mjerimi i tyre është shenjë që tregon se Perëndia i ka zgjedhur duke i dalluar mes të tjerësh, se njeriu *rrifka* pikërisht qentë që do më shumë; se ndoshta ky mjerim qenka një përgatitje, një provë, një zbutje, ndoshta edhe diçka më tepër - diçka që një ditë do të shpërblehet me interesa të mëdha në ar, çfarë them (!) në lumturi. Dhe këtë e quajnë "lumnim"!".

Jepi!

- "Tani këta më lënë të kuptoj se jo vetëm që janë më të mirë se të fuqishmit, se sa zotërit e tokës, të cilëve duhet t'u lëpijnë pështymën (jo prej frikës, kurrsesi prej frikës, por ngase Zoti ka urdhëruar të nderohet çdo autoritet)¹⁰ - që jo vetëm janë më të mirë, por edhe që "janë më mirë", ose që sidoqoftë "do të jenë më mirë", një ditë. Po mjaft më! E mbyllim! Nuk duroj dot. Ajër i rëndë! Ajër i rëndë! Më duket se kjo oficinë ku *fabriko-hen idealet*, është e mbushur me gënjeshtër të qelbura."

- Jo, prisni edhe një çast! Ende nuk më keni folur për kryeveprën e këtyre *negromantëve*, që nga gjithçka që është e zezë nxjerrin të bardhën, qumështin dhe pa-

fajësinë – a nuk e keni vënë re se deri në ç' pikë arrin përkryerja e tyre në rafinim, takti i tyre artistik sypatrembur, i stërhollë, stërgjenial e i stërgënjeshtërt? Bëni kujdes! Këto gjëkafshë të nëndheshme që gëlojnë nga hakmarrja dhe urrejtja – çfarë bëjnë pikërisht me hakmarrjen dhe urrejtjen? A i keni dëgjuar ndonjëherë këto fjalë? A do të dyshonit ndonjëherë, gjithë sikur t'iu besonit fjalëve të tyre, se do gjendeni pikërisht mes njerëzve të *ressentiment-it*?

- «Kuptoj, dhe po i hap edhe një herë veshët (medet, medet, medet, dhe *po mbyll* hundët). Tani po dëgjoj për herë të parë atë që ata e kanë thënë aq shpesh: “Ne të mirët, *ne jemi të drejtët* – atë çka kërkojnë nuk e quajnë si shpagë, por si “triumfin e drejtësisë”, atë çka urrejnë nuk e quajnë armikun e tyre, jo! por ata urrejnë “padrejtësinë”, “blasfeminë”, ajo në të cilën besojnë dhe shpresojnë nuk është shpresa për hakmarrje, për të ëmblën hakmarrje (“më të ëmbël se mjalti” – e pati quajtur Homeri),¹¹ por fitorja e Zotit, e Zotit të *drejtë* mbi blasfemuesit; ajo çka iu mbetet të duan në faqe të dheut nuk janë vëllezërit e tyre në urrejtje, por “vëllezërit e tyre në dashuri”,¹² siç thonë ata, të gjithë të mirët dhe të drejtët e tokës.»

- Dhe si e quajnë atë që iu shërben si ngushëllim për gjitha vuajtjet e jetës – fantazmagorinë e tyre të së ardhmes së bekuar të mbivendosur prej tyre?

- “Si? Mirë e dëgjova? E quajnë “grykimi universal”, ardhjen e mbretërisë së tyre, “mbretërisë së Zotit” – por ndërkohë jetojnë “në besim”, “në dashuri”, “në shpresë”.

- Po mjaft me kaq! Mjaft me kaq!

15.

Në besimin tek çfarë? Në dashurinë për kë? Në shpresën për çfarë? - Këta të dobët - në fakt, në një çast të caktuar edhe ata duan të jenë të fortë, pa dyshim, dhe një ditë të bukur do të vijë edhe "mbretëria" e tyre - "mbretëria e Zotit" thjesht kështu e quajnë ata, siç dhe e kemi thënë: janë kaq të përulur në çdo gjë! Për ta përvojtur këtë mbretëri duhet jetuar gjatë, përtej vdekjes - madje duhet jetuar një jetë e përjetshme, për t'u ngushëlluar përjetësisht për jetën tokësore të kaluar "në besim, në dashuri, në shpresë". Të shpërblehesh për çfarë? Të shpërblehesh me çfarë?... Danteja, për mendimin tim, ka bërë një gabim trashanik duke vënë, me një naivitet tmerrues, në portën e ferrit të tij shkrimin "dashuria e amëshuar më krijoi"¹³ - ndërsa tek ajo e parajsës dhe me "lumnimin e përjetshëm" të saj, mund të qëndronte për bukuri, sidoqoftë do ta kishte tagrin për këtë, shkrimi "urrejtja e amshuar më krijoi" - gjithë nëse një e vërtetë mund të qëndrojë në portën e një gënjeshtre! Në fakt çfarë është lumnimi i asaj parajse?... Kësaj mund t'i biem në të edhe vetë, por do të ishte më mirë të na e tregonte një autoritet i padiskutueshëm i çështjes në fjalë, Tomas Akuini, shenjtori dhe mësuesi i madh. "*Beati in regno caelesti* - thotë ai me një butësi prej qengji - *videbunt poenas damnatorum, ut beatitudo illis magis complaceat.*" Ose nëse na e ka ënda ta dëgjojmë me tone më të forta, fjala vjen nga goja e njërit prej atyre etërve triumfues të Kishës, që ia ndalon dishepujve të tij kënaqësitë e spektakleve publike - e pse fundja?: «Besimi na ofron shumë më tepër - thotë

ky, *de Spectac.*, c. 29 sgg. - diçka shumë më intensive; falë shëlbimit kemi në dispozicionin tonë kënaqësi krejt të tjera; në vend të atletëve kemi martirët tanë; nëse duam gjak, e pra, kemi gjakun e Krishtit... Por çfarë nuk na pret në ditën e kthimit të tij, të triumfit të tij!» - dhe kështu vijon ky vizionar i rrëmbyer: «*At enim supersunt alia spectacula, ille ultimus et perpetuus iudicii dies, ille nationibus insperatus, ille derisus, cum tanta seaculi vetustas et tot eius natiuitates uno igne haurientur! Quae tunc spectaculi latitudo! Quid admirer! Quid rideam! Ubi gaudeam! Ubi exultem spectans tot et tantos reges, qui in coelum recepti nuntiabantur, cum ipso Iove et ipsis suis testibus in imis tenebris congemescentes! Item praesides (gubernatorët e provincave) persecutores dominici nominis saevioribus quam ipsi flammis saevierunt insultantibus contra Chistianos liquescentes! Quos praetera sapientes illos philosophos coram discipulis suis una conflagrantibus erubescentes, quibus nihil ad deum pertinere suadebant, quibus anemas aut nullas aut non in pristina corpora redituras affirmabant! Etiam poetas non ad Rhadamanti nec ad Minois, sed ad inopinati Christi tribunal palpitantes! Tunc magis tragoedi audienti, magis scilicet vocales (më mirë në zë, ulëritës edhe më të këqij) in sua propria calamitate, tunc histriones cognoscenti, solutiores multo per ignem; tunc spectandus auriga in flammea rota totus rubens, tunc xystici contemplandi non in gymnasiis, sed in igne jaculati, nisi quod ne tunc quidem illos velim vivos, ut qui malim ad eos potius conspectum insatiabilem conferre, qui in dominum desaevierunt. "Hic est ille, dicam, fabri aut quaestuariae filius (siç tregohet në të gjithë pjesën që vijon e sidomos nga ky përshkrim i nënës së Jezusit i njohur nga Talmudi, Ter-*

tuliani, duke u nisur nga ky çast i referohet çifutëve), *sabbati destructor, Samarites et deamonium habens. Hic est, quem a Juda redemistis, hic est ille arundine et colaphis diverberatus, sputamentis dedecoratus, felle et aceto potatus. Hic est, quem clam discentes subriperunt, ut resurrexisse dicatur vel hortulanus detradxit, ne lactucae suae frequentia commeantium leaderentur.*" Ut talia spectes ut talibus exultes, quis tibi praetor aut consul aut quaestor aut sacerdos de sua liberalitate praestabit? Et tamen haec jam habemus quodammodo perfidem spiritu imaginante repraesentata. Ceterum qualia illa sunt, quae nec oculos vidit nec auris audivit nec in cor hominis ascenderunt? (I Cor., 2,9). Credo certo et utraque cavea (rreshti i parë dhe i katërt, ose sipas të tjerëve, skena komike dhe tragjike) et omni stadio gratiora». ¹⁴ *Per fidem*: kështu është shkruar.

16.

Po i afrohemi përfundimit. Dy vlerat e përkundërta, "e mirë dhe e keqe", "e mirë dhe e ligë", kanë bërë mbi faqe të dheut një luftë të tmerrshme mijëvjeçare: e megjithëse është e sigurt se tashmë vlera e dytë ka kohë që e ka mposhtur të parën, ka ende vende ku beteja vazhdon dhe fati i saj nuk dihet. Madje mund të themi se ndërkohë ajo është intensifikuar gjithmonë e më shumë, duke u bërë gjithmonë e më e thellë, e më shpirtërore; aq sa ndoshta në ditët e sotme nuk ka mbetur më asnjë shenjë më përcaktuese e "natyrës sipërane", natyrës më shpirtërore, sesa të qenit të skizmuar në mënyrën që u tha dhe të qenit akoma një sheshbetejë e asaj antiteze. Simboli i kësaj lufte, i shprehur në shkro-

nja që kanë mbetur deri më sot të lexueshme përmbi të gjithë historinë e njerëzve, është "Roma kundër Judesë, Judea kundër Romës." Nuk ka pasur deri më sot asnjë ngjarje më të madhe se kjo betejë, se parashtrimi i *kësaj* çështjeje, se *kjo* kundërvënie e një armiqësie për vdekje. Roma ndjeu te çifuti diçka si mishërimin e kundërnaturës, simethënë *monstrum*-in e saj diametralisht të kundërt; në Romë çifuti konsiderohej një "*fajtor i vërtetuar* i urrejtjes ndaj mbarë gjinisë njerëzore":¹⁵ me plot të drejtë, përderisa është e drejtë të lidhet mirëqenia dhe e ardhmja e gjinisë njerëzore me dominimin e vlerave aristokrate, e vlerave romake. Po çfarë kanë ndjerë çifutët kundrejt Romës? Kjo merret vesh nga shumë shenja; por do të mjaftonte vetëm të sillnim ndërmend me kujdes Apokalipsin e Gjonit, modeli më i ngatërruar i të gjitha sharjeve që mund të jetë shkruar, që hakmarrja ka në ndërgjegje. (Veç të tjerash nuk duhet nënvlerësuar vendosmëria e skajshme e instinktit të krishterë, që pikërisht mbi këtë libër të urrejtjes shkroi emrin e dishepullit të dashurisë, të po atij të cilit i atribuoi ungjillin e entuziazmit dashuror: pavarësisht falsifikimit letrar që është nevojitur për këtë qëllim, këtu sidoqoftë fshihet një fije e vërtete.) Faktikisht romakët ishin të fortët dhe aristokratët, të fortë dhe aristokratë siç nuk ka pasur ndonjëherë mbi tokë, e madje të tillë siç as nuk janë ëndërruar ndonjëherë: çdo relikte e tyre, çdo mbishkrim të çon në ekstazë, gjithë nëse arrihet të gjendet çfarë shkruhet në to. Çifutët ishin anasjelltas ai popull priftëror, i *ressentiment par excellence*, tek i cili gjendej një gjenialitet popullor moral i pashoq: mjafton të krahasosh popujt me talente analoge si kinezët dhe gjer-

manët, me çifutët, për të dalluar se çfarë është e dorës së parë dhe çfarë e dorës së pestë. Cila prej tyre doli përkohësisht *fitimtare*, Roma apo Judea? Epo s'ka pikë dyshimi: mendoni në të vërtetë përpara kujt përkulen njerëzit sot, bash në Romë, si para kuintesencës së të gjitha vlerave eprane – dhe jo vetëm në Romë, por thuajse në më shumë se gjysmën e botës, kudo njeriu është zbutur, a gjakon të zbutet – para *tre çifutëve*, siç dihet, dhe *një çifuteje* (përpara Jezusit të Nazaretit, peshkatarit Pjetër, qilimbërësit Pal, dhe mamasë së Jezusit, të quajtur Mari). Është një fakt me rëndësi parësore: padyshim Roma është mposhtur. Është e vërtetë se në Rilindje pati një rizgjim mrekullisht shqetësues të idealit klasik, të mënyrës aristokrate në vlerësimin e gjërave: porsi dikush që ringjallet prej gjumit të vdekjes, vetë Roma po lëvizte nën peshën e Romës së re të çifutëzuar që ishte ndërtuar mbi atë të moçmen, që kishte tërë pamjen e një sinagoge ekumenike dhe quhej “Kishë”; por menjëherë Judea triumfoi sërish, falë asaj lëvizje të *ressentiment* thelbësisht plebeje (gjermane dhe angleze) të cilën e quajnë Reformë, bashkë me gjithçka që pasonte prej saj, restaurimin e Kishës – restaurim po ashtu edhe i paqes së vjetër mortore të Romës klasike. Me Revolucionin francez, Judea e shpartalloi edhe një herë idealin klasik në një formë edhe më përfundimtare dhe të thellë: aristokracia e fundit politike ekzistuese në Evropë, ajo e shekujve *francezë* XVII e XVIII u shemb nën instinktet popullore të *ressentiment*-it - kurrë ndonjëherë mbi tokë nuk është parë një jubile më i madh dhe një entuziazëm më i zhurmshëm se ky! Porse pikërisht në kulmin e tij ndodhi gjëja më madhështore e më e

papritura: vetë ideali antik u shfaq i tëri dhe i bëri para syve e ndërgjegjes së njerëzimit – ja edhe një herë përballë parullës së kahershme e të rreme të *primatit të shumicës*, përballë vullnetit për skadim, përdhosje, nivelim, ulje dhe perëndim të njeriut, tingëlloi më e qartë e më depërtuese se kurrë parulla e kundërt, e tmerrshme dhe magjepsëse, parulla e *primatit të pakicës*! Si shenjë e fundit e rrugës *tjetër* u shfaq Napoleoni, ky njeri krejtësisht i përveçëm, ky fryt i vonë tej çdo skaji si kurrkush tjetër, e bashkë me të problemi i mishëruar i *vetë idealit aristokrat* – merreni mirë parasysh se *çfarë* problemi madhor është ky - Napoleoni, kjo sintezë e *çnjerezores* dhe e *mbinjerzores*.

17.

-Pra paska marrë fund e gjithë kjo? Ajo kundërvënie idealesh, më e madhja në mes shoqeve, qenka vendosur *ad acta** përgjithmonë? Apo vetëm është shtyrë për një kohë të gjatë?... A nuk mund të ndodhë që në një çast të caktuar ardhmërie zjarri antik, pas një përgatitjeje shumë më të gjatë, të shpërthejë prapë edhe më shkatërrues? E për më shumë: a nuk duhet ta dëshirojmë me tërë fuqinë *këtë* gjë? Madje dhe ta duam? Madje dhe ta promovojmë?... Kushdo që tashmë sikundër lexuesit e mi, fillon të meditojë e t'i thellojë mendimet e tij, zor se ka për t'ia dalë në krye brenda një kohe të shkurtër – arsye që është e mjaftueshme për mua për t'ia dalë në krye gjithsesi, duke qenë se tashmë prej

* Lat.: term juridik me kuptimin "e zgjidhur", "e futur në dosje".

kohësh ajo që *dua* unë është bërë më se e qartë, ajo që dua pikërisht me atë parullën e rrezikshme që është e shkruar shprehimisht në librin tim të fundit: “Përtej të mirës dhe të keqes”... Në mos tjetër kjo nuk do të thotë: “Përtej të mirës dhe të ligës”...

Shënim. Gjej rastin që ma jep kjo esse të shpreh publikisht dhe formalisht një dëshirë që deri më sot e kam shfaqur vetëm në diskutime rastësore me njerëz të dijes: pra që një aksh fakultet i filozofisë të merrte meritën, përmes një serie konkursesh akademike, për përparimin në studimet e *historisë së moralit* – ndoshta ky libër mund të shërbejë për të dhënë një shtysë energjike pikërisht në këtë drejtim. Pyetjen e mëposhtme e parashtroj pikërisht në lidhje me një mundësi të tillë. Kjo pyetje meriton vëmendjen e filologëve dhe historianëve po aq sa edhe atë të filozofëve profesionistë. “Çfarë të dhënash na siguron shkenca gjuhësore, dhe sidomos hulumtimi etimologjik, për historinë e evoluimit të koncepteve morale?”.- Nga ana tjetër, është po aq e nevojshme që në këto lloj problemesh të fitohet edhe përfshirja e fiziologëve dhe mjekëve (mbi vlerën e kriterëve të gjykimit të përdorura deri më sot) – kësodore do mund t’u lihet në dorë filozofëve profesionistë mundësia për të ushtruar edhe në këtë rast patronazhin dhe ndërmjetësimin e tyre, pasi ata t’ia kenë dalë me sukses t’i transformojnë tërësisht marrëdhëniet ndërmjet filozofisë, fiziologjisë e mjekësisë, në një shkëmbim më se miqësor e të begatë. Të gjitha tabelat e vlerave, me një fjalë të gjitha “ti duhet”, të zbuluara prej etnologjisë, do të kishin nevojë para së gjithash për një qartësim dhe interpre-

tim *fiziologjik*, përpara atij *psikologjik*; më pas të gjitha këto tabela vlerash kanë nevojë për një kritikë nga ana e shkencës mjekësore. Pyetja se “Cila është vlera e asaj apo kësaj tabele “vlerash” dhe morali?”, duhet shtruar në këndvështrimet më të ndryshme; sidomos pyetja “e vlefshme për çfarë qëllimi” nuk shkokëlohet kurrë me hollësinë e duhur. Për shembull, diçka që do të kishte vlerë dukshëm lidhur me mundësinë e një jetëgjatësie më të madhe të një race (ose me fuqizimin e aftësive të saj për t’u përshtatur me një klimë të caktuar ose me ruajtjen e numrit më të madh të pjesëtarëve të saj), nuk do të kishte kurrsesi po atë vlerë nëse do të bëhej fjalë për të plazmuar një lloj më të fortë. E mira e shumicës dhe e mira e pakicës janë kritere të përkundërta vlerash; mëtimin se i pari ndër këto pikëvështrime ka një vlerë sipërane është diçka që ia duam t’ia lëmë nativitetit të biologëve anglezë... Tashmë të gjitha shkencat duhet të përgatisin terrenin për detyrën e ardhshme të filozofëve: duke nënkuptuar me këtë detyrë faktin se filozofi duhet të zgjidhë *problemin e vlerës*, duhet të përcaktojë *hierarkinë e vlerave*. -

ESEJA E DYTË

«FAJI», «NDËRGJEGJJA E KEQE» DHE TË NGJASHMET

1.

Rritja e një kafshe të cilës i *lejohet të bëjë premtime* – a nuk është pikërisht kjo detyra paradoksale që i ka vënë vetes natyra ndaj njeriut?... A nuk është ky problemi i vërtetë i njeriut?... Fakti që ky problem është zgjidhur deri në një gradë të lartë, do t'i duket gjithmonë e më befasues atij që di ta masë plotësisht forcën e ndajsh-tuar dhe të kundërt, pra atë të të *harruarit*. Të harruarit nuk është vetëm *vis inertiae**, siç besojnë sipërfaqësorët, është më tepër një forcë e të frenuarit, aktive dhe pozitive në kuptimin më të saktë të fjalës, forcë së cilës i detyrohet fakti se gjithçka që përjetojmë, mësojmë dhe mirëpresim brenda nesh, në gjendjen e tretjes (mund ta quajmë “përthithje intelektuale”) arrin aq pak në vetëdijen tonë, sa i gjithë procesi i shumëfishtë i ushqimit të trupit tonë, i ashtuquajtura proces “asimilimi”. Me mbyllë ndonjëherë portat dhe dritaret e vetëdijes, mos me e lanë veten me u ngacmue nga zhurma dhe nga lufta me të cilën bota okulte e organeve në shërbimin tonë shpërfaq bashkëpunimin dhe kundërshtimin e saj;

* Lat.: forcë e inercisë

pak qetësi, pak *tabula rasa*** e vetëdijes, për t'i bërë akoma vend diçkaje të re, sidomos funksioneve e funksionarëve më fisnikë, për të qeverisur, për të parashikuar, për të renduar (meqë organizmi ynë ka një strukturë oligarkike) – ky është avantazhi – siç u tha – i një të harruari aktiv, të ngjashëm me një gardian, me një ruajtës të rendit spiritual, të qetësisë, të etiketës: për këtë shkak do duhet vendosur në mënyrë të përnjëhershme, se në ç' masë s'ka lumturi, as paqtim, as shpresë, as krenari, as të tashme që është e mundur pa aftësinë për të harruar. Njeriu ku dëmtohet dhe zë të funksionojë në mënyrë të çrregullt ky aparat frenues, mund të krahasohet (dhe jo vetëm të krahasohet) me një dispeptik, që nuk arrin t'i "dalë në krye" asgjëje... Dhe pikërisht kjo kafshë me doemos harruese, ku të harruarët përbën një forcë, një formë shëndeti të *harlisur*, ka plazmuar me anë të edukimit një aftësi të përkundërt, një kujtesë, me ndihmën e së cilës mund të ndërpresë, në disa raste – procesin e të harruarit – në ato raste, pra, kur duhet bërë ndonjë premtim: jo vetëm një pamundësi për t'u çliruar nga përshtypjet e harruara tashmë, jo vetëm një mostretje e një fjale sakaq të lënë peng të cilës nuk i gjendet dhe filli, por një dëshirë për t'u bërë i lirë, një dëshirë e përsëritur dhe e vazhdueshme e asaj që është dëshiruar sakaq, një kujtesë e vërtetë e dëshirimit: kështu që mes parakes "unë dëshiroj", "unë do të bëj" dhe shkarkimit të vërtetë të vullnetit, *aktit* të tij, mund të ndërkallet kollaj një botë gjërash të reja dhe të ndryshme, rrethanash, por edhe aktesh vullneti, pa e këputur këtë vargan të gjatë

** Lat.: tabelë e fshirë, e bardhë. Koncept filozofik që ka kuptimin e diçkaje ende të paprekur, pa përvoja të mëparshme.

të dëshirimit. Por sa shumë gjëra presupozon e gjithë kjo! Sa shumë duhet të ketë mësuar njeriu në mënyrë që të mund të ketë paraprakisht në dorë të ardhmen, sa duhet të ketë mësuar ta ndajë mirë ngjarjen e domosdoshme nga ajo shkakësore, të mendojë sipas shkakësisë, të shohë dhe të parashikojë gjëra të largëta si të ishin të pranishme, të përcaktojë me saktësi se cili është qëllimi e cili është mjeti dhe, në përgjithësi, të dijë të llogarisë, të bëjë parashikime – për të bërë gjithë këtë, sa shumë duhet të jetë bërë vetë njeriu *i parashikueshëm, i rregullt, i domosdoshëm* edhe për veten e vet, për formën e vet të përshfaqjes, që të mund të hyjë dorëzanë më në fund për veten *si ardhmëri*, siç bën ai që premton!

2.

Dhe kjo është pikërisht historia e gjatë e zanafillës së *përgjegjësisë*. Ajo detyra për të rritur një kafshë që mund të bëjë premtime, përmban në vetvete, siç e kemi pikasur, si kusht dhe përgatitje, detyrën e menjëherëshme për ta *bërë* në krye të herës njeriun, deri diku, të paracaktuar, të njëtrajtshëm, të barabartë mes të barabartëve, përshtat rregullit e, për pasojë, të parashikueshëm. Puna e pamatë e atij që kam quajtur «moralitet i zakoneve» (shih *Agu i mëngjesit*) puna e vërtetë që njeriu duhet të kryejë mbi veten në hapësirën më të gjatë kohore të gjinisë njerëzore, e gjithë puna *parahistorike* e gjen këtu domethënien e saj, justifikimin e saj të madh, pavarësisht sa vrazhdësi, tirani, flegmatizëm dhe idiotizëm mbart ajo: falë moralitetit të zakoneve dhe këmishës së forcës shoqërore njeriu është *bërë* re-

alisht i parashikueshëm. Le të zhvendosemi përkundrazi në fundin e procesit të pamatë, atje ku pema i pjek më në fund frytet e saj, ku shoqëria dhe moraliteti i zakoneve të saj nxjerr më në fund në dritë qëllimin për të cilin ajo që thjesht mjeti: *individin sovran*, individin e barabartë vetëm me veten, të emancipuar rishitas nga moraliteti i zakoneve, individin autonom dhe mbi-moral (pasi «autonom» dhe «etik» janë terma që përjashtojnë njëri-tjetrin), shkurt, njeriun me vullnet të vetin, të pavarur, të durueshëm në kohë, të cilit *i lejohet të premtojë* – dhe tek ai një vetëdije krenare që vibron në çdo muskul, të *asaj çka* është mbërritur dhe është mishëruar tek ai, një vetëdije reale e fuqisë dhe lirisë, një ndjenjë përkryerje e njeriut në përgjithësi. Kjo qenie e çliruar, që realisht *mund* të premtojë, ky kryezot i vullnetit *të lirë*, ky sovran – a ka si të mos e dijë se se çfarë superioriteti ka fituar ai mbi ata të cilëve nuk u lejohet të premtojnë as të bëhen dorëzanë për veten e tyre dhe sa besim, sa frikë, sa blatim ngjall – ky i «*meriton*» të trija këto gjëra – dhe sesi, me dominimin e vetes, i jepet domosdo edhe dominimi i rrethanave, i natyrës dhe i të gjitha krijesave me vullnet më pak të vendosur dhe më pak të përgjegjshëm? Njeriu “i lirë”, padron i një vullneti të vendosur dhe të parrëzueshëm, gjen te ky proces edhe *kutin e tij të vlerës*: duke iu hedhur të tjerëve vështrimin e tij, ai nderon ose përçmon; dhe me të njëjtën domosdoshmëri me të cilën nderon të ngjashmit e vet, të fortët dhe besnikët (të cilëve u *lejohet* të premtojnë), pra gjithsecilin që premtonte mbretërisht, me të vështirë, rrallë e pa ngut, nopranë po që për ta falur besimin e tyre, që, kur premtonte, *të shënojë një dal-*

lim, dhe që e jep fjalën si diçka për t'i zënë besë sepse do jenë bërë të fortë mjaftueshëm sa të mund ta mbajnë pavarësisht çdo fatkeqësie, edhe «kundër fatit» – me po të njëjtën vendosmëri do t'i ketë gati shqelmat për zagarët langaraqë që premtajnë pa pasur tagrin, dhe kamxhikun për gënjeshtarin që e tradhton fjalën e vet pikërisht në çastin kur e shqipton. Vetëdija krenare e privilegjit të jashtëzakonshëm të *përgjegjësisë*, vetëdija e kësaj lirie të rrallë, e kësaj fuqie mbi veten dhe mbi fatin, kanë depërtuar tek ai deri në sferat më të thella, për t'u bërë instinkt, instinkt mbizotërues – si do ta quajë ai këtë instinkt mbizotërues, gjithmonë nëse ndjen tek vetja nevojën e një termi për ta përçanësuar? Por nuk ka dyshim: ky njeri sovran e quan atë *vetëdijen* e tij...

3.

Vetëdijen e tij?... Mund të pikaset lehtë e paraprakisht se koncepti i vetëdijes, të cilin e ndeshim këtu në trajtën e tij më të përkryer, më të lartë dhe gati befasuese, ka sakaq pas vetes një histori dhe metamorfozë të gjatë trajtash. Të mund të bëhesh dorëzanë për veten dhe me krenari, pra të mund *t'i thuash po* edhe vetes – kjo, siç u tha, është një frut i pjekur, por edhe një frut *i vonë* – por sa shumë kohë u desh që ky frut i athët e i hidhur të rrinte në pemë! Dhe për një periudhë kohe akoma shumë më të gjatë, këtij fruti nuk iu pa asgjë – askush nuk do kishte mundur ta premtonte, edhe pse pema po rritej, e gjitha e tendosur pikërisht për ta lindur këtë frut! «Si krijohet kujtesa tek kafsha njeri? Si ngulitet tek ky intelekt i çastit, pjesërisht i mpirë, pjesër-

isht përhumbës, te kjo harresë e gjallë, si ngulitet pra aq thellë diçka që të ngelet e pranishme?»... Ky problem shumë i lashtë, siç mund të merret lehtë me mend, nuk është zgjidhur bash me përgjigje dhe mjete të buta: mbase nuk ekziston, në tërë prehistorinë e njeriut, asgjë më e tmerrshme dhe e mistershme se *mnemoteknika* e tij. «Diçka damkoset me zjarr për ta shtypur në kujtesë: vetëm ajo që s'pushon së dhemburi, ngelet në kujtesë» - ky është një parim themelor i psikologjisë më antike (dhe për fat të keq, edhe më kohëgjatë) mbi tokë. Mund të thuhet gjithashtu, se kudo ku ekzistojnë akoma në tokë solemnitete, seriozitete, mister, ngjyra të errëta në jetën e njerëzve dhe popujve, *vepron akoma a posteriori* diçka nga tmerri me të cilin gjithkund mbi tokë dikur bëheshin premtime, jepeshin pengje, thureshin lavde: e kaluara, e kaluara më e gjatë dhe më e ashpër, që merr frymë pranë nesh dhe gurgullon ndër ne, kur bëhemi «hijerëndë». Sa herë që njeriut i është dukur e domoshme të krijonte një kujtesë, kjo nuk ka ndodhur kurrë pa gjak, tortura, flijime; flijimet dhe pengjet më mizore (mes të tjerash, flijimi i të parëlindurve), gjymtimet më të krupshme (për shembull tredhjet), format rituale më mizore të të gjithë kulteve fetare (dhe të gjitha fetë janë, në themelin e tyre të skajshëm, sistem mizorish) - gjithçka e ka zanafillën tek ai instinkt që tek dhimbja pá mjetin më të fuqishëm ndihmës për mbamendjen. Në njëfarë kuptimi i gjithë asketizmi përfshihet te kjo: disa ide duhen bërë të pashlyeshme, të gjithëpranishme, të paharrueshme, "fikse", për hipnotizimin e të gjithë gjendjes së sistemit nervor dhe intelektual pikërisht falë këtyre "ideve fikse" - dhe procedurat, sikurse for-

mat e jetës asketike, janë mjete për t'i çliruar këto ide nga konkurenca me të gjitha të tjerat, për t'i bërë "të paharrueshme". Sa më keq të ishte njerëzimi "në punë kujtese", aq më e tmerrshme ka qenë pamja e përdorimeve të saj; ashpërsia e legjislacionit penal në veçanti e jep përmasën e vështirësisë që kanë hasur njerëzit për të arritur harresën, dhe për t'ua mbajtur gjithnjë parasysh disa nevoja parake të bashkëjetesës sociale, atyre që ishin skllëverit e çdo emocioni e çdo dëshire të çastit. Ne gjermanët sigurisht nuk konsiderohemi një popull fort mizor dhe zemërgur, aq më pak mund të konsiderohemi si popull sipërfaqësor dhe që kënaqet duke jetuar ditën. Por mjafton vetëm t'i hedhim një sy rendeve tona të lashta penale për të kuptuar përmjeherësh se sa mund kushton, mbi tokë, të rrisësh një "popull mendimtarësh" (dua të them: *popullin* e Evropës, në gjirin e të cilit sot është e mundur të gjesh maksimumin e besimit, seriozitetit, objektivitetit dhe të mungesës së shijes, dhe që falë këtyre cilësive ka të drejtë të rrisë lloj-lloj mandarinësh në Evropë). Këta gjermanët kanë krijuar një kujtesë me mjete të tmerrshme, për t'ia mbërritur bërjes zap të instinkteve të tyre plebeje dhe vrazhdësisë së tyre brutale: mendoni për dënimet e lashta gjermane, për shembull vrasja me gurë (- e para saga rrëzon mbi kokën e fajtorit gurin e mullirit), deri te tortura e rrotës (më tipikja ndër shpikjet dhe specialitetet e gjenit gjerman në fushën e dënimeve!), tek ajo e shtyllës, tek ajo e copëtimit dhe shkeljes së fajtorit nga kuajt ("shqyerja"), tek ajo e zierjes së fajtorit në vaj ose në verë (ende në shekullin e XIV dhe XV), tek rrjepja e përzgjedhur, tek shkulja e mishit nga kraharori; si

dhe tek tortura e lyerjes së keqbërësit me mjaltë dhe braktisja e tij në mëshirë të mizave, nën diellin përcël-
 lues. Falë këtyre imazheve dhe këtyre veprimeve si
 përfundim fiksohen në kujtesë ato pesë apo gjashtë
 “nuk dua”, në lidhje me të cilat është bërë *premtimi* me
 qëllim për të jetuar me avantazhet e shoqërisë – dhe me
 të vërtetë, falë kësaj lloj kujtese u mbërrit më në fund
 “tek arsyeja”! – Ah arsyeja, serioziteti, zotërimi mbi
 afektet, gjithë kjo çështje e errët që quhet refleksion, të
 gjithë këto privilegje dhe emblema mburrje të njeriut:
 sa shtrenjtë kanë kushtuar! Sa gjak dhe tmerr ka në
 themel të të gjithë «gjërave të mira»!...

4.

Por përse vallë ka ardhur në botë kjo “çështje e errët”,
 ndërgjegja e fajit, gjithë “ndërgjegja e keqe”? – Dhe
 me këtë kthehemi tek gjenealogjistët tanë të moralit.
 E them edhe një herë – apo s’e kam thënë ende asnjëherë?
 – ata nuk vlejnë asgjë. Një përvojë vetjake, jo
 më e gjatë se pesë pëllëmbë, thjesht “moderne”; kurr-
 farë dijeje, kurrfarë vullneti për ta njohur të kaluarën;
 instinkt historik më pak se kurrë, një “shikim i dytë” i
 nevojshëm pikërisht në këtë çast – e prapë merren me
 historinë e moralit: dhe kjo qartazi duhet të përfundojë
 në rezultate që nuk kanë një raport mirëfilli përbuzës
 me të vërtetën. Këta gjenealogjistët tanë të moralit a
 kanë menduar ndonjëherë, qoftë edhe për së largu se,
 për shembull, ai koncept themelor i “fajit” e ka zanafil-
 lën e vet nga koncepti shumë material i “borxhit”? Ose
 që dënimi si *shpagë* është zhvilluar duke anashkaluar

absolutisht çdo hamendje mbi lirinë a moslirinë për të dashur? – dhe kjo deri në pikën ku përndryshe lind pikësëpari nevoja për një nivel të lartë humanizimi, që kafsha “njeri” të fillojë të bëjë ato dallime shumë më primitive si “qëllim”, “neglizhencë”, “e rastësishme”, “e përgjegjshme” dhe të kundërtat e tyre, e t’i peshojë ato në dhënien e dënimit. Ai mendim që sot është kaq i lirë e në dukje kaq i natyrshëm dhe i pashmangshëm, të cilit na është dashur t’i drejtohem gjithmonë për të shpjeguar se si ka zënë fill mbi tokë ndjenja e drejtësisë, mendimi pra se “krimineli meriton të dënohet *pasi* do të kishte mundur të vepronte ndryshe”, është në fakt një formë absolutisht e vonuar, madje e rafinuar, e gjykimit dhe deduktimit njerëzor; ai që e zhvendos këtë gjykim tek zanafillat, bën një gabim të trashë në lidhje me psikologjinë e njerëzimit më antik. Në harkun më të gjatë kohor të historisë njerëzore, *nuk* janë dhënë dënime *pasi* ai që e kishte bërë të keqen konsiderohej përgjegjës për veprimin e vet, pra *jo* sipas premisë se duhet dënuar vetëm fajtori - por, përkundrazi, ai dënohej siç i dënojnë prindërit ende sot bijtë e tyre, prej zemërimit për një dëm të pësuar, që shfryhet mbi autorin e dëmit – zemërim ky, i kontrolluar dhe i ndryshuar nga ideja se çdo dëm ka të *barasvlershmen* e tij dhe se mund të zhdëmtohet, qoftë edhe me anë të *dhimbjes* së atij që e ka shkaktuar. Nga e ka përftuar forcën e vet kjo ide shumë e lashtë, me rrënjë shumë të thella që mbase sot nuk mund të çrrënjosen më, do me thënë ideja e një barazvlere të dëmit dhe dhimbjes? Unë e kam zbuluar sakaq në marrëdhënien kontraktuale mes *kreditorit* dhe *debitorit*, që është aq i lashtë sa janë edhe “subjektet e

së drejtës", dhe i cili na shpie edhe njëherë, vetiu, tek format themelore të blerjes, shitjes, shkëmbimit dhe tregtisë.

5.

Pa dyshim, të menduarit e këtyre raporteve kontraktuale, zgjon, sikurse është e natyrshme të pritët pas asaj që vëzhguam përpara, çdo lloj dyshimi dhe rezistence kundër njerëzimit më antik që i ka krijuar apo premtuar ato. Pikërisht këtu bëhen *premtimet*; pikërisht këtu bëhet fjalë për të *fabrikuar* një kujtesë për atë që premtton; pikërisht ky do ketë një bazë ku do zbulohen gjëra të vrazhda, mizore, të pakëndshme. Për ta bërë të besueshëm premtimin tij për rikthim, për t'i garantuar seriozitetin dhe shenjtërimin e premtimit, për t'i imponuar vetes dhe vetëdijes rikthimin si një detyrë, si një obligim, debitori ofron me një kontratë, si peng për kreditorin në rast të ndonjë moszbatimi të mundshëm, diçka që ai akoma "zotëron", diçka mbi të cilën ka ende pushtet, për shembull trupin e vet, gruan e vet, lirinë ose dhe jetën e vet (ose, sipas do premisave religjioze, deri edhe lumnimin e vet, shpëtimin e shpirtit të vet, dhe në fund, edhe paqen e varrin: si në Egjipt, ku as në varr kufoma e debitorit nuk gjente paqe nga kreditori – dhe pikërisht për egjiptasit kjo paqe kishte një kuptim të veçantë). Por pikërisht kundër trupit të debitorit kreditori mund të përdorte çdo lloj lëndimi dhe torture, për shembull duke i prerë aq pjesë sa mendonte ai se ishin në përpjesëtim me shumën e borxhit. Dhe pikërisht nga kjo mënyrë të pami zunë fill shumë

shpejt dhe kudo parametra vlerësues shumë të saktë, pjesërisht mizorë në detajet e tyre të vogla dhe imcake, vlerësime, të fiksuara në mënyrë *legjitime*, për gjymtyrët e veçanta dhe pjesët e trupit. Mëtoj se përbën sakaq një hap përpara prova e një konceptimi më të lirë të së drejtës, më zemërgjerë, *më romak*, fakti se në Romë dymbëdhjetë pllakat dekretinin se duhej konsideruar si diçka e parëndësishme çështja se sa prenin kreditorët nga trupi i kreditorit, “si plus minusve secuerunt, ne fraude esto*”. Le ta sqarojmë logjikën e gjithë këtij lloj kompensimi: ajo nuk është dhe aq e zakonshme. Barasvlera rrjedh nga fakti se përkundër një avantazhi që i referohet direkt dëmit (pra, në vend të një dëmshpërblimi në parà, në tokë a prona të ndryshme) i lejohet kreditorit njëfarë *kënaqjeje e brendshme* si rimbursim i borxhit dhe dëmshpërblim – kënaqësia që të mund ta shfryjë lirisht fuqinë e vet kundrejt një të pafuqishmi, epshi “*de faire le mal pour le plaisir de le faire*”*, qejfi i përdorimit të dhunës: kënaqësi që si e tillë vlerësohet gjithë e më shumë sa më i papërfillshëm dhe i mjerueshëm që është kreditori në rendin e shkallës shoqërore, dhe që mund t’i duket debitorit një kafshatë e shijshme, madje si ngjërim i një rangu më të ngritur. Nëpërmjet “ndëshkimit” të debitorit, kreditori merr pjesë te një *e drejtë zotnie*; më në fund mund të shijojë ndjenjën këndellëse të përçmimit dhe keqtrajtimit të një qenie njerëzore si diçka që është “poshtë tij” – a të paktën, në rastin kur zbatimi i një dënimi iu ka kaluar sakaq “autoriteteve”, ta *shohë* të përçmuar dhe të keqtrajtuar. Kompensimi

* Lat.: pret më pak apo më shumë, nuk ka rëndësi. * Fr. të bësh keq vetëm nga kënaqësia.

qëndron pra tek një mandat dhe tek një e drejtë mizore.

6.

Në këtë sferë, në të drejtën e detyrimeve pra, e ka vatrën e saj të parë bota e koncepteve morale të “fajit”, “vetëdijes”, “detyrës”, “shenjtërisë së detyrës”. Fillesat e saj, si ato të çdo gjëje që është e madhe në tokë, janë njomur gjatë dhe në thellësi nga gjaku. Dhe a s’do ishte e drejtë të shtonim se në fund, asaj bote nuk i është shqitur kurrë më një kundërmim gjaku dhe torture? (edhe te plaku Kant: imperativi kategorik ka shijen e mizorisë...). Dhe njësoj këtu është përsëritur për herë të parë ai zinxhir i mbrapshtë idesh, “faji dhe vuajtja”, që mbase është bërë i pazgjidhshëm. Dhe ta pyesim prapë veten: në ç’kuptim mund të jetë dhimbja kompensim i “borxheve”?

Për arsye se *shkaktimi* i vuajtjes prodhon shkallën më të lartë të kënaqjes, për shkak se i dëmtuari merrte në këmbim të humbjes (shto këtu edhe pakënaqësinë për dëmin) një kundër-kënaqësi të jashtëzakonshme, atëherë shkaktimi i vuajtjes që një *festë* e vërtetë, diçka që, siç u tha, vlerësohej gjithmonë më shumë, sa më shumë që kundërshtonte rangun dhe pozitën shoqërore të kreditorit. Këto thuhet si hamendësim: pasi është shumë e vështirë të arrish në fund të këtyre gjërave të nëndheshme, pavarësisht faktit se është edhe e mjerueshme; dhe ai që ndërkaq ngathtëzi këtu konceptin e “hakmarrjes”, nuk bën tjetër përpos që vesh dhe mbulon sytë në vend që t’i bëjë më të mprehtë (edhe hakmarrja shpie

pikërisht tek i njëjti problem: “si është e mundur që të shkaktuarit e vuajtjes përfaqëson një zhdëmtim?”). I kundërvihet, më duket mua, delikatesës, e akoma më shumë hipokrizisë së kafshëve të zbutura shtëpiake (aludoj për njerëzit modernë, aludoj për ne), të imagjinosh me intensitetin më të madh të mundshëm deri në ç’gradë *mizoria* përbën lumturinë më të madhe festive të njerëzimit më të lashtë, dhe madje përzihet si ingredient, me gati të gjitha gëzimet e tij; nga ana tjetër, me sa naivitet dhe me sa pafajësi shpërfaqet nevoja e tij për mizori, dhe se si pikërisht “ligësia” e çinteresuar (ose, për ta thënë me Spinozën, *sympathia malevolens*) vendoset në mënyrë themelore prej tij si cilësi *normale* e njeriut. Tek *Përtej të mirës dhe të keqes*, (edhe më përpara tek *Agu i mëngjesit*) kam përmendur me kujdes spiritualizimin dhe “hyjnizimin” gjithnjë në rritje të mizorisë, që rend përmes të gjithë historisë së qytetërimit superior (dhe, marrë në një konotacion domethënës, madje e sendërton). Sidoqoftë, nuk ka kaluar dhe aq shumë kohë qysh kur nuk arrihej të imagjinoheshin dasma princash dhe festa popullore me salltanet pa ekzekutive kapitale, tortura e qoftë edhe një auto-da-fe*, dhe as të imagjinohej një qeverisje aristokratike e shtëpisë pa individë mbi të cilat të mund të shpërthehej lirisht ligësia dhe talljet mizore (– le të kujtojmë për shembull Don Kishotin në oborrin e dukeshës: sot ne e lexojmë tërë *Don Kishotin* me një shije të hidhur në gojë, gati duke u torturuar, dhe për këtë mbase do të ishim të huaj, shumë të errët për autorin dhe bashkëkohësit e tij

* Spanj. akt besimi. Quheshin kështu dënimet kapitale që jepte Inkuizicioni spanjoll dhe portugez ndaj heretikëve.

- ata e lexonin me vetëdijen më të qetë në botë, si librin më të paqtë, dhe sa s'vdisnin së qeshuri). Të shohësh të tjerët tek vuajnë të bën mirë, ta shkaktosh vuajtjen të bën akoma më mirë - kjo është një sentencë e ashpër, por prapë një sentencë themelore, antike, e fuqishme, njerëzore - tepër njerëzore, që mbase edhe majmunët do ta miratonin: në fakt thuhet se ata, duke shpikur mizori të çuditshme, e pathonë në shumëçka njeriun dhe janë, simethënë, "preludi" i tij. Pa mizori nuk ka festë: këtë mëson më e hershmja, më e gjata histori e njeriut - por edhe dënimi ka në vetvete goxhà *pamje festive!*

7.

- Për ta thënë shkarazi, me këto mendime nuk dua aspak që të ndihmoj pesimistët tanë të çojnë ujë të ri në mullinjtë e çjerrë dhe cijatës të mërzisë së tyre nga jeta; përkundrazi, duhet dëshmuar shprehimisht se atëbotë, kur njerëzimit nuk i vinte ende turp prej mizorisë së vet, jeta në tokë ishte shumë më e paqtë se sot që ekzistojnë pesimistët. Errësimi i qiellit mbi njerëzit ka ardhur gjithnjë duke u rritur në përpjestim me rritjen e turpit të njeriut *përballë njeriut*. Shikimi i lodhur pesimist, mosbesimi përballë enigmës së jetës, jo-ja e akullt e neverisë ndaj jetës - a nuk janë këto shenjat e epokave *më të liga* të gjinisë njerëzore? Madje ato, si bimë moçalore që janë, dalin në dritë të diellit vetëm kur ekziston moçali të cilit i përkasin - nënkuptoj këtu squlljen dhe demoralizimin e sëmurë, për shkak të të cilit bisha "njeri" mëson, përfund, të ketë turp nga të gjithë instinktët e veta.

Në rrugën drejt "engjëllit" (që të mos përdorim këtu një fjalë më të ashpër) njeriu ka ardhur duke vënë atë stomak të sëmurë dhe atë gjuhë veshtullore, për shkak të të cilëve i janë bërë të neveritshme jo vetëm gëzimi dhe pafajësia e kafshës, por i është bërë e amësht edhe vetë jeta – aq sa nganjëherë qëndron përballë vetes duke mbyllur hundën dhe me papën Inoçenti i Tretë përpilon, me dënim, katalogun e gjithçkaje që e neverit ("ngjizja në mëkat, ushqimi krupëndjellës i trupit amësor, mjerimi i lëndës prej të cilës njeriu është zhvilluar, kutërbimi mizor, sekretimi i pështymës, urina dhe fekalet"). Tani që dhimbja duhet të vihet në ekspozé si i pari ndër argumenten *kundër* ekzistencës, si pikëpyetja e saj më e mbrapshtë, do të bënim mirë të kujtonim ato kohë kur gjykimi ynë ishte i kundërt, ngaqë nuk dëshironte njeri të hiqte dorë nga të *shkaktuarit* dhimbje dhe te kjo gjë shihej një magji e dorës së parë, një karrem i vërtetë që të joshte *për* të jetuar. Mbase atëherë – ta themi për ngushëllimin e shpirtave delikatë – dhimbja nuk ishte aq e madhe sa sot; të paktën ky ka për të qenë përfundimi i mjekut që do të ketë kuruar zezakë (duke i marrë si përfaqësues të njerëzve prehistorikë –) në raste të rënda inflamacionesh të brendshme, që e çojnë në prag të dëshpërimit edhe evropianin më të përkryer organikisht – zezakëve kjo nuk iu ndodh. (Kurba e rezistencës njerëzore ndaj dhimbjes në fakt duket se precipiton në mënyrë të jashtëzakonshme dhe gati të papritur, posa ke pas vetes dhjetëmijë apo dhjetë milionë të parët që i përkasin një qytetërimi superior; dhe për aq sa më takon nuk kam dyshime se, në krahasim me një natë dhimbjesh të një femre hysterike të

emancipuar, vuajtjet e të gjithë kafshëve që deri më sot janë pyetur me thikë me qëllimin për të marrë përgjigje shkencore, nuk janë as për t'u marrë në konsideratë.) Mbase është legjitime të pranohet mundësia që edhe kënaqësia e mizorisë nuk duhet të jetë shuar mirëfilli: ajo do të kishte nevojë vetëm për njëfarë sublimimi dhe për njëfarë dëlirësimi, duke e lidhur me faktin se dhimbja dhemb më shumë; në veçanti duhet të përshfaqet e përkthyer në elementin imagjinar dhe shpirtëror, e stolisur me emra thjesht kaq të padëmshëm sa të mos zgjojë asnjë dyshim as në ndërgjegjen më delikate dhe hipokrite ("mëshira tragjike" është një nga këto emra; tjetër është "*les nostalgies de la croix*"*. Ajo çka të revoltonte përballë dhimbjes, nuk është dhimbja në vetvetë, por absurditeti i dhimbjes: por as për të krishterin, që ka transferuar tek dhimbja një mekanizëm të tërë të mistershëm shpëtimi, as për njeriun e thjeshtë të epokave më të lashta, që dinte ta interpretonte çdo dhimbje në raport me spektatorin ose me atë që e shkaktonte të keqen, nuk ekzistonte kjo dhimbje *absurde*. Në mënyrë që dhimbja e nëndheshme, e pazbuluar, pa dëshmitarë, të hiqej nga bota dhe të mohohet ndershmërisht, që gati e detyrueshme të shpikeshin hyjni dhe qenie të ndërmjetme të gjithfarë lartësie e thellësie, shkurt, diçka që lëviz edhe në fshehtësi, që sheh edhe në terr dhe që nuk e lë t'i ikë lehtë një spektakël interesant i dhimbshëm. Falë këtyre shpikjeve, jeta u esnafizua, në stratagjemin, ku gjithmonë ka qenë esnafa, e përlijjes së vetvetes, e përlijjes së "të keqes" së saj; sot, mbase

* Fr.: nostalgjitë e kryqit

pikërisht për këtë arsye, do të duheshin shpikje të tjera ndihmëse (për shembull jeta si enigmë, jeta si problem i njohjes). “Është e përligjur çdo e keqe, spektakli i të cilës këndell një zot”: kështu tingëllonte logjika primitive e ndjenjës – dhe në të vërtetë, a ishte veç ajo primitive? Perënditë e menduara si të dhëna pas spektakleve *mizore* – oh, sa shumë grafullon brenda humanizimit tonë evropian kjo ide e stërlashtë, mund t’u lypet këshillë Kalvinit dhe Luterit në lidhje me këtë. Është e sigurt, megjithatë, se deri dhe grekët nuk dinin t’u ofronin perëndive të tyre kurrfarë sajdisje më të pëlqyeshme për lumturinë e tyre se gëzimet e mizorisë. Me çfarë sysh kujtoni ju se i bën Homeri perënditë e tij ta shohin fatin e njeriut? Ç’kuptim të fundëm patën, tekembramja, luftërat trojane dhe tmerre të tilla të ngjashme tragjike? Nuk ia vlen të vihet në dyshim: shiheshin si *spektakle feste* për perënditë, dhe për faktin se poeti, në këtë gjë, ka një natyrë shumë më “hyjnore” se njerëzit e tjerë, pasi ato ishin edhe festa për poetët... Po kështu, filozofët grekë të moralit më vonë imagjinuan se i shihnin perënditë të hedhur mbi konfliktet morale, mbi heroizmin dhe mundimet e vetëshkaktuara të atij që është i virtytshëm: “Herkuli i detyrës” ishte mbi një palk skenik, dhe e dinte më së miri këtë gjë; virtyti pa dëshmitarë, ishte për këtë popull aktorësh diçka absolutisht e pakonceptueshme. Ajo shpikje aq e guximshme dhe fatale e filozofëve, që atëbotë u fut për së pari në përdorim në Evropë, shpikja e “vullnetit të lirë”, e spontanitetit absolut të njeriut në të mirë dhe në të keqe, a nuk qe vallë për t’i dhënë status një të drejtë idesë se interesi i perëndive

për njeriun, për virtytin njerëzor, *nuk mund të pakësohet kurrë?* Mbi këtë skenë tokësore nuk duhej të mungonte kurrë gjëja realisht e re, tensionet, ngatërresat, katastrofat: një botë e menduar në mënyrë krejt deterministe do të kishte qenë e thjeshtë për t' u parashikuar nga perënditë e, për pasojë, në një hark të shkurtër kohe do ishte edhe e bezdisshme – shkak ky i mjaftueshëm për ata *miq të perëndive*, filozofët, për të mos pretenduar nga perënditë një botë të tillë deterministe! Tërë njerëzimi i lashtë është plot me pekule delikate për “spektatorin”, si një botë thelbësisht publike, thelbësisht e shfaqur, që nuk dinte ta imagjinonte lumturinë pa spektatorë dhe festa. – E siç e thashë njëherë, edhe tek *ndëshkimi* i madh ka goxhà pamje festive!...

8.

Që të rimarrim fillin e kërkimit tonë, ndjenja e fajit, e detyrimeve tona personale, siç e kemi parë, i ka pasur rrënjët e veta në marrëdhënien ndërpersonale më të lashtë e zanafillore që ka ekzistuar ndonjëherë, në marrëdhënien mes blerësit dhe shitësit, kreditorit dhe debitorit: këtu, për herë të parë, ballafaqohet personi me personin, këtu, për herë të parë, personi *u mat* me personin. Ende nuk është gjetur një gradë aq e ulët civilizimi sa të mos vihej re diçka nga kjo marrëdhënie. Vendosja e çmimeve, matja e vlerave, shpikja e të barasvlershmeve, shkëmbimi kokë më kokë – e gjithë kjo e ka shqetësuar mendimin më të lashtë të njeriut në atë masë saqë, njëfarësoj, të menduarit është e *gjithë kjo*: këtu është kultivuar forma më

e lashtë e mendjemprehtësisë, kjo mund të supozohet edhe si përudhja e parë e krenarisë njerëzore, ndjenja e epërsisë kundrejt kafshëve të tjera. Mbase fjala jonë "*Mensch*" (*manas*) shpreh pikërisht një pjesë të *kësaj* ndjenje për veten: njeriu përkufizohej si qenie që përcakton vlera, vlerëson dhe mat sepse është "kafsha vlerësuese në vetvete". Shitblerja, me të gjithë ndajshitesat e saj psikologjike, është më e lashtë edhe se fillimet e çdo forme tjetër të organizmit social dhe të shoqërizimit: kurse ndjenja e shkëmbimit, kontratës, borxhit, detyrimit, kompensimit që po çelte, përkundrazi, është *zhvendosur* pikësëpari nga forma më rudimentare e së drejtës personale tek komplekset komunitare më të palatuara dhe parake (në raportet e tyre me komplekse të ngjashme), tok me zakonin për të krahasuar fuqinë me fuqinë, për të matur dhe llogaritur. Syri që përshtatur tashmë me këtë perspektivë: dhe me atë vijimësi të palatuar, që është karakteristike e mendimit të njerëzimit më të hershëm, që i ngadaltë në lëvizje por mandej i pamëshirshëm për të çarë përpara në një drejtim të vetëm, u mbërrit shumë shpejt, me përgjithësim të madh, tek "çdo gjë ka çmimin e vet; gjithçka mund të blihet" - tek kanoni moral më i lashtë dhe naiv i *drejtësisë*, tek fillimi i çdo "shpirtmirësie", çdo "barazie", çdo "vullneti të mirë", çdo "objektiviteti" mbi tokë. Në këtë nivel të parë, drejtësia është vullneti i mirë mes njerëzve gati të barabartë për nga fuqia, për të rënë në ujdi pala me palën, për t'u "marrë vesh" prapë me një ujdi - dhe, në lidhje me më pak të fuqishmit, për t'i *detyruar* të bëjnë një marrëveshje mes tyre. -

9.

I matur gjithnjë me metrin e fillesave (fillesa të cilat, nga ana tjetër, ekzistojnë në çdo epokë, ose janë edhe një herë të mundshme), edhe komuniteti qëndron me anëtarët e vet në atë raport themelor kaq të rëndësishëm, i cili është ai i kreditorit kundrejt debitorëve të tij. Njeriu jeton në një komunitet, gëzon avantazhet e një komuniteti (oh, çfarë avantazhesh! sot nganjëherë i nënvlerësojmë), banon i mbrojtur, i strehuar, në paqe dhe mirëbesim, i qetë në lidhje me disa dëmtime dhe akte armiqësore, të cilave iu ekspozohet njeriu *i jashtëm*, "i përjashtuari" - gjermani e njeh mirë domethënien zanafillore të "Elend"* (*êlend*) -, sepse pikërisht për shkak të këtyre dëmtimeve dhe akteve armiqësore janë marrë angazhime e detyrime karshi komunitetit. Çfarë ka për të ndodhur në rastin tjetër? Komuniteti, kreditori i mashtruar, do të marrë shpagën më të kënaqshme, për këtë mund ta flemë mendjen. Këtu është në diskutim, të paktën, dëmi i menjëhershëm, që dëmtuesi ka shkaktuar: pavarësisht kësaj, ai që bën keq është sidomos ai që "prish", që shkel kontratën, ose s'e mban fjalën e dhënë ndaj të gjithës, për sa i takon të gjitha të mirave dhe lezeteve të jetës komunitare, tek të cilat ka pasë pjesë deri në atë çast. Keqbërësi është një debitor që jo vetëm nuk dëmshpërblen avantazhet dhe paradhëniet që ka gëzuar, por që kalon madje në sulm ndaj kreditorit të tij: nga çka rrjedh qartazi, se duke u nisur nga ai çast jo vetëm që i humbet të gjitha këto të mira dhe avan-

* Lat.: mjerë viktimat. [Sh. i përkth. A. C.]

tazhe, por paralajmërohet madje se ç'është kanë këto të mira. Mëria e kreditorit të dëmtuar, e komunitetit, e rikthen debitorin në gjendjen e egër dhe absolutisht të jashtëligjshme nga e cila pat qenë deri në atë moment i mbrojtur: e përzë nga gjiri i vet – dhe që nga ky moment mund të ushtrohet kundër tij çdo lloj armiqësie. “Dënimi”, në këtë nivel qytetërimi, nuk është tjetër pos riprodhimit, *mimus*-it të sjelljes normale kundër njeriut të urryer, të çarmatosur dhe të mposhtur, që ka humbur jo vetëm çdo të drejtë dhe mbrojtje, por edhe çdo mëshirim; pra e drejta e luftës dhe celebrimi i fitores së *vae victis!** në tërë pamëshirësinë dhe mizorinë e saj – nga kjo shpjegohet sesi vetë lufta (përfshi kultin flijues të luftëtarëve) ka ofruar të gjitha *format* në të cilat jepet dënimi në histori.* Gjerm.: mjerim

10.

Një komunitet, me të përftuar më shumë fuqi, nuk i merr më aq seriozisht shkeljet individuale, sepse ato nuk mund të konsiderohen më, në atë masë si përpara, aq të rrezikshme dhe revolucionare për qëndrueshmërinë e së tërës: shkelësi nuk “nxirret jashtë ligjit” as nuk dëbohet më, mëria e përgjithshme nuk mund të shpërthejë më kundër tij në mënyrë të shfrenuar si më parë – madje në të kundërt, duke filluar nga ai çast, keqbërësi do jetë i mbrojtur dhe i ruajtur me kujdes nga komuniteti kundër kësaj mërie dhe veçanërisht kundër mërisë së atyre që janë dëmtuar drejtpërsëdrejti. Kompromisi me mërinë e atyre që janë goditur më shumë se të gjithë nga

keqbëria; një orvatje për të lokalizuar rastin dhe për të parandaluar një pjesëmarrje dhe një gjendje ankthi më të gjerë dhe më të përgjithshme; orvatja për të gjetur ekuivalentet e për të sistemuar tërë ngjarjen (*compositio*); mbi të gjitha vullneti, që përparon gjithnjë e më i vendosur, për të trajtuar çdo shkelje si të *kompensueshme me para*, pra për të izoluar, të paktën deri në njëfarë mase, keqbërësin nga veprimi i tij – ja tiparet që janë ngulitur gjithmonë e më haptazi në zhvillimin e mëtejshëm të së drejtës penale. Duke u rritur forca dhe vetëdija e një komuniteti, edhe e drejta penale zbutet, çdo dobësim dhe çdo gjendje më e thellë rreziku nxjerr sërish në dritë forma më të ashpra se kjo. “Kreditori” është bërë gjithmonë e më njerëzor dora-dorës që pasuria e tij është shtuar: në fund është bërë pikërisht *masë* e pasurisë së tij aftësia për t’i duruar dëmet pa vuajtur. Nuk do ishte e pakonceptueshme një *vetëdije fuqie* nga ana e shoqërisë, për të cilën ajo të mundej t’ia lejonte vetes luksin më aristokratik të mundshëm – të lërë të *pandëshkuar* ata që e sulmojnë. “Ç’punë kam me parazitët e mi?” mund të thotë. “Të rrojnë e të begatohen: jam akoma mjaft e fortë sa t’ia lejoj vetes!” ... Drejtësia, që kishte filluar me “gjithçka kompensohet me para, gjithçka duhet të kompensohet me para”, përfundon duke mbyllur një sy dhe duke i lënë të lirë mos-shlyesit – përfundon, si çdo gjë e mirë në tokë, *duke asgjësuar vetveten*. Ky vetasgjësim i drejtësisë: dihet se me çfarë emri të bukur quhet – *falje*; ngelet, siç është e dukshme, privilegji i më të fuqishmit, më mirë akoma, të qenit e tij përtej së drejtës.

11.

Dhe tani një fjalë refuzimi për orvatjet e shfaqura së fundmi për të kërkuar origjinën e drejtësisë në një terren krejt të ndryshëm – pra atë të *ressentiment*. Le t'ua themi së pari në vesh psikologëve, gjithmonë nëse kanë me të vërtetë dëshirë për ta studiuar një herë e mirë nga afër *ressentiment*-in: kjo bimë lulëzon sot në tërë shkëlqimin e vet mes anarkistëve dhe antisemitëve, sikundër ka lulëzuar gjithmonë, e fshehur, e ngjashme me vjollcën, sidoqë ka pasur një erë krejt tjetër. Dhe meqë nga e ngjashmja mund të dalë vetëm e ngjashmja, nuk kemi pse mrekullohemi nëse pikërisht nga këto mjedise do lindin përpjekje, sikundër sakaq ka pasur shpesh – shih citimet e mësipërme – për ta shenjtëruar *hakmarrjen* me emrin e *drejtësisë* – sikur drejtësia, tekefundit, të mos ishte tjetër pos një zhvillim i mëtejshëm i ndjenjës së njeriut që ndihet i fyer – e pastaj për t'i nderuar, me *hakmarrjen*, afektet e *kundërimit* në përgjithësi, apo dhe të të gjithëve. Mbi këtë gjënë e fundit nuk do të skandalizohesha shumë: madje do më dukej gati një *meritë*, po të raportohej me gjithë problemin biologjik (në lidhje me të cilin vlera e këtyre afekteve është nënvlerësuar deri më sot). E vetmja gjë që dua të nënvizoj, është fakti se pikërisht nga fryma e *ressentiment* është ajo që e bijon këtë *nuancë* të re barazie shkencore (në dobi të urrejtjes, zilisë, mllëfit, dyshimit, mërisë dhe hakmarrjes). Në fakt kjo "drejtësi shkencore" ndalon menjëherë dhe ia lë vendin notave të një armiqësie dhe paragjykimi vdekjeprurës, sapo të hyjë në lojë një grup tjetër afektesh që, si pasojë e kanë merituar për

këtë arsye të vlerësohen *shkencërisht* dhe të mbahen si të rëndësishme: pra afektet mirëfilli *aktive*, si lakmia për pushtet, për zotërim, dhe gjëra të ngjashme të këtij lloji. (E. Dyhring, *Vlera e jetës, Kurs Filozofie*; dhe gjithandej). Kaq mjafton kundër kësaj prirjeje në përgjithësi: për sa i takon parimit të veçantë të Dyhringut, sipas të cilit atdheu i drejtësisë duhet kërkuar në trojet e ndjenjës kundërvepruese, për hir të së vërtetës, me një përmbyasje të beftë, do i duhet vënë përkundër ky tjetri: trualli i *fundit* i pushtuar nga shpirti i drejtësisë është ai i ndjenjës së kundërveprimit! Nëse ndodh realisht që njeriu i drejtë të ngelet i drejtë edhe ndaj fyesit të tij, (dhe jo vetëm i ftohtë, i vetëpërmbajtur, i huaj, indiferent: të qenit i drejtë është gjithmonë një sjellje *pozitive*), në qoftë se nën peshën e një ofendimi, të një talljeje, të një dyshimi personal, objektiviteti i lartë, i qartë, sa i thellë aq edhe shpirtgjerë, i një syri të drejtë dhe *gjykues* nuk turbullohet, ja, ky është një shembull përsosmërie dhe mjeshtërie sublime mbi tokë – diçka që këtu, me pak kujdes, nuk duhet ta presim, dhe të cilës në çdo rast nuk i duhet *besuar* shumë lehtë. E sigurt është se, mesatarisht, edhe tek personat më të drejtë mjafton një dozë e vogël armiqësie, ligësie, insinuate, për t'ia ngjitur gjakun në sy dhe për t'ia nxjerrë nga sytë barazinë. Njeriu aktiv, që sulmon dhe është i dhunshëm, është gjithmonë dhe akoma njëqind hapa më afër drejtësisë se njeriu që reagon; ai nuk e ka fare të nevojshme ta vlerësojë në mënyrë false dhe të paragjykuar objektin e tij, siç bën dhe i duhet të bëjë njeriu reaktiv. Në fakt, në çdo epokë njeriu agresiv, duke qenë më i fortë, më kurajoz, më fisnik, ka pasur nga ana e vet dhe shikimin

më të lirë dhe ndërgjegjen më të mirë: përkundrazi pikaset sakaq ai që ka mbi ndërgjegjen pikërisht shpikjen e "ndërgjegjes së keqe" – njeriu i *ressentiment*-it! Dhe së fundi, le të shohim pak historinë rreth nesh: tek cila sferë, deri më sot, ka qenë e shtëpisë e gjithë ushtria e të drejtës si dhe nevoja e mirëfilltë për drejtësi mbi tokë? Vallë në sferën e njerëzve që reagojnë? Sigurisht që jo! Përkundrazi, tek ajo të njerëzve aktivë, të fortë, spontanë, agresivë. Nga këndvështrimi historik, e drejta përfaqëson mbi tokë – e them kundër agjitorit të lartpërmendur, që ka rrëfyer për veten: "doktrina e hakmarrjes kalon si filli i kuq i drejtësisë përmes të gjithë punëve dhe mundimeve të mia"¹⁷, pikërisht luftën kundër ndjenjave të kundërveprimit, luftën ndaj tyre, nga ana e fuqive agresive dhe aktive, që përdornin një pjesë të forcës së tyre për të frenuar dhe kontrolluar shfrenimet e *patosit* kundërveprues dhe për të bërë të detyrueshëm një ujdj. Kudo që ushtrohet drejtësia, kudo që mbahet drejtësia, shihet një fuqi më e fortë në raport me ata që i janë nënshtruar dhe që janë më të dobët (qofshin ata grupe ose individë), e cila kërkon mjete për t'i dhënë fund furisë së marrë të *ressentiment*-it mes tyre, duke e hequr pjesërisht nga duart e hakmarrjes objektin e *ressentiment*-it, pjesërisht duke zëvendësuar, nga ana e vet, hakmarrjen me luftën kundër armiqve të paqes dhe të rendit, pjesërisht duke shpikur, duke propozuar dhe, me raste, duke imponuar marrëveshje; pjesërisht duke ngritur në normë disa ekuivalentë të kompensimi të dëmit, tek të cilave duke filluar nga ai moment, adresohet *ressentiment*-i. Por elementi më vendimtar, ajo çka bën dhe kryen pushteti suprem kundër regjimit

të ndjenjave të kundërvënies dhe mërisë – kështu bën gjithmonë sapo e ka njëfarësoj forcën e mjaftueshme – është statutizimi i *ligjit*, shtjellimi imperativ i asaj që, në sytë e tij, duhet konsideruar si e drejtë dhe e ligjshme, apo si e padrejtë dhe e paligjshme: dhe teksa, pas themelimit të ligjit, pushteti suprem i trajton aktet agresive dhe arbitrare të individëve, apo të grupeve të tëra, si dhunim të ligjit dhe si revoltë kundër tij, ai e heq vëmendjen e subjekteve të tij nga dëmi i afërt, i shkaktuar nga këto krime dhe përfton, në fund fare, të kundërtën e asaj që kërkon çdo hakmarrje e cila sheh vetëm me këndvështrimin e të dëmtuarit dhe vetëm atë e mban të vlefshëm. Tani e tutje, syri ushtrohet në një vlerësim gjithmonë e *më impersonal* të veprimit, edhe syri i vetë të dëmtuarit (edhe pse i fundit, siç e kemi vënë në dukje). – Në përputhje me këtë, vetëm duke u nisur nga statutizimi i ligjit, ekziston “e drejta” dhe e “gabuar” (dhe *jo*, siç do Dyringu, duke u nisur nga akti dëmtues). Nuk ka absolutisht kuptim të flitet për të drejtë dhe të gabuar *në vetvete; në vetvete* të ofendosh, të dhunosh, të shfrytëzosh, të asgjësosh nuk mund të jetë asgjë e “kundërt me të drejtën” përderisa jeta realizohet *thelbësisht*, pra në funksionet e saj themelore, duke ofenduar, dhunuar, e shfrytëzuar dhe as nuk mund të mendohet pa këtë karakter. Madje duhet të rrëfejmë edhe diçka më serioze: parë nga këndvështrimi më i lartë biologjik, kushtet e ligjshmërisë mund të jenë vetëm *kushte të jashtëzakonshme*, pasi ato janë shtrëngime të pjesshme të vullnetit të vërtetë dhe të mirëfilltë për jetë, që bëhet vullnet për fuqi, dhe kësodore janë të nënshtruara si mjete të veçanta për qëllimin e

përgjithshëm të këtij vullneti: pra si mjete për të krijuar njësi fuqie *më të mëdha*. Një rend juridik i menduar si sovran dhe i përgjithshëm, jo si mjet në luftën mes komplekseve të fuqisë, por si mjet *kundër* çdo lufte në përgjithësi, pak a shumë sipas modelit komunist të Dyringut për të cilin çdo vullnet duhet ta konsiderojë të ngjashëm çdo vullnet, do ishte një parim *armiqësor ndaj jetës*, një realitet që shkatërron dhe zhbën njeriun, një atentat ndaj të ardhmes së njeriut, një shenjë sfiliteje, një udhë e tërthortë drejt hiçit.

12.

Edhe një fjalë, tani, mbi zanafillën dhe qëllimin e dënimit – dy probleme që ndahen dhe duhen ndarë: për fat të keq, zakonisht, përzihen në një të vetëm. Si janë sjellë, në këtë rast, deri më sot gjenealogjistët tanë të moralit? Në mënyrë naive, siç kanë bërë gjithmonë. Zbulojnë një “qëllim” çfarëdo të dënimit, si për shembull, hakmarrjen dhe frikësimin, dhe mandej në gjithë pafajësinë e tyre, e vendosin këtë qëllim në zanafillë, si *causa fiendi** të dënimit, dhe me kaq loja mbaron. Por “qëllimi i së drejtës” është elementi i fundit që të hyn në punë për historinë e ngjizjes së të drejtës. Madje për cilëndo histori, nuk ekziston asnjë parim më i rëndësishëm se ai, i fituar me aq shumë mund dhe që pikërisht *kështu duhej* fituar – sipas të cilit arsytet e lindjes së një gjëje dhe dobia e saj finale, sikundër edhe përdorimi i saj real dhe futja e saj në një sistem qëllimesh, janë fakte *toto coelo* të ndara

* Lat.: shkak i të bërit.

nga njëra-tjetra. Se diçka që ekziston, e realizuar në njëfarë mënyre, përfundon gjithmonë duke u interpretuar në perspektivën e qëllimeve, nga një fuqi eprane ndaj saj: merret përsëri, ristrukturohet dhe përshtatet sërish për përdorime të reja. Se çdo ngjarje në botën organike është një *mposhtje*, një vënie nën thundër, një interpretim, një sistemim, ku, domosdoshmërisht, "kuptimi" dhe "qëllimi" të vlefshëm deri në atë moment, duhet të nxihen ose të bjerren plotësisht. Sado mirë qoftë kuptuar *dobishmëria* e një çfarëdo organi psikologjik, ose qoftë edhe e një institucioni juridik, e një zakoni shoqëror, e një doku politik, e një forme në artet apo në kultin fetar, sigurisht nuk është kuptuar akoma asgjë në lidhje me origjinën e tij: sado që kjo mund të tingëllojë e papranueshme dhe e papëlqyeshme për veshë më të vjetër – sepse ngaherë është besuar se të kuptuarit e qëllimit final ose dobisë së diçkaje, të një forme, të një institucioni, do të thotë edhe kuptim i arsyes së zanafilës së saj. Për të dhënë një shembull të kësaj logjike: syri qenkej bërë për të parë, dora për të rrokur. Kështu është imagjinuar edhe fakti se dënimi që shpikur për të ndëshkuar. Por të gjitha qëllimet, të gjitha dobitë, janë vetëm *shenja* të faktit se një vullnet për fuqi ka vënë nën dominim diçka më pak të fuqishme dhe i ka imponuar në mënyrë autonome sensin e një funksioni; dhe e gjithë historia e një "gjëje", e një organi, e një përdorimi, mund të jetë kësodore një vargan i vazhdueshëm shenjash, interpretimesh dhe sistemimesh gjithmonë të reja, arsyet e të cilave as nuk kanë nevojë për të qenë të lidhura mes tyre, madje, sipas rasteve, ndjekin dhe zëvendësojnë njëra-tjetrën krejt rastësisht. "Evolucio-

ni" i një "gjëje", i një zakoni, i një organi, është diçka krejt tjetër nga *progressus*-i i saj drejt një finishi, dhe më pak se kurrë një *progressus* logjik dhe shumë i shkurtër i përfutur me harxhimin minimal të forcës dhe të mirave – porse vijimësia e proceseve të mposhtjes zhvillohen në të pak a shumë thellësisht, pak a shumë të pavarur nga njëri-tjetri, për më tepër me rezistenca që vazhdimisht i kundërvihen, përpjekje për modifikim forme me qëllim mbrojtjeje dhe reagimi, përfshi rezultatet e kundërveprimeve të arrira. Forma është fluide, por "kuptimi" është akoma më tepër... Edhe në brendësi të çdo organizmi të veçantë nuk ndodh aspak ndryshe: në çdo rritje substanciale të së gjithës, rrëshqet edhe "funktioni" i organeve të veçanta – në disa raste prishja e tyre e pjesshme, zvogëlimi i tyre numerik (për shembull me shkatërrimin e elementeve të ndërmjetëm) mund të jetë një shenjë force dhe perfeksioni në rritje. Doja të thosha: edhe të bërit i *pavlefshëm* pjesërisht, atrofizimi dhe degjenerimi, humbja e kuptimit dhe e njëtrajtshmërisë me qëllimin, thënë shkurt, vdekja, bëjnë pjesë të kushtet e *progressus*-it real, i cili shfaqet gjithmonë si vullnet dhe rrugë drejt një fuqie më të madhe dhe pohohet gjithmonë me çmimin e fuqive më të vogla të panumërta. Madhështia e një "progresi" *matet* madje me metrin e gjithçkaje që është dashur të sakrifkohet; njerëzimi si masë e sakrifkuar për mirëqenien e një lloji të veçantë njerëzor *më të fortë* – ky *do ishte* progres... E nënvizoj gjith'ë më fort këtë këndvështrim themelor të metodologjisë historike, sepse i kundërvihet rrënjësisht instinkteve dhe shijes së kohës, në fakt dominuese, e cila në vend të teorisë së një *vullneti për fuqi* që zhdrivil-

lohet në çdo ngjarje, do të preferonte të përshtatej me rastësinë absolute, madje dhe me absurditetin mekanicist të çdo ngjarje. Idiosinkrazia demokratike kundrejt gjithçkaje që komandon dhe don të komandojë, *misarkizmi** modern* (për të përvijuar me një fjalë të shëmtuar një gjë të shëmtuar) pak nga pak është maskuar aq shumë dhe është shndërruar në një gjë intelektuale, madje intelektuale në shkallë sipërore, sa të mundet të hyjë sot tinëz, hap pas hapi, deri edhe në shkencat më rigorozë dhe në dukje më objektive: madje më duket se ka bërë zap tërë fiziologjinë dhe teorinë e jetës, në dëm të tyre, afërmendsh, pasi me një marifet prestidigjitori ka bërë të zhduket prej tyre një koncept themelor, ai i *veprimtarisë* së vërtetë e të mirëfilltë. Nën trysninë e asaj idiosinkrazie kalon përkundrazi në plan të parë “përshtatja”, pra një veprimtari e dorës së dytë, një kundërveprim i thjeshtë, madje vetë jeta është përkufizuar si një përshtatje e brendshme gjithnjë e më e finalizuar ndaj fakteve të jashtme (Herbert Spenser). Me këtë mohohet, amà, esenca e jetës, *vullneti për fuqi* i saj. Shpëton nga sytë prioriteti parimor që kanë forcat spontane, agresive, mësymëse, që janë në gjendje të sigurojnë interpretime të reja, direktiva dhe forma të reja, efekti i të cilave thjesht pasohet nga “përshtatja”. Në këtë mënyrë mohohet, te vetë organizmi, roli hegjemonik i elementeve të caktuara për funksionet më të ngritura, ku vullneti i jetës shpërfaqet në mënyrë aktive dhe formative. Mendoni për atë për çka Haksli e ka qortuar Spenserin “nihilizmin administrativ”: por këtu është

** Qëndrim armiqësor ndaj qeverisë, por më i butë se anarkizmi.

fjala për shumë më tepër sesa për të "administruar" ...

13.

- Për t'u kthyer te argumenti, pra tek *dënimi*, duhen dalluar dy aspekte te ai: nga një anë, ajo kohëzgjatja relative, zakoni, akti, "drama", njëfarë vijimësie e rreptë procedurash, nga ana tjetër *rrjedhshmëria* e tij, kuptimi, qëllimi, pritja që lidhet me ekzekutimin e këtyre procedurave. Këtu ne hamendësojmë, *per analogiam*, sipas këndvështrimit të metodologjisë historike që ekspozuam më lart, se vetë procedura do të jetë diçka më antike, e përparme ndaj përdorimit të saj në lidhje me dënimin; që kjo e fundit është *futur* së pari në procedurë (e cila ekzistonte prej kohësh, por e kuptuar ndryshe) dhe e interpretuar brenda saj. Shkurt, që gjërat nuk janë ashtu siç kishin pretenduar deri më sot gjenealogjistët tanë naivë të moralit dhe të së drejtës, të cilët pandehnin që të gjithë se procedura ishte *shpikur* me qëllimet e dënimit, ashtu sikundër ishte menduar se dora që bërë për të mbërthyer. Për sa i takon aspektit tjetër të dënimit, atij të rrjedhshëm, "domethënies" së tij, koncepti "dënim" nuk ka më, në fakt, në një gjendje shumë më të vonë të qytetërimit (për shembull në Evropën e sotme) një domethënie të vetme, por një sintezë të tërë "domethëniesh": historia që i paraprin, ajo e dënimit në përgjithësi, historia e përdorimit të tij për qëllimet më të ndryshme, përfundon duke u kristalizuar në njëfarë uniteti të vështirë për t'u shprehur, të vështirë për t'u analizuar, dhe duhet ta përsëris, absolutisht të papërcaktueshëm. (Sot është e pamundur të thuhet me

saktësi për çfarë arsye mbërrihet tek dënimi: çdo koncept, ku përqendrohet semantikisht një proces i tërë, i shpëton përkufizimit; e përcaktueshme është vetëm ajo që nuk ka histori.) Në një stad të mëparshëm, ajo sintezë "domethëniesh" duket ku e ku më e ndashme, akoma më e shpërbëshme; akoma mund të perceptohet sesi, për çdo rast të veçantë, elementet e sintezës e ndryshojnë vlerën e tyre dhe për pasojë ristrukturohen, në mënyrë që tani kjo e tashme e elementit del në pah dhe dominon në kurriz të të tjerëve, madje, në disa raste, një element (si për shembull qëllimi i frikësimit) duket se i eliminon të gjithë elementet e tjerë. Për të dhënë akoma një ide se sa e pasigurt, paragjyquese, aksidentale është "domethënia" e dënimit dhe se sa mund të përdoret, interpretohet, rregullohet për qëllime radikalisht të ndryshme një procedurë e vetme dhe identike: ja skema që ka ardhur duke mu përcaktuar mbi vetë bazën e një materiali relativisht të kufizuar dhe të rastësishëm. Dënimi si neutralizim, si pengim për një dëm të mëtejshëm. Dënimi si shpagim i dëmit ndaj të dëmtuarit në çfarëdo forme (edhe në atë të një kompensimi të ndjenjave). Dënimi si izolim i një gjëje që e trazon ekuilibrin, si parandalim i përhapjes së mëtejshme të trazimit. Dënimi si mjet për të futur frikë përpara atyre që e përcaktojnë dhe e bëjnë ekzekutiv dënimin. Dënimi si një lloj kompensimi për avantazhet që ka gëzuar shkelësi deri në atë çast (për shembull, kur përdoret në miniera si skllav). Dënimi si syrgjynosje e një elementi në prishje e sipër (në disa raste të një rodi të tërë: siç ndodh në të drejtën kineze¹⁸: si mjet, pra, për të ruajtur pastërtitë e racës ose për ta bërë të

qëndrueshëm një tip të caktuar social). Dënimi si festë, pra si dhunë dhe poshtërim në dëm të një armiku më në fund të mposhtur. Dënimi si ngulitje në kujtesë, si për atë që e vuan – i ashtuquajtur “korrektim”, si dhe vetëm për dëshmitarët e ekzekutimit. Dënimi si pagim i një honorari, me anë të të cilit fuqia pretendon ta mbrojë keqbërësin nga sulmet e hakmarrjes. Dënimi si kompromis me dukurinë natyrore të hakmarrjes, përderisa ai mbahet ende në jetë nga racat më të forta dhe konsiderohet privilegj. Dënimi si deklaram dhe normë e luftës kundër një armiku të paqes, të ligjit, të rendit, të autoritetit, që luftohet me mjetet që siguron lufta, si i rrezikshëm për komunitetin, si shkelës i paktit mbi të cilin bazohen premiset e tij, si kryengritës, tradhtar dhe prishës i paqes. –

14.

Është e qartë se kjo listë është e paplotë; dënimi është qartazi i mbingarkuar me gjithfarë dobish. Kjo e bën shumë më të lejueshëm eliminimin e një dobie të *hamendësuar*, që me thënë të drejtën, në ndërgjegjen popullore konsiderohet si më thelbësorja – besimin tek dënimi, që sot për arsye të ndryshme po luhatet, pikërisht këtu e gjen akoma gjithmonë mbështetjen e vet më të vlefshme. Vlera e dënimit duhet të jetë që të zgjojë tek fajtori *ndjenjën e fajit*, tek dënimi kërkohet *instrumentum*-i karakteristik i atij reaksioni psikik që quhet “ndërgjegje e keqe”, “brejtje ndërgjegjeje”. Por kjo teori është ende sot një dhunim sa i takon realitetit dhe psikologjisë: dhe aq më tepër, nëse mendon për

tërë historinë më të gjatë të njeriut, për prehistorinë e tij! Pikërisht tek keqbërësit dhe të burgosurit ndjenja e brejtjes së ndërgjegjes është diçka shumë e rrallë, burgjet, institutet e dënimit *nuk* janë vendet e inkubacionit ku shumohet ky lloj krimbi – për këtë janë dakord të gjithë vëzhguesit e ndërgjegjshëm, të cilët, në shumë raste, e shprehin një gjykim të tillë me zemër të thyer dhe kundër dëshirave të tyre më të thella. Që ta shprehim me fjalë të përgjithshme, dënimi të bën më të vrazhdë dhe të ftohtë; ai përqendron; acaron ndjenjën e tëhuajsisë; shton aftësinë e rezistencës. Nëse ndodh që ai ta flashkë energjinë dhe të shkaktojë një gjunjëzim të mjerueshëm dhe një vetëposhtërim, ky rezultat është sigurisht akoma më pak ngushëllues se efekti i mesëm i dënimit, që karakterizohet nga një hije e rëndë, e thatë dhe e zymtë. Por nëse mendojmë për ata mijëvjeçarë që i *paraprijnë* historisë së njeriut, do të mund të deduktonim kollaj se pikërisht dënimi *e ka ndalur*, më vendosmërisht se kurrë, evolucionin e ndjenjës së fajit – të paktën për sa i përket viktimës mbi të cilën ushtrohej fuqia dënuese. Në fakt nuk duhet të nënvleftësojmë se në ç’masë pikërisht spektakli i procedurave gjyqësore dhe ekzekutive është për fajtorin një pengesë për ta konsideruar gjestin e tij, llojin e aksionit të tij *në vet-vete*, si diçka të qortueshme: sepse ai sheh që pikërisht i njëjti lloj veprimesh kryhet me ndërgjegje të paqtë në shërbim të drejtësisë, dhe miratohet; pra spiunazhi, mashtrimi, mitmarrja, intriga, i gjithë arti plot dinakëri dhe marifete, i policëve dhe paditësve – i gjithë sistemi, në fakt, i shpërfaqur në llojet e ndryshme të dënimit (një sistem i pajustificuar nga pasioni, por i bazuar mbi

parimin), të vjedhjes, dhunës, shtypjes, fyerjes, burgosjes, torturës, vrasjes. Të gjitha këto veprime ai i sheh që gjykatësit nuk i trajtojnë si akte që meritojnë censurë dhe dënim *në vetvete*, por vetëm në një kontekst aplikimi të veçantë. "Ndërgjegjja e keqe", bima më e mbrapshtë dhe më interesante e "bimësisë sonë", nuk ka lindur mbi këtë truall – në të vërtetë, ndërgjegjja e atyre që gjykojnë dhe vendosin dënimin, për një periudhë kohe shumë të gjatë, nuk e ka regjistruar *kurrë* faktin se ka të bëjë me një "fajtor". Përkundrazi ka të bëjë më shumë me një individ të aftë për të shkaktuar dëme, me një copë të papërgjegjshme fataliteti. Madje edhe ai mbi kokën e të cilit binte mandej dënimi, sërish si një copë fataliteti, nuk vuante nga asnjë "dënim intim" tjetër përpos atij që rrjedh nga shfaqja e papritur e diçkaje të paparashikuar, e një fatkeqësie të frikshme natyrore, e një orteku që bie dhe të përllan, kundër të cilit nuk mund të bëhet asgjë.¹⁵ Edhe ndërgjegjja e Spinozës e ndjeu tërë këtë në mënyrë të rrezikshme (pavarësisht komentatorëve të tij si për shembull Kuno Fisher, që u *ngutën* për ta keqkuptuar pikërisht mbi këtë pikë,) kur, një pasdite, duke u penguar kushedi te cili kujtim, u zhyt në problemin se sa nga i famshmi *morsus conscientiae** kishte mbetur tek ai në veçanti, tek ai që e kishte përkufizuar të mirën me të keqen mes fantazive njerëzore, duke mbrojtur me zemërim nderin e Zotit të tij "të lirë" kundër atyre blasfemuesve që kishin guxuar të pohonin se Zoti e përcakton çdo efekt *sub ratione boni*** ("gjë e cila, amà, do nënkuptonte që Zoti t'i nën-

* Lat.: brejtja e ndërgjegjjes.

** Lat.: në aspektin e së mirës.

shtrohet fatit dhe do ishte sigurisht më i madhi ndër të gjitha absurditetet").¹⁹ Për Spinozën bota ishte kthyer sërish mbrapa tek ajo pafajësi ku gjendej para shpikjes së ndërgjegjes së keqe: ku kishte përfunduar pra *morsus conscientiae*? "E kundërta e *gaudium****, – u tha në fund – një trishtim i shoqëruar nga përshtfaqja e një ngjarjeje të kaluar që është kryer në mënyrë të kundërt me çdo pritshmëri". *Eth. III propos. XVIII schol. I.II.* Jo ndryshe nga Spinoza, keqbërësit e goditur nga dënimi, në rrjedhën e mijëvjeçarëve, e kanë kuptuar "fajin" e tyre: "Papritur diçka nuk ka shkuar si duhet këtu", dhe jo "Nuk duhet ta kisha bërë"; ata i nënshtroheshin dënimit siç i nënshtrohesh një sëmundjeje, një fatkeqësie apo vdekjes, me atë fatalizëm kokëfortë e pa revoltim, falë të cilit, për shembull, rusët ende sot na e kalojnë ne perëndimorëve në trajtimin e jetës. Nëse pati atëherë një kritikë të aksionit, që inteligjenca që ushtroi kritikën e saj mbi aksionin: pa dyshim duhet t'i kërkojmë *efektet* e mirëfillta të dënimit para së gjithash në një mprehje të sensit të kujdesit, në një zgjatje të kujtesës, në një vullnet për të vepruar, tash e tutje, me më shumë vëmendje, me më shumë mosbesim, me më shumë fshehtësi, duke konsideruar që për shumë gjëra jemi me të vërtetë tepër të dobët, në njëfarë përsosjeje të vetë-kritikës. Ato çka mund të arrihen me anë të dënimit tek njeriu dhe kafsha, janë shtimi i frikës, mprehja e dinakërisë, kontrolli i dëshirave: në këtë mënyrë dënimi *e zbut* njeriun, por nuk e bën "më të mirë" – madje, do ishte më korrekte të pohohej e kundërta. ("Kush pëson mëson", thotë një

*** Lat.: gëzimi, ngazëllimi.

fjalë e urtë: dhe sapo mëson, bëhesh edhe i keq. Për fat, shumë shpesh gabimi të bën edhe budalla.)

16.

Në këtë pikë, nuk mund ta shmang dot dhënien e një përkufizimi të parë e të përkohshëm të hipotezës sime personale mbi zanafillën e "ndërgjegjes së keqe". Ajo e fiton me vështirësi vëmendjen dhe kërkon meditim, veshtim dhe përsiatje të vazhdueshme. Mëtoj se ndërgjegjja e keqe është ajo sëmundje e rëndë që i ra njeriut si pasojë e metamorfozës më të thellë nga të gjitha ndryshimet që ka përvojtur - atë që e burgosi në rrethojën e shoqërisë dhe të paqes. Një gjë e tillë duhet t'i ketë ngjarë kafshëve ujore, kur qenë të detyruara të shndërroheshin në kafshë tokësore apo të vdisnin, e kështu edhe këto gjysmëkafshë të përshtatura në mënyrë fatlume me jetën e egër, me luftën, me nomadizmin, me aventurën - papritur i panë të gjitha instinktet e tyre të zhvleftësuarra dhe "të fikura". Atëbotë iu desh të ecnin mbi këmbë dhe "të mbaheshin", teksa më përpara i mbante uji: një rëndesë e tmerrshme i mundonte. Ndiheshin të paaftë për veprimet më elementare, për këtë botë të re dhe të panjohur, nuk i kishin më udhërrëfyesit e tyre të lashtë, instinktet rregulluese, të pagabueshme në mënyrë të pavetëdijshme - ishin katandisur, fatkeqët e gjorë, të mendonin, të deduktonin, të llogarisnin, të kombinonin shkaqe dhe pasoja, të katandisur te "ndërgjegjja" e tyre, te organi më i mjerueshëm dhe më mashtrues i tyre! Besoj se mbi tokë nuk ka pasur kurrë një ndjenjë të këtillë

mjerimi, një siklet kaq të zymtë – e ndërkaq ato instinkte sigurisht nuk kishin reshtur papritur së shpërfaquri nevojat e tyre! Vetëm se për t'i kënaqur ishte e vështirë dhe vetëm në të rrallë e mundur: në thelb, ato u desh të gjenin kënaqje të reja dhe gati të nëndheshme. Të gjithë instinktët që nuk shkarkohen jashtë, *kthehen së brendshmi* – kjo është ajo çka quaj *përbrendësim* i njeriut: vetëm kështu zhvillohet ajo çka më vonë do marrë emrin “shpirt”. E gjithë bota e brendshme, në fillim e hollë si të ishte mes dy shtresash epitetale, është zgjeruar dhe stërçelur, ka fituar thellësi, gjerësi, gjatësi, po aq sa janë penguar mundësitë e njeriut për t'u shkarkuar jashtë. Ato bastione të tmerrshme kundër të cilave organizimi shtetëror mbrohej kundër instinkteve të lashta të lirisë – dënimet bëhen kryesisht prej këtyre bastioneve – bënë që ato instinkte të njeriut të lirë dhe endacak, duke u prapësuar, të ktheheshin kundër vetë njeriut. Armiqësia, mizoria, kënaqësia e persekutimit, e sulmit, e gjymtimeve, e shkatërrimit – gjithçka që kthehet kundër zotëruesve të këtyre instinkteve: kjo është origjina e “ndërgjegjes së keqe”. Njeriu, që në mungesë armiqsh të jashtëm dhe rezistencash, i ngujuar në ngushticat shtypëse dhe në rregullsinë e zakoneve, çartte i padurueshëm vetveten, vetëpërndiqej, torturohej, thumbohej, keqtrajtohej, kjo kafshë që hidhet kundër hekurave të kafazit të vet duke u plagosur, të cilën duan “ta zbusin”, kjo qenie e privuar nga diçka, e brejtur nga nostalgjia e shkretëtirës, të cilës i është dashur të bëjë vetë një aventurë, një qelë torture, një xhungël të pasigurt dhe plot rreziqe – ky i lojtur, ky i burgosur i dëshpëruar dhe i përmalluar për vendlindjen, u bë shpikë-

si i "ndërgjegjes së keqe". Me këtë, amà, iu çel udha sëmundjes më të rëndë dhe më të errët nga e cila njerëzimi nuk është shëruar deri më sot, vuajtja që njeriu ka për *veten, për vetë njeriun*: si pasojë e një shkëputjeje të dhunshme nga e shkuara e vet kafshërore, e një kapërcimi, thuajse e një rënieje në situata dhe kushte të reja ekzistenciale, e një shpallje lufte kundër instinkteve të lashta, mbi të cilat deri atëherë e kishte bazuar forcën e vet, kënaqësinë e vet, dhe me të cilën fuste frikën. Po shtojmë menjëherë se, nga ana tjetër, me faktin që një shpirt kafshëror drejtohet kundër vetes, duke marrë qëndrim kundër vetes, mbi tokë ishte shfaqur diçka kaq e re, e thellë, e padëgjuar, enigmatike, e mbarsur në kontradikta dhe *e mbarsur me të ardhme*, sa pamja e tokës ndryshoi në mënyrë rrënjësore. Në të vërtetë do duheshin spektatorë hyjnorë për të çmuar shfaqjen që sapo kishte filluar, përmbyllja e së cilës akoma nuk është e parashikueshme absolutisht – një spektakël tepër i rafinuar, fantastik, tepër paradoksal që të mund të zhvillohej për arsye absurde, i pavënëre mbi çfarëdo planeti tjetër qesharak! Qysh atëherë, njeriu *konsiderohet* një nga fatet më të papritura dhe ngazëllyese të lojës që ka bërë "djaloshi i madh" i Heraklitit²⁰ – qoftë ai Zeusi apo rasti – ai zgjon vetë një interes, një tension, një shpresë, gati një siguri, si të ishte njoftimi i diçkaje, përgatitja e diçkaje, sikur njeriu të mos ishte finalizim, por udhë, episod, urë, premtim i madh...

17.

Një nga premisat e kësaj hipoteze mbi origjinën e

ndërgjegjes së keqe është, para së gjithash, fakti se ai gjymtim nuk ka qenë as gradual, as i vullnetshëm dhe nuk ka përfaqësuar një rritje organike në kushte të reja, por një thyerje, një kapërcim, një bashkëveprim, një fat të pashmangshëm, kundër të cilit nuk ishte e mundur as lufta, e aq më pak *ressentiment*-i. Në radhë të dytë, mandej, fakti se futja e një popullsie, deri atëherë e shfrenuar dhe patrajtë, në një trajtë të qëndrueshme, siç pat zënë fill me një akt dhune, kështu u çua në përm-bushje vetëm me akte dhune – që, për pasojë, “Shteti” më i lashtë u duk si një tirani e tmerrshme, si një me-kanizëm shtrydhës dhe pa skrupuj, dhe vijoi mbi këtë udhë, deri sa ajo lënda e papërpunuar e popullit dhe e gjysmëkafshërisë më në fund u amalgamua mirë dhe u bë e epshme, dhe gjithaq e pajisur me formë. Përdora fjalën “Shtet”: është e qartë se kujt i referohem – një tufë çfarëdo me kafshë bionde për pre, një racë pushtuesish dhe padronësh, që e organizuar ushtarakisht dhe me forcën për të organizuar, i hodhi kthetrat e saj të tmerrshme mbi një popullsi mbase pafundësisht më të madhe si numër, por akoma pa trajtë, akoma nomade. Kështu zë fill në tokë “Shteti”: besoj se është asgjesuar ajo ëndrra në diell që e bënte atë të fillonte me një “kontratë”. Ai që mund të komandojë, ai që është natyrshëm “padron”, ai del në skenë tiranik në veprime e në gjeste – sigurisht nuk ka nevojë për kontrata! Me qenie të tilla është e pamundur të bësh llogaritje, ata vijnë si fati, pa shkak, pa arsye, pa respekt, pa pretekste, shfaqen si rrufeja, tepër të tmerrshëm, tepër bindës, tepër “të ndryshëm” për të qenë qoftë edhe thjesht të urryer. Vepra e tyre është një krijim formash instink-

tive, një sajim formash, ata janë artistët më të pavullnetshëm dhe të pavetëdijshëm që ekzistojnë – pra, aty ku ata shfaqen ka diçka të re, një produkt sundimi që *jeton*, ku pjesët dhe funksionet janë të përcaktuara dhe të finalizuara, ku nuk gjen vend asgjë që nuk ka marrë më parë një “kuptim” në lidhje me gjithçka. Nuk e dinë se çfarë është faji, përgjegjësia, respekti, këta organizatorë të lindur. Tek ata dominon ai egoizmi i tmerrshëm i artistit, që ka një shikim të çeliktë dhe di të justifikohet me “vepër”, si nëna me të birin, në jetë të jetëve. Këta nuk janë ata tek të cilët është rritur “ndërgjegjja e keqe” - merret vesh më së miri qysh në fillim – por megjithatë *pa ata* kjo bimë e keqe nuk do ishte rritur, ajo nuk do ekzistonte sikur nën peshën e goditjeve të tokmakëve të tyre, të dhunës së tyre prej artistësh të mos ishte përzënë nga bota, ose të paktën nga shikimi dhe të ishte bërë gati *latent* një *quantum* gjigand i lirisë. Ky *instinkt i lirisë* i bërë latent nga dhuna – e kemi kuptuar tashmë – ky instinkt i shtypur i lirisë, i mbytur, i burgosur në brendësi, që përfundon duke mos mundur të shkarkohet dhe të shpengohet tjetërkund në mos kundër vetes: kjo dhe vetëm kjo gjë, është, në fillesën e saj, ndërgjegjja e keqe.

18.

Të ruhemi nga nënvlerësimi i të gjithë këtij fenomeni vetëm sepse ai është, qysh në krye të herës, i pakëndshëm dhe i dhimbshëm. Në fund, po ajo forcë aktive që vepron madhërisht në ata artistë dhe organizues të dhunës dhe ngre shtete, është po ajo që këtu, në brendë-

si, në përmasa më të vogla, më të reduktuara, kthehet mbrapsht, në "labirintin e zemrës" për t'u shprehur me Gëten²¹, ndërton ndërgjegjen e keqe dhe idealet negative, është pikërisht po ky *instinkt i lirisë* (i quajtur në gjuhën time: vullneti për fuqi): vetëm se lënda mbi të cilën shkundullon natyra e dhunshme dhe formuese e kësaj force, këtu është pikërisht njeriu, në gjithë veten e tij antike dhe shtazore – dhe jo, si tek ai fenomeni tjetër më i madh dhe më vezullues, njeriu *tjetër*, njerëzit e *tjerë*. Kjo dhunë e fshehtë kundër vetvetes, kjo mizori prej artistësh, kjo kënaqësi për t'i dhënë vetes, lëndës që dergjet gati e rëndë, krupëndjellëse, për t'ia ngulitur vetvetes një formë, për ta damkosur me zjarr një kritikë, një kontradiktë, një përçmim, një jo, ky mundim i mbrapshtë e tmerrësisht plot kënaqësi i një shpirti të ndarë me dashje në vetvete, që i shkakton vetes dhimbje për kënaqësinë e të shkaktuarit dhimbje, e gjithë kjo "ndërgjegje e keqe" *aktive*, në fund – pikaset sakaq – si një prehër amësor autentik ngjarjesh ideale dhe imagjinare, ka pjellë edhe një sasi të madhe bukurish dhe pohimesh të reja, dhe mbase për herë të parë, në radhë të parë *bukurinë*... Në fakt, çfarë do ishte "e bukur", sikur kontradikta të mos ishte bërë më përpara e vetëdijshme për veten, nëse përpara i shëmtuari të mos i kishte thënë vetvetes: "Unë jam i shëmtuar"?... Të paktën, pas këtij udhëzimi, enigma do jetë më pak enigmatike: në ç' masë, pra, koncepte kontradiktore si *altruizëm*, *vetëmohim*, *vetëflijim* mund të shprehin një ideal, një bukuri; dhe një gjë do të jetë e qartë tash e tutje – nuk e dyshoj – pra natyra e *kënaqësisë* që provon altruisti, ai që mohon dhe sakrifikon vetveten: kjo kënaqësi është mizori.

- Kaq duhej thënë nga unë, tani për tani, mbi zanafilën e "jo egoistes" si vlerë *morale* dhe për caktimin e truallit nga i cili ka lindur kjo vlerë: vetëm ndërgjegjja e keqe, vetëm vullneti për të keqtrajtuar veten, përbën premisën për *vlerën* e jo egoistes.

19.

Nuk ka dyshime mbi faktin se ndërgjegjja e keqe është një sëmundje, por një sëmundje siç mund të jetë shtatzania. Nëse shkojmë në kërkimin e kushteve në të cilat ka mbërritur në kulmin e vet më mizor dhe sublim kjo sëmundje - do shohim se çfarë ka hyrë në botë bashkë me të. Por për këtë gjë duhet frymëmarrje e gjerë - dhe, para së gjithash, duhet të kthehemi sërish në një pikëvështrim të përparshëm. Raporti i të drejtës private mes debitorit dhe kreditorit, për të cilin është folur gjatë, është interpretuar prapë dhe, ç'është e vërteta, në një mënyrë absolutisht të pazakontë dhe që meriton refleksion nga pikëvështrimi historik, në gjirin e një raporti ku për ne modernët ai është mbase absolutisht i pakuptueshëm: pra në raportin që ekziston mes *bashkëkohësve* dhe *paraardhësve* të tyre. Brenda komunitetit primitiv të fiseve - flasim për epoka zanafillore - brezi i gjallë njih përherë një detyrim juridik kundrejt brezit më të lashtë që ishte themeluesi i fisit (dhe në asnjë mënyrë një lidhje sentimentale: jo pa arsye mund edhe të mohohet kjo lidhje për periudhën më të gjatë të gjinisë njerëzore). Këtu mbizotëron bindja se lloji *vazhdon* vetëm falë sakrificave dhe veprimtarisë së të parëve, të mbijetuar si shpirtra të fuqishëm, që nuk

pushojnë së siguruari llojit avantazhe të reja dhe kontribute të reja që rrjedhin nga forca e tyre. Mbase falas? Por nuk ekziston më asgjë "falas" për ato epoka të palatuara dhe "të varfra në shpirt". Me çfarë mund të shpaguhen? Sakrifica (në fillim për ushqimin, e kuptuar trashë, festa, tempuj, blatime, mbi të gjitha bindje – ngaqë të gjithë doket, si produkt i të parëve, janë edhe rregulla edhe urdhra që vijnë prej tyre –: a iu jepet ndonjëherë mjaftueshëm të parëve? Dyshimi mbetet dhe rritet: kohë pas kohe ai bën të detyrueshëm një zhdëmtim të madh gjithëpërfshirës, njëfarë dëmshpërblimi të përbindshëm për "kreditorin" (sakrifikimi famëkeq i të paralindurit, për shembull, gjak, gjak njerëzor në çdo rast). Frika nga të parët dhe nga fuqia e tyre, vetëdija e detyrimeve ndaj tyre, sipas kësaj logjike, rritet saktësisht në atë masë që rritet vetë forca e fisit, dora dorës që fisi bëhet gjithnjë e më fitimtar, më i pavarur, më i nderuar dhe më i frikshëm. Sigurisht, është kështu, dhe jo e kundërta! Çdo hap drejt prishjes së fisit, të gjitha mjerimet e mundshme, të gjitha tiparet e degjenerimit, të zhbërjes së afërt e zvogëlojnë gjithmonë edhe frikën përpara shpirtit të themeluesit të tij dhe japin një imazh gjithmonë e më të zvogëluar të largpamësisë së tij, të provanisë së tij dhe të aktualitetit të forcës së tij. Nëse e imagjinojmë këtë tip logjike të palatuar të shtyrë deri në kulmin e vet, paraardhësit e fiseve *më të fuqishme* do përfundojnë duke u transformuar, falë fantazisë së frikës në rritje, në diçka të përbindshme, dhe do të shtyhen në fund në errësirën e një hyjnie të zymtë e të paimagjinueshme – paraardhësi përfundon, medoemos, duke u shpërfiguruar në një zot. Mbase kjo është

edhe zanafilla e zotave, pra një zanafillë e prejardhur nga *frika!*... Dhe nëse dikush do ta quante të nevojshme të shtonte “e prejardhur edhe nga *pietas!*” do të kishte vështirësi ta mbante në këmbë këtë teori për periudhën më të gjatë të llojit njerëzor, epokën e hershme. Dhe aq më tepër pastaj për epokën *e mesme*, ku formohen fiset aristokratike - që në të vërtetë ia kanë paguar me gjithë interesa të parëve të tyre, paraardhësve të tyre, (heronj, perëndi), të gjitha cilësitë që, ndërkohë, ishin shpërfaqur tek ata, cilësitë *aristokratike*. Më vonë do t'i hedhim një sy edhe procesit të fisnikërimit dhe stërholimit të perëndive (që sigurisht nuk është “shenjtërimi” i tyre): e përmbyllim sa për tani, përkohësisht, rrjedhën e të gjithë këtij evolucioni të vetëdijes së fajit.

20.

Vetëdija e të qenit borxhi ndaj zotave, siç mëson historia, nuk është shuar fare as mbas rënies së formës së organizimit të “komunitetit” të bazuar mbi afërsitë e gjakut: njerëzimi, në të njëjtën mënyrë si ka trashëguar konceptet e “së mirës dhe së keqes” nga fisnikëria e fisit, (me prirjen e vet thelbësore psikologjike për të vendosur rendime hierarkike), ka marrë, me trashëgiminë e hyjnive, të fisit dhe të tribusë, edhe atë të barrës së borxheve akoma të pashlyera dhe dëshirës për t'u çliruar prej tyre. (Momenti i kalimit shënohet nga popullatat e gjera të skllëvërve dhe të shërbëtorëve që janë përshtatur me kultin e perëndive të padronëve të tyre, qoftë me forcë, qoftë për shkak të nënshtrimit dhe *mimikrisë*: duke kaluar nëpërmjet tyre kjo trashëgimi vërshon në

gjithë botën.) Ndjenja e borxhit kundrejt zotave është rritur në harkun e mijëvjeçarëve, dhe në të vërtetë, gjithmonë në të njëjtën masë me të cilën rriteshin dhe mbarështoheshin mbi tokë, koncepti i zotit dhe ndjenja e hyjnisë. (E gjithë historia e luftërave, e fitoreve, vël-lazërimeve, përzierjeve etnike, gjithçka që i paraprin rendimit përfundimtar hierarkik të të gjithë elementeve popullore të çdo sinteze të madhe racore, pasqyrohet në lëmshin gjenealogjik të perëndive të tyre, në saggat e luftërave të tyre, të fitoreve dhe pajtimeve të tyre. Përparimi drejt mbretërive universale është gjithmonë po aq edhe progresi drejt perëndive-universale; despotizmi, me nënshtrimin që i bën aristokracisë së pavarur, ia çel gjithmonë rrugën këtij apo atij monoteizmi.) Shfaqja e zotit të krishterë, si zoti maksimal, tek i cili kemi mbërritur deri më sot, ka sjellë gjithashtu edhe maksimumin e ndjenjës së borxhit mbi tokë. E zëmë se më pas kemi hyrë në lëvizjen e *kundërt*, gjasat janë të plota për të deduktuar nga dekadencia e pandalshme e besimit tek zoti i krishterë faktin se qysh tash ekziston një rënie e konsiderueshme e vetëdijes së fajit tek njeriu; madje nuk është për t'u hedhur poshtë perspektiva, se fitorja e plotë dhe përfundimtare e ateizmit do të mund ta çlironte njerëzimin nga gjithë kjo ndjenjë borxhi ndaj fillimit të vet, ndaj *causa prima*-s. Ateizmi dhe njëfarë *pafajësie e dytë* e plotësojnë dhe i bashkohen njëri-tjetrës. -

21.

Kaq kam për të thënë, tani për tani, në përgjithësi dhe

shkurtimisht mbi lidhjet mes koncepteve “borxh”, “detyrë” dhe postulateve të tyre religjioze: qëllimisht e kam lënë pasdore deri tani moralizimin e mirëfilltë të këtyre koncepteve (rrëshqitjen e po atyre tek ndërgjegjja ose, akoma më saktë, gërshetimin e ndërgjegjes së keqe me konceptin e zotit) dhe në fund të kapitullit paraardhës kam folur sikur ky moralizim të mos ekzistonte, dhe për pasojë sikur këto koncepte të ishin sot, medoemos, pranë fundit, meqë hipoteza e tyre ka rënë, besimi të “kreditori” ynë, të Zoti. Faktet e vërteta janë tmerrësisht ndryshe nga kjo teori. Moralizimi i koncepteve të fajit dhe detyrës, me prapa-shtyrjen e tyre në ndërgjegje të keqe, është realisht përpjekja për të përmbysur drejtimin e zhvillimit të përshkruar deri tani ose të paktën për t’ia bllokuar lëvizjen: tash *duhet* përjashtuar përfundimisht perspektiva e një ngushëllimi përfundimtar, tani shikimi *duhet* të tërhiqet trishtazi dhe të përmbysset para një pamundësie të hekurt; tash ato koncepte të “fajit” dhe “detyrës” duhet të kthehen prapa – kundër *kujt* pra? S’kemi pse dyshojmë: pikësëpari kundër “debitorit”, tek i cili është konsoliduar fuqishëm ndërgjegjja e keqe, ka kryer një brejtje të tillë, është përhapur aq shumë, aq shumë është rritur nga të gjitha anët si një polip, sa që bashkë me pamundësinë e shlyerjes së borxhit konceptohet në fund edhe pamundësia e shlyerjes së dënimit, mendimi i pamundësisë së një shpage (dënimi “i përjetshëm”) – dhe në fund edhe kundër “kreditorit”, qoftë kur merret për *causa prima*-n e njeriut, për zanafillën e gjinisë njerëzore, për stërgjyshin e tij, dënuar tashmë nga një mallkim (“Adami”, “mëkati zanafil-lor”, “mosliria e vullnetit”), qoftë ndaj Natyrës nga gjiri

i të cilës lind njeriu dhe ku është futur tashmë parimi i së keqes ("demonizimi i natyrës"), ose ndaj ekzistencës në përgjithësi që ngelet si *e pavlefshme në vetvete* (ndarje nihiliste nga ajo, dëshirë e hiçit ose dëshirë e "të kundërtës" së saj, e një tjetër-qenie, budizmi apo gjëra të afërme) – derisa papritur gjendemi përballë ekspedientit paradoksal dhe të tmerrshëm tek i cili njerëzimi i martirizuar ka gjetur një lehtësim të çastit, atë shkëndijë gjeniale të *krishtërimin*: vetë Zoti sakrifikohet për faj të njeriut, Zoti vet-shpaguhet, Zoti si i vetmi që mund ta çlirojë njeriun nga ajo gjë nga e cila njeriu është bërë i paaftë të çlirohet vetë – kreditori sakrifikohet për debitorin e tij, për *dashuri* (a duhet ta besojmë? –), për dashurinë e debitorit të tij!...

22.

Lexuesi duhet ta ketë marrë vesh sakaq se *çfarë* ka ndodhur vërtet në skenën dhe në *prapaskenat* e kësaj drame. Ai vullnet për vetë-torturë, ajo mizori e përkëmbyer e kafshës njerëzore, që u subjektivizua dhe u shty brenda vetes, e burgosur siç ishte brenda "Shtetit", si pjesë e procesit të zbutjes, shpiku ndërgjegjen e keqe, për të lënduar veten, meqë u ndalua shkrimi *më i natyrshëm* i kësaj dëshire për të bërë keq – ky njeri i ndërgjegjes së keqe e ka shfrytëzuar hipotezën religjioze për ta shtyrë vetë-martirizimin e tij deri në vrazhdësinë dhe rafinimin më të tmerrshëm. Një borxh kundrejt Zotit: ky mendim bëhet për të instrumenti i torturës. Rrok te "Zoti" antitezat më të skajshme që arrin të gjejë në lidhje me instinktet e veta tipike dhe të pashlyeshme, i

ri-interpreton këto instinkte si faj ndaj Zotit, (si armiqësi, revoltë, rebelim kundër "Zotit", "Atit" të parit dhe fillimit të botës), tendoset në kundërvënien "Zot" dhe "Djall", hedh kundër vetes çdo Jo që i thotë natyrës, natyrshmërisë, realitetit të qenies së vet, e derdh jashtë si një Po, si diçka që ekziston, trupore, e njëmendtë, si Zot, si shenjtëri e Zotit, si gjykim i Zotit, si vend ekzekutimi i Zotit, si përtejasi, si amëshim, si martirizim pa fund, si ferr, si pamatësi e dënimit dhe e fajit. Kjo është një marrëzi e vullnetit në sferën e mizorisë psikologjike që absolutisht s'e ka shoqen: *vullneti* i një njeriu për t'u ndjerë fajtor dhe i dënueshëm aq sa të mos mundet më t'i shlyejë fajet e tij, *vullneti* i tij për t'u menduar i ndëshkuar, pa qenë e mundur asnjëherë që dënimi të përshtatet me fajin, *vullneti* i tij për të helmuar universin me problemin e ndëshkimit dhe të fajit, për të përjashtuar njëherë e përgjithmonë kësodore çdo rrugëdalje nga ky labirint "idesh fikse", *vullneti* i tij për të vendosur një ideal, - atë të "të shenjtit Zot" - dhe për të qenë i sigurt në mënyrë të patjetërsueshme për padenjësinë e vet përpara tij. Medet për këtë shtazë të marrë e të trishtë, Njeriun! Çfarë fantazish ia kaplojnë mendjen, çfarë idesh kundër-natyre, çfarë paroksizmesh perversiteti, ç'shtazëri mendore shpërthen sapo frenohet në qenien e vet *bisha e aksionit!*... E gjithë kjo është jashtëzakonisht interesante, por ka edhe një trishtim të zi, të zymtë dhe nervozues; kështu që duhet ta mbajmë veten me forcë që të mos e ngulim shikimin shumë gjatë në këto humnera. Këtu ka *sëmundje*, nuk ka dyshim, është sëmundja më e tmerrshme që ka bërë kërدينë ndonjëherë mes njerëzve deri më sot - e ai që arrin akoma të dëgjojë

(por sot nuk ka më veshë për këto gjëra! -), sesi në këtë natë martirizimi dhe absurditeti, ka kumbuar britma e *dashurisë*, britma më e përmalluar e ekstazës, e shëlbimit në *dashuri*, ai sprapset nga tmerrri i pathyeshëm!... Tek njeriu ka shumë gjëra të tmerrshme!... Një kohë tepër të gjatë, Toka ka qenë një çmendinë!...

23.

Le të mjaftojë kjo njëherë e mirë mbi origjinën e "të shenjtit Zot". - Që konceptimi i zotave në *vetvete* nuk ka përse të çojë te kjo lajthitje e fantazisë, pa fokusimin e të cilës nuk qëndruam dot për një çast, që ekzistojnë mënyra më *fisnike* për ta përdorur shpikjen fantastike të perëndive, që për këtë vetëkryqëzim dhe këtë vetëdëmtim të njeriut, ku mijëvjeçarët e fundit të Evropës kanë qenë mjeshtërorë - e gjithë kjo për fat akoma mund të rroket duke i hedhur një vështrim *perëndive greke*, këtyre reflekseve ku pasqyrohen njerëz aristokratikë dhe të zotët e vetes, ku *shtaza* që është tek njeriu ndihej e hyjnizuar dhe *nuk* e shqyente veten me *furi*! Këta grekët i përdorën për një kohë të gjatë perënditë e tyre, pikërisht për ta larguar nga vetja "ndërgjegjen e keqe", për t'u kënaqur me lirinë e tyre shpirtërore: pra në një kuptim të kundërt me përdorimin që i ka bërë krishtërimi Zotit të vet. Në këtë gjë shkuan shumë larg këto koka fëmijësh lu-anore e plot shkëlqim; dhe madje një autoritet si ai i Zeusit homerik herë pas here i bën të kuptojnë se sillen në mënyrë tepër sipërfaqësore. "Çudi!" - pat

thënë ai në një rast – qe fjala për çështjen e Egjistit, një çështje shumë e mbrapshtë.

“Çudi, si vdekatarët ankohen prorë për të pavdekshmit!

Vetëm nga ne ju vika e keqja, kështu mendojnë!

por në marrëzinë e tyre,

kundër fatit, vetes rrënimin ia krijojnë.”²²

Këtu shihet dhe ndihet në të njëjtën kohë që ky spektator dhe gjykatës olimpik është fare larg nga të qenit armiqësor dhe nuk ka mendim të keq për ta: “Sa të marrë janë!” mendon ai për gabimet e vdekatarëve – dhe “marrëzinë”, “mungesën e arsyes”, pak “tjetërsim mendor” edhe grekët e epokës më të thantë dhe të guximshme ia kanë lejuar vetes për të shpjeguar shkakun e shumë të këqijave dhe ndodhive ogurzeza – punë pa mend, jo mëkat! Kuptoni?... Por edhe ky “tjetërsim mendor” ishte problem – sakaq, si ka mundësi? “Prej nga mund të kenë ardhur mendje si tonat, njerëz siç jemi ne, fisnikë prej lindjes, të gatuar mirë, shoqërisht të ngritur, aristokratë, të virtytshëm?”. Kjo ka qenë pyetja që shekull pas shekulli i ka bërë vetes fisniku grek, kur është gjendur përpara cënimesh dhe përdhosjesh që nuk arrinte t’i kuptonte dhe me të cilat ishte përlyer një nga të barabartët e tij. “Duhet ta ketë marrosur ndonjëri nga zotat,” do të thoshte përfund, duke shkundur kokën. – Kjo rrugëdalje është tipike e grekëve,... Kësodore perënditë shërbenin për të justifikuar, deri në njëfarë pike, njeriun edhe në të keqe, ato shërbenin si shkaqe të së keqes – aso kohe ata nuk merrnin mbi vete as dënimin, por, çka është shumë më fisnike, as fajin...

24.

- Po e mbyll me tri pyetje, siç do të mund ta shihni. "Këtu a po vendoset, apo po shpërbëhet ndonjë ideal?" mund të më pyesni... Por a e keni pyetur ndonjëherë veten, se sa shtrenjtë ka kushtuar mbi tokë vendosja e *cilitdo* ideal? Sa realitet duhej të diskreditohej për këtë shkak dhe të hidhej poshtë, sa gënjeshtër duhet të shenjtëroheshin, sa ndërgjegje duhet të turbulloheshin, sa "hyjni" duhej të sakrifikohej çdo herë? Që të mund të ngrihet një tempull, *duhet shkatërruar një tempull*: ky është ligji – tregomëni në çfarë rastesh nuk e ka gjetur përmbushjen e vet!... Ne njerëzit modernë, trashëgojmë traditën mijëra vjeçare të viviseksionimit të ndërgjegjes dhe të praktikimit të mizorisë kundër kafshës që jemi vetë ne: dhe kjo është sfera e stërvitjes sonë më të gjatë, mbase e vokacionit tonë artistik, e në çdo rast, e diletantizmit dhe shthurjes së shijes tonë. Njeriu i ka parë për një kohë tepër të gjatë prirjet e tij natyrore me "sy të keq", kësodore këto kanë përfunduar duke u lidhur ngushtë me "ndërgjegjen e keqe". Një orvatje e përkundërt do ishte gjë e bëshme *në vetvete*, – por kush do kishte forcën për ta bërë? – pra orvatjen për të bashkangjitur me ndërgjegjen e keqe prirjet e *panatyrshme*, të gjithë ato aspirata për të përtejshmen, të kundërta me shqisën, me instinktin, me natyrën, me kafshën, shkurt të gjithë idealet që kanë ekzistuar deri më sot, ideale që janë që të gjitha armiqësorë ndaj jetës, ideale që denigrojnë botën. Kujt mund t'i drejtohesh sot me këto shpresa dhe me këto kërkesa?... Pikërisht njerëzit e mirë

do na dilnin kundër; dhe mandej, sigurisht, dembelët, kufizuesit, mburravecët, histerikët, të lodhurit... Çfarë ofendon më thellësisht, çfarë ndan më bindshëm se vënia në dukje e një grime nga ashpërsia dhe madhështia me të cilën e trajtojmë veten? Dhe nga ana tjetër – sa mirëkuptim dhe sa dashamirësi na tregon bota, posa sillemi si tërë pjesa tjetër e botës dhe njësoj “e lëshojmë veten”!... Për atë qëllim do të duhej një soj shpirtrash *ndryshe* nga ata që janë të mundshëm pikërisht në këtë epokë: shpirtra të bërë më të fortë nga luftëra dhe fitore, për të cilët pushtimet, aventurat, rreziqet, dhimbja janë bërë deri dhe nevojë; për të gjitha këto do të duhej mësimi me ajrin prerës të maleve, me ecjet e gjata dimërore, me akullin, me malet në çdo kuptim, do duhej, për t’u shprehur në mënyrë të palatuar dhe të përciptë, pikërisht ai *shëndet i madh*!... E sot a është akoma i mundshëm ai shëndet i madh?... Por një ditë, në një epokë më të fortë se kjo e tashme e kalbur dhe introspektive, ka për të mbërritur deri tek ne njeriu i *shëlbimit*, njeriu i dashurisë dhe përçmimit të madh, shpirti krijues, gjithmonë sërish i shtyrë nga vrulli i forcës së tij larg nga çdo izolimi, nga çdo përtejësi, ai njeri vetmia e të cilit keqkuptohet nga populli, si të ishte një arratisje nga realiteti – teksa është vetëm shpërfundja e tij, vetëvarrosja e tij, zhytja e tij në realitet, për të mundur me nxjerrë dhe me sjellë me vete i kthyer sërish në dritë dikur, *shëlbimin* e këtij realiteti: shëlbimin nga mallkimi që ideali, siç ka qenë deri më sot, i ka hedhur përsipër. Ky njeri i së ardhmes, që do na shëlbojë jo vetëm nga ideali siç ka qenë deri më sot, por edhe nga ajo që *u desh të lindte prej tij*, nga neveria e madhe, nga vullneti

i hiçit, nga nihilizmi, ky kumbim i mesditës dhe i vendimit të madh, që do t'a lirojë sërish njeriun, që do t'i kthejë tokës qëllimin e saj dhe njeriut shpresën e tij, ky antikrisht dhe antinihilist, ky mposhtës i Zotit dhe i hiçit – *do të duhet një ditë të vijë...*

25.

- Po çfarë po them? Mjaft! Mjaft! Tashmë veç një gjë është e drejtë, me heshtë: përndryshe do të hyja në një log të hapur vetëm për atë që është më i ri se unë, që është më i fortë se unë, më "ardhmëror" se unë – të hapur vetëm për *Zarathustrën, Zarathustrën e pa Zot...*

ESEJA E TRETË

CILA ËSHTË DOMETHËNIA E IDEALEVE ASKETIKE?

“Të shkujdesur, tallës, të fortë – kështu na do mençuria: ajo është grua, dashuron gjithmonë veç luftëtarin.”
Kështu foli Zarathustra.

1.

Ç’kuptim kanë idealet asketike? – Tek artistët, asfare, ose gjithfarë kuptimi; tek filozofët e dijetarët, një lloj “dhuntie” dhe instinkti për kushtet më të favorshme për të arritur një nivel më të lartë shpirtëror; tek gratë, në rastin më të mirë një joshje *shtesë*, pak *morbidezza** në kurmin e bukur, ëngjëllsia e një kafshe të bukur, të dhjamur; tek të dështuarit dhe të fituarit fiziologjikisht (në shumicën e të vdekshmëve), një orvatje për t’u shfaqur si “shumë të mirë” për këtë botë, një formë e shenjtë e babëzisë, dermani i tyre kryesor në luftën me dhimbjen dhe mërzinë e vazhdueshme; tek priftërinjtë besimi i njëmendtë priftëror, motori i tyre më i mirë i fuqisë; si dhe legjitimimi “epran” i fuqisë; tek shenjtorët, më në fund një pretekst për letargji, *novissima gloriae cupido***

* Ital.: butësi. Në italisht në origjinal.

** Lat.: dëshira më e re për lavdi.

e tyre, paqtimi i tyre në mosqenie ("Zoti"), forma e tyre e çmendurisë. Por te fakti i thjeshtë që idealet asketike kanë pasur një domethënie kaq të madhe për njeriun, shprehet tipari themelor i vullnetit të njeriut, *horror vacui**** i tij: *ai ka nevojë për një qëllim* - dhe ai shpejt do të vendosë mosqenie më mirë sesa mungesë vullneti. - Nuk po kuptoni?... A më keni kuptuar?... "Sigurisht që jo, zotni" - Epo, le ta fillojmë nga fillimi.

2.

Ç'kuptim kanë idealet asketike? Ose, që të marrim një rast të veçantë, në lidhje me atë që më kanë pyetur shpesh, çfarë domethënie ka, për shembull, që një ar-tist si Rikard Vagneri i ka thurur lavd dëlirësisë në ditë e pleqërisë së tij? Është e vërtetë që, në një farë kuptimi, e ka bërë këtë gjithmonë; por në kuptimin asketik vetëm në çastin më të fundit. Ç'kuptim ka pra ky "ndryshim kuptimi", kjo përmbysje e kuptimit - meqë kështu ndodhi, në këtë mënyrë Vagneri u kthye drejt e në të kundërtën e tij. Ç'kuptim ka që një artist të kthehet në të kundërtën e tij? Në këtë pikë (duke pasur parasysh se ne nuk na vjen keq të ndalojmë pak tek kjo pyetje), menjëherë sjellim në mendje periudhën më të mirë, më të fortë, më të lumtur dhe më të spikatur, që mbase ka ekzistuar ndonjëherë në jetën e Vagnerit: kjo është periudha kur ai ishte singërisht dhe thellësisht i zënë me idenë e "Dasmës së Luterit". Kush e di se cilat rrethana janë përgjegjëse për faktin se ne tani

*** Lat.: tmerr nga boshi. Sipas Niçes, ky është fenomeni antropologjik bazë.

kemi Mjeshtrit Këngëtarë në vend të muzikës së tij të dasmës? Dhe sa prej asaj vijon të kumbojë te kjo? Por nuk ka dyshim se edhe motivi i Dasmës do kishte qenë në godi me lavdin e dëlirësisë. Sigurisht ky gjithashtu do të ishte pajtuar me lavdin e sensualitetit - dhe kështu, do të dukej tamam në rregull, edhe kështu do të ishte tamam "vagneriane". Pasi nuk është e nevojshme antiteza midis dëlirësisë dhe sensualitetit: çdo martesë e mirë, çdo lidhje zemre e mirëfilltë e tejkalon këtë antitezë. Mua më duket se Wagneri do të kishte bërë mirë ta kishte sjellë këtë realitet *tërheqës* edhe njëherë në shtëpi tek gjermanët e tij, me anë të një "Komodie Luterieane" të guximshme dhe të hirshme, për ata gjermanë që ishin dhe janë shumë mohues ndaj sensualitetit; dhe mbase merita më e madhe e Luterit është në faktin që pati kurajën e *sensualitetit* të tij (zakonisht është quajtur, me delikatesë "liria ungjillore" ...). Por edhe në ato raste kur ekziston antiteza midis dëlirësisë dhe sensualitetit, fatmirësisht për një farë kohe nuk ka pasur nevojë të jetë një antitezë tragjike. Kjo duhet të vlejë për të gjithë të vdekshmit e mend në kokë e këmbë në tokë, të cilët janë larg së njehuri se s'bën mes arsyeve të kundërta me jetën ekuilibrin e tyre të dobët mes "kafshës" dhe "engjëllit" - shpirtrat më të hollë e më të kthjellët, si Gëtja, si Hafisi, kanë parë tek kjo gjë një joshje të *mëtejshme* të jetës. Këto "konflikte" janë realisht ato që e joshin njeriun për jetën. Nga ana tjetër, kuptohet fare mirë se kur e adhurojnë dëlirësinë derrat e gjorë - dhe të tillë derra ka plot! - vetëm shohin dhe adhurojnë në të antitezën ndaj vetvetes, antitezën ndaj derrave fatkeqë - oh, me çfarë lakmie dhe hungërimë tragjike!

veç mund ta hamendësoni – ata adhuruan atë kontrast meskin dhe të sipërfaqshëm, të cilin Rikard Vagneri në moshë të shtyrë padyshim dëshironte t'ia vendoste muzikës dhe ta vinte në skenë! *Për ç'arsye vallë?* mund të pyetet me të drejtë. Çfarë rëndësie patën derrat për të, çfarë rëndësie kanë për ne? –

3.

Në këtë pikë është e pamundur të mos shtrojmë pyetjen e mëtejshme se çfarë duhet të bënte realisht ai me atë “thjeshtësinë fshatarake” – burrërore (ah, kaq të paburmi) – të atij djallushi të gjorë dhe natyral, Parsifalit, të cilin përfundimisht e bëri katolik nga gjithë ato këshilla mashtruese. Çfarë? Ishte menduar *seriozisht* ky Parsifali? Dikush mund të tundohet të supozojë të kundërtën, madje ta dëshirojë atë – që Parsifali vagnerian ishte një engletisje, si një pjesë përmbyllëse e një trilogjie ose një drame satirike, në të cilën Vagner tragjediani dëshironte të na jepte lamtumirën neve, vetes së tij, mbi të gjitha *tragjedisë*, dhe të vepronte kështu në një mënyrë që do të ishte e volitshme dhe e vlefshme, kjo është, me një teprim të parodisë së shpenguar dhe më ekstreme të vetë tragjikes, të seriozitetit më të kobshëm tokësor dhe të mjerimit tokësor të së vjetrës – një parodi *e fazës më të vrazhdë* në panatyrshmërinë e idealit asketik, që ishte tejkaluar prej kohësh. Kjo, siç kam thënë, do të kishte vlerë për një tragjedian madhështor; i cili si çdo artist fillimisht e arrin kulmin e mbramë të madhështisë së vet kur mund të shikojë *poshtë vetes së tij* dhe artit të tij, dhe kur mund të *qeshë* me veten e tij. A është Parsifali

i Vagnerit e qeshura e tij e fshehtë e superioritetit mbi veten, triumfi i asaj lirie artistike supreme dhe i përtej-sisë artistike të cilën ai e kishte arritur prej kohësh? E dëshirojmë të jetë kështu, se çfarë vlere mund të ketë, *po të merret seriozisht*, Parsifali? Është vërtet e nevojshme të shohim në të (siç patën thënë kundër meje) "pjellën e një urrejtjeje të sëmure ndaj diturisë, shpirtit, dhe kurmit"? Një mallkim i shqisave dhe i shpirtit në një frymë të *vetme* urrejtje? Një apostazi dhe një konvertim tek idealet obskurantiste dhe të sëmura kristiane? Dhe së fundmi, një vetëmohim dhe veteliminim nga ana e një artisti i cili deri në atë çast ia kishte kushtuar gjithë fuqinë e vullnetit të tij të kundërtës, domethënë, shprehjes *më të lartë* artistike të shpirtit dhe trupit. Dhe jo vetëm artin, por dhe jetën e tij. Kujtoni vetëm se me çfarë entuziazmi i ndoqi Vagneri hapat e filozofit Fojerbah. Motoja e Fojerbahut e "sensualitetit të shëndetshëm" tingëllonte në veshët e Vagnerit gjatë viteve tridhjetë dhe dyzet të këtij shekulli, njësoj si dhe në veshët e shumë gjermanëve të tjerë (ata e pagëzuan veten e tyre "Gjermanët e rinj") si fjala e shëlbimit. Po në fund, a *më-soi diçka të re*? Se të paktën duket se ka përfunduar duke dëshiruar të *jepte një mësim të ri* mbi atë subjekt... Dhe jo vetëm në rastin e Parsifalit me trumbetat lart nga skena: në melankolinë e studimeve të mundimshme, të shumta dhe të sikletshme të viteve të mbrame, ka me qindra vende në të cilat shfaqjet një dëshirë dhe një vullnet i fshehtë, një vullnet i përhumbur, i pasigurt, i papranuar për të predikuar kthimin e sigurt prapa, konvertimin, mohimin, kristianizmin, mesjetën, dhe për t'i thënë dishepujve të tij, "Gjithçka është e kotë!

Kërkojeni shpëtimin diku tjetër!" Madje dhe "gjaku i Shëlbuesit" përmendet njëherë.

4.

Më lejoni të them timen në një rast të tillë, i cili ka shumë elementë të dhimbshëm – dhe është një rast tipik: puna më e mirë është ta ndash artistin nga vepra në mënyrë aq të plotë sa ai të mos mund të merret aq seriozisht sa vepra e tij. Ai është fundja premisa e veprës së tij, barku i nënës, trualli, në disa raste fertilizuesi dhe plehu, mbi të cilën dhe prej të cilës rritet ajo – dhe për pasojë, në shumicën e rasteve, diçka që duhet harruar nëse duam të shijojmë vetë veprën. Këqyrja e *originës* së një vepre i takon fiziologëve dhe viviseksionistëve të shpirtit, por kurrë dhe kurrsesi, sot a mot për estetët, artistët. Autori dhe krijuesi i Parsifalit nuk u kursye nga një nevojë për t'u zhytur dhe për të jetuar në thellësitë dhe themelet e tmerrshme të kundërshtive mesjetare të shpirtit, nga nevoja e një shkëputjeje egërshane nga çdo ngritje intelektuale, nga çdo rreptësi dhe disiplinë, nga nevoja për një farë *perversiteti* mendor (nëse lexuesi do ma falë një fjalë si kjo), as më pak e as më shumë sesa i kursehen një gruaje shtatzënë tmerret dhe mrekullitë e shtatzënisë, që, siç kam thënë, duhen harruar nëse don ta gëzosh fëmijën. Ne duhet të ruhem nga konfuzioni, kur artisti bie shumë lehtë për shkak të "contiguity"* psikologjike (që të përdorim terminologjinë angleze); të thuash vetë artisti na *qenkej* në fakt objekti

* Ang.: afërsi.

që ai mund të përshfaqë, imagjinojë dhe shprehë. Në të vërtetë, sikur artisti të konceptonte se qenkej ky objekt, ai sigurisht nuk do ta përshfaqte, konceptonte apo shprehte atë. Homeri nuk do ta kishte krijuar një Akil, as Gëtja një Faust, sikur Homeri të kishte qenë një Akil apo Gëtja të kishte qenë një Faust. Një artist i plotësuar edhe i përkryer është i shkëputur përjetësisht nga "realja", nga aktualja; nga ana tjetër, çmohet fakti se ai nganjëherë mund të lodhet në pikën e dëshpërimit nga "irrealiteti" dhe falsiteti i përjetshëm i ekzistencës së tij më intime – dhe se priret nganjëherë të hidhet në truallin më të ndaluar për të, në realitet, dhe të tentojë të ketë ekzistencë reale. Me çfarë rezultati? Rezultati mund të pikaset – është *velejteti*** tipik i artistit; po ai *velejtet* viktimë e të cilit ra Vagneri në pleqërinë e tij, dhe për të cilin atij iu desh të paguante aq shtrenjtë dhe aq fatalisht (ai për këtë arsye humbi më të vlefshmen pjesë të shokëve). Por tek e fundit, duke e anashkaluar këtë *velejtet* kush nuk do të dëshironte për hir të Vagnerit që ai të na kishte thënë lamtumirë me një mënyrë tjetër, jo me një *Parsifal*, por me një stil më prej fitimtari, më vetëbesues, më vagnerian – një stil më pak mashtrues, një stil më pak të dyzuar në lidhje me kuptimin e vet total, më pak shopenhauerian, më pak nihilist?...

5.

- Ç'kuptim paskan pra idealet asketike? Në rastin e një

** *Velleität*, (ang. *Velleity*, fr. *Velleité*, it. *Velleità*) në gjuhët kryesore evropiane, qysh prej shekullit XVII, do të thotë: vullnet i dobët, zakonisht i artistëve që shpërfaqin njëmijë projekte por nuk realizojnë asnjë vepër.

artisti: *kurrfarë kuptimi...* ose kaq shumë sa janë baras me asgjë... Të eliminojmë në radhë të parë artistët: ata janë tepër larg një pavarësie të mjaftueshme prej botës ose kundër saj, që vlerësimet e tyre dhe ndryshimet në këto vlerësime të meritojnë vëmendje. Në të gjitha kohët ata kanë luajtur rolin e shërbyesit të një morali, një filozofie, ose një feje, pa marrë parasysh se fatkeqësisht kanë qenë shumë shpesh oborrtarët e përkulur të klientëve dhe padronëve të tyre, dhe lajkatarët kureshtarë të fuqive ekzistuese dhe madje të fuqive të reja që do vinin. Të paktën, ata kanë gjithmonë nevojë për një mbrojtje, një mbështetje, një autoritet të strukturuar tashmë: artistët nuk qëndrojnë kurrë vetëm, të qëndruarit vetëm është në kundërshtim me instinktët e tyre më të thella. Kështu, për shembull, Rikard Vagneri "kur erdhi koha" mori filozofin Shopenhauer si eskortën dhe mbrojtjen e tij. Kush do ta konsideronte qoftë edhe të mendueshëm, faktin se ai do të kishte *kurajën* e një ideali asketik, pa mbështetjen që i ofronte filozofia e Shopenhauerit, pa autoritetin e Shopenhauerit që *dominoi* Evropën në vitet shtatëdhjetë? (Kjo, pa marrë parasysh pyetjen nëse do të ishte e mundur ekzistenca e një artisti pa qumështin* e një ortodoksie). Çka na sjell tek pyetja më serioze: Ç'kuptim ka një *filozof* i vërtetë që i bën homazh një ideali asketik, një intelekt i vërtetë të pavarur si Shopenhaueri, një burrë dhe një kalorës me një vezullim prej bronzi, i cili ka kurajën të jetë vetja e tij, i cili di si të qëndrojnë vetë pa prituri për njerëz të tjerë që t'i mbulojnë shpatullat, dhe për këshillat e eprorëve

* Aludim për monologun e famshëm tek Vilhelm Teli

të tij? Fillimisht le të marrim në shqyrtim qëndrimin e Shopenhauerit përballë *artit*, një qëndrim i cili ka qenë jo vetëm për t'u marrë parasysh por edhe joshës për disa tipe njerëzish. Është e qartë se kjo është arsyeja pse Rikard Vagneri *papritmas* iu drejtua Shopenhauerit (i bindur për këtë hap, siç dihet, nga një poet, Hervegu), deri në atë pikë sa bëri që të shpërthente një kontraktë teorike e plotë midis kredove të tija estetike më të hershme dhe atyre të mëvonshme – për shembull, më të hershmet, të shprehura tek *Opera dhe Drama*, më të vonshmet tek shkrimet që botoi nga 1870-a e më pas. Nga ajo kohë dhe më vonë (dhe kjo është kthesa e cila na acaron më tepër) Vagneri nuk pati skrupuj në ndryshimin e gjykimit të tij në lidhje me vlerën dhe pozicionin e vetë muzikës. Çfarë i interesonte atij kur prej asaj dite e mbrapa e bëri muzikën një mjet, një medium, një “grua”, e cila në mënyrë që të harlisej, kishte nevojë për një qëllim, një burrë – që është, drama? Ai papritur kuptoi që *më shumë* mund të ndikohej nga risia e teorisë shopenhaueriane në *majorem musicæ gloriam*** – që do me thënë, me anë të *sovrانيتit* të muzikës, siç e kuptonte Shopenhaueri; muzika shkëputej dhe u kundërvuhej të gjitha arteve të tjera, muzika si arti i pavarur më vete, jo si artet e tjera, që përball refleksione mbi botën fenomenologjike, por më shumë si gjuha e vetë vullnetit, që flet në mënyrë kategorike për “abisin” si shfaqjen e tij më personale, origjinale dhe e drejtpërdrejtë. Rritja e jashtëzakonshme në vlerës e muzikës (një rritje e cila dukej se buronte nga filozofia e Shopenhauerit)

** Lat.: për një lavd më të madh të muzikës.

fillimisht ishte e shoqëruar nga një rritje e padëgjuar në vlerësimin me të cilin mbahej vetë *muzikanti*: ai u bë tani orakull, prift, madje, më shumë se prift, një lloj pipëze për “esencën e brendshme të gjërave”, një telefon i botës së përtejme – sepse tani e tutje nuk fliste vetëm me muzikë, ai e bëri atë ventrilokuistin e Zotit, – ai ligjëronte metafizikë: sa çudi që një ditë foli përfundimisht për *idealet asketike!*

6.

Shopenhaueri e ka shfrytëzuar konceptimin kantian të problemit estetik edhe pse është e qartë se nuk e ka konsideruar me një shikim kantian. Kanti mëtonte se i jepte nderin e vet artit, duke preferuar dhe duke vënë në plan të parë, mes predikateve të së Bukurës, ato që formojnë krenarinë e njohjes: pavetorësia dhe vlefshmëria e përbotshme. Nuk është ky vendi për të diskutuar nëse kjo ka qenë në fund fare, një gabim; dua vetëm të nënvizoj faktin se Kanti, si të gjithë filozofët, në vend që të vërë në fokus problemin estetik duke u nisur nga përvoja e artistit (e krijuesit), ka medituuar mbi artin dhe mbi të bukurën vetëm nga pikëvështrimi i “spektatorit” dhe e ka përfshirë, kësodore, pa e vënë re, edhe “spektatorin” në konceptin e “së bukurës”. Dhe sikur të paktën filozofët e së bukurës ta njihnin mirë këtë “spektator”; pra si fakt të madh dhe përvojë *personale*, si një plotësi përjetimesh të veçanta dhe të forta, dëshirash, surprizash, gëzimesh në sferën e së bukurës! Përkundrazi, druhem se ka ndodhur gjithmonë e kundërta: dhe kështu ata na kanë dhënë, qysh prej fillimeve, përku-

fizime tek të cilat, si tek ai përkufizimi i famshëm që i dha Kanti së bukurës, mungesa e një përvoje më të rafinuar personale mori pamjen e një krimbi të madh, e një gabimi themelor. Kanti ka thënë: “E bukur është ajo që pëlqehet *pa interes*”. Pa interes! Ta krahasojmë këtë përkufizim me një tjetër të dhënë nga një “spektator” dhe nga artist “i vërtetë”, Stendali, që njëherë e quajti të bukurën *une promesse de bonheur*.²³ Këtu refuzohet dhe eliminohet në çdo rast, pikërisht e vetmja gjë që Kanti vlerëson tek kondita estetike: *le désintéressement*. Kush ka të drejtë, Kanti apo Stendali? – Sigurisht që sikur estetët tanë të mos lodhen duke hedhur në peshore, në favor të Kantit, faktin se falë magjisë së artit mund të shihen “pa interes” edhe statuja femrash lakuriq, do të na lejohet fare mirë të qeshim pas shpine me ta – përvojat e *artistëve*, në lidhje me këtë çështje delikate, janë shumë më “interesante”, dhe Pigmalion, nuk duhet të ketë qenë, në asnjë rast, një “burrë jo estetik”. Le ta gjykojmë pra me dashamirësi pafajësinë e estetëve tanë që pasqyrohet në argumente të këtilla, dhe le t’i bëjmë për shembull nder Kantit për atë që di të të mësojë mbi karakteristikat e veçanta të taktit me një naivitet prej famullitari fshati! – Dhe të kthehemi pra tek Shopenhaueri që ishte i afërt me artet në mënyrë krejt të ndryshme nga Kanti, e prapë nuk arriti kurrë të çlirohej nga tërheqja magjike e përkufizimit kantian: si ka ndodhur kjo? Ky fakt është mjaft i çuditshëm: shprehjen “pa interes” ai e interpreton në mënyrën më personale, duke u nisur nga përvoja që për të duhet të ketë qenë më normale se çdo tjetër. Për pak gjëra Shopenhaueri flet me kaq shumë siguri si për efektin e soditjes estetike: thotë

se ajo thjesht kundërvepron ndaj "interesit" seksual, si kamfuri dhe lupulina; ai nuk lodhet kurrë së ekzaltuari këtë çlirim nga "vullneti jetësor" si avantazhi dhe dobia e madhe e konditës estetike. Madje mund të tundohe- mi të pyesim nëse botëkuptimi thelbësor i "Vullnetit dhe përshfaqjes" së tij, mendimi se është i mundur një shëlbim i "vullnetit" vetëm nëpërmjet "përshfaqjes", ka zënë fill nga një përgjithësim i kësaj lloj përvoje të seksit. (Në gjithçka që i përket filozofisë shopenhaueriane, nuk duhet harruar kurrë, e vë në dukje kalimthi, se ajo është konceptimi i një të riu njëzetegjashtë vjeçar; dhe që prandaj ajo është pjesë jo vetëm e specifikes shopenhaueriane, por edhe e specifikes së asaj pjese të jetës). Të dëgjojmë, për shembull, një nga pjesët më domethënëse të shkruara në lavd të konditës estetike (*Bota si vullnet dhe si përshfaqje*, I, f. 231), të dëgjojmë tonin, vuajtjen, lumturinë, mirënjohjen me të cilën janë thënë këto fjalë. "Kjo është gjendja e mungesës së dhimbjes që Epikuri e ekzaltonte si e mirë supreme dhe si gjendje hyjnore; për atë çast jemi të çliruar nga impulsi i pacipë i dashjes, celebroidmë sabatin e punës së detyrueshme të vullnetit, e ndalur rri rrota e Isionit..." Çfarë afshi në këto fjalë! Çfarë imazhi dënimi dhe mërzie të gjatë! Çfarë kundërvënie, gati patologjike, kohe mes "atij çasti" dhe asaj "rrote Isioni", "puna e detyrueshme e vullnetit", "impulsi i pacipë i dashjes"! Ta zëmë edhe se Shopenhaueri ka njëqind herë të drejtë për personin e vet, e çfarë na qenkej arritur me këtë, për një njohje më të mirë të esencës së të bukurës? Shopenhaueri ka përshkruar një efekt të së bukurës, efektin e paqtimt të vullnetit – por ky mandej a është një efekt normal?

Stendali, siç u tha, natyrë jo më pak sensuale, por më harmonike se Shopenhaueri, nënvizon një efekt tjetër të së bukurës: “E bukura *premtton lumturi*”, dhe mëton se e dhëna faktike është pikërisht *ngazëllimi i vullnetit* (i “interesit”) dhe nëpërmjet së bukurës. Dhe, në fund, a nuk mund t’i bëhet vërejtje vetë Shopenhauerit, i cili shumë pa të drejtë këtu e quan veten kantian, se nuk e ka kuptuar absolutisht në mënyrë kantiane përkufizimin kantian të së bukurës – sepse edhe atij e bukura i pëlqen për shkak të një “interesi”, madje për shkak të një interesi tepër të fortë, personal si rrallëherë: atë të të torturuarit që çlirohet nga tortura e tij?... Dhe për t’u kthyer tek pyetja jonë e parë, “*ç’kuptim ka lavdi që i bën një filozof idealit asketik?*” – kemi këtu, të paktën, një udhëzim të parë: ai don të çlirohet nga një torturë.

7.

Të ruhem, para fjalës “torturë” nga vrenjtja e fytyrave: pikërisht në këtë rast ka mjaft për të vënë në llogarinë e kundërt, mjaft për të deduktuar, – mbetet edhe diçka për të qeshur. Të mos e nënvleftësojmë faktin se Shopenhaueri, që e kishte trajtuar sensualitetin sikur në të vërtetë të ishte një armik i tij personal (përfshi veglën e tij, gruan, këtë “*instrumentum diaboli*”), kishte *nevojë* për armiq, për të ruajtur humorin e mirë; sepse i dashuronte pasionet e tërbuara, të vrerta, të zeza dhe të gjelbëreme; tërbohej për t’u tërbuar, për pasion, sepse do të sëmurej, do të bëhej pesimist (- gjë që nuk ndodhi, megjithëse e dëshironte me zjarr) pa armiq të tij, pa Hegelin, gruan, sensualitetin dhe gjithë vullnetin për të

ekzistuar, për të ngelur. Përndryshe Shopenhaueri *nuk* do kishte mbetur, mund ta vëmë bast: armiqtë e tij amà e mbanin, armiqtë e tij e joshnin gjithmonë dhe pandarë për ekzistencën, mëria e tij ishte, si tek cinikët e lashtë, rimëkëmbja e tij, ngushëllimi i tij, shpërblimi, dermani kundër neverisë, *lumturia* e tij. Kjo për sa i përket aspektit më personal të rastit Shopenhauer; veç kësaj ka akoma tek ai diçka tipike, – dhe vetëm tashti kthehemi te problemi ynë. Do të ketë në mënyrë të padiskutueshme, për sa kohë të ketë filozofë në tokë dhe kudo që ka pasur filozofë (nga India në Angli, për të marrë polet ekstreme të talentit filozofik) një acarim dhe një mëri filozofike të veçantë kundër sensualitetit – Shopenhaueri është vetëm shfryrja më elokuyente, dhe nëse kemi veshë për të dëgjuar, edhe shkulmi më tërheqës dhe ngazëllues – në të njëjtën mënyrë ekziston te filozofët një parapritje dhe një përzemërsi krejt e veçantë për sa i takon të gjithë idealit asketik, kundrejt dhe kundër të cilave nuk bëhet dot gjë. Të dyja i përkasin, siç u tha, tipit; nëse njëra gjë apo tjetra do i mungojnë një filozofi, ai do të ngelet – për këtë të jemi të sigurt – vetëm një “i ashtuquajtur”. Ç’do me thënë kjo? Kjo gjendje faktike pikësëpari duhet interpretuar: ajo të rrijë aty budallaqe në amshim, si çdo “gjë në vetvete”. Çdo kafshë, pra edhe *la bête philosophique*, priret instinktivisht kah një *optimum* kushtesh të favorshme, që i lejojnë të shfryjë plotësisht forcën e saj dhe të mbërrijë *maksimumin* në ndjenjën e fuqisë. Po aq instinktivisht dhe me një mprehtësi nuhatjeje “sipërane ndaj çdo arsyeje”, të gjitha kafshët dridhen për vdekje para çdo lloj turbullimi dhe pengese që ua ndalojnë apo pengojnë udhën

drejt *optimumit* (- nuk është udha e saj drejt lumturisë, ajo për të cilën flas, por udha e saj drejt fuqisë, drejt aksionit, drejt një veprimi më të fuqishëm dhe, në shumicën e rasteve, pikërisht udha e saj drejt palumturisë). Njësoj e përçmon martesën filozofi, sikundër gjithçka që mund ta kandisë për të, - martesën si pengesë dhe fatkeqësi në rrugën e tij drejt optimumit. Cili filozof i madh ka qenë i martuar? Herakliti, Platoni, Dekarti, Spinoza, Lajbnici, Kanti, Shopenhaueri - asnjëri nuk ishte; për më tepër, as nuk mund të *mendohen* të martuar. Një filozof i martuar është *për komedi*, kjo është teoria ime: dhe ai përjashtim me emrin Sokrat, i mbrapshti Sokrat, me sa duket, u martua *ironice**, vetëm për të vërtetuar *këtë* teori. Çdo filozof do të fliste si foli njëherë Buda, teksa e njoftuan se i kishte lindur një djalë: "Më lindi Rahula, mu farkëtua një zinxhir"²⁴ (Rahula këtu ka kuptimin "një demon i vogël"); çdo "shpirt i lirë" duket të ketë një orë reflektimi, gjithë, nëse ka pasur përpara një orë shkujdesjeje, siç i ndodhi vetë Budës - "e shtypur dhe e ankthshme - mendonte mesveti - është jeta në shtëpi, në bujtinën e ndyrë; liri është ta braktisësh shtëpinë": "dhe duke menduar kështu, e braktisi shtëpinë".²⁵ Kaq shumë ura drejt *pavarësisë* tregohen në idealin asketik, sa filozofi s'ka si t'i dëgjojë pa u gëzuar në thellësi dhe pa i duartrokitur historitë e këtyre njerëzve të vendosur, që një ditë i thanë jo çdo mungese lirie për të ikur në një *shkretëti* çfarëdo; edhe duke pranuar se ishin vetëm gomerë gjigandë ose madje gjithçka përpos se shpirta të fortë. Ç'kuptim ka,

* Frëng.: ironikisht.

në këtë pikë, ideali asketik për filozofët? Përgjigja ime, që do jetë marrë vesh prej kohësh, është: duke e parë atë filozofi buzëqesh si para një *optimumi* të kushteve të spiritualitetit sipëran dhe fort të guximshëm – dhe me këtë *nuk* mohon “ekzistencën”, madje pohon aty ekzistencën *e vet* dhe *vetëm* atë, e mbase e deri n’atë pikë sa të arrijë thuajse te konceptimi i dëshirës sakrilegje: *pereat mundus, fiat philosophia, fiat philosophus, fiam!... ***

8.

Shihet se nuk janë dëshmitarë dhe gjykatës të pakorruptueshëm të idealit asketik këta filozofët! Ata mendojnë për *vetë*, – ç’u duhet atyre “e shenjta”! Madje mendojnë për atë që për *ta* është gjëja më e domosdoshme: liria nga detyrimet, nga turbullimet, nga zhurma, nga aferat, nga detyrat, nga shqetësimet; kthjelltësi në kokë; valle, hedhje dhe fluturim i mendimeve; një ajër i mirë, i kthjellët, i qartë, i lirë, i thatë, siç është ajri i bjeshkëve, ku çdo qenie kafshërore bëhet më shpirtërore dhe me flatra; qetësi në çdo nëntokë; të gjithë qentë të lidhur më së miri në zinxhirë, asnjë lehje armiqësie dhe mërie pushatake; asnjë tenjë ambicieje të lënduar; rropulli të përvuajtura dhe të nënshtruara, të zëna me punë si gurë mulliri, por të pavënare, zemra e huaj, përtej, në të ardhme, postume, – për ta përmbledhur, me ideal asketik ata nënkuptojnë asketizmin e paqtë të një kafshe të hyjnizuar dhe të aftë tashmë për të fluturuar, që kalon përmbi jetën, më shumë se sa të ndalet

** Lat: u fiktë bota, u bëftë filozofia, u bëfshin filozofët, u bëfsha!

mbi të. Dihet cilat janë tri parullat kumbuese të idealit asketik: varfëri, përvujturi, dëlirësi: dhe vetëm shikojeni nga afër jetën e të gjithë shpirtave të mëdhenj, pje-llorë dhe gjenialë – do të gjenden që të tria gjithmonë deri në njëfarë momenti. Dhe, sigurisht – *kurrë* sikur të ishin pjesë e “virtyteve” të tyre – ç’punë ka kjo specie njerëzish të lartësuar me virtytet! – përpos si kushtet më thelbësore dhe natyrale të ekzistencës së tyre *më të mirë*, të pjellshmërisë së tyre më të bukur. Dhe në këtë lidhje është krejt e mundshme që intelektualizmi i tyre dominues duhet të ngatërrohej në një krenari të shfrenuar dhe të acaruar ose një sensualitet fytes, ose që të arrinte të mëtonte vullnetin e tyre për “shkretëtirë” mbase kundër një prirje për luksin dhe për finesën, dhe njëherësh kundër njëfarë lirie plangprishëse të zemrës dhe të dorës. Por ai intelektualizëm ia doli, pikërisht sepse ishte instinkti *dominues*, që i pohon nevojat e tij mbi të gjithë instinktët e tjera – dhe ia del akoma; po të mos ia dilte nuk do ishte dominues. Te kjo pra nuk ka asgjë prej “virtyti”. Për më tepër, *shkretëtira* për të cilën sapo fola, ku shpirtat e fortë tërhiqen dhe izoloohen – sa ndryshe është kjo shkretëtirë nga ajo që të diturit imagjinojnë në ëndrrat e tyre! Në fakt, në disa raste, janë vetë këta të ditur, shkretëtira. Dhe është e sigurt se të gjithë komedianët e intelektit nuk mund ta përballojnë atë për asnjë çast – për ata një shkretëtirë e tillë nuk është romane as siriane sa duhet, as teatrale sa duhet! Sidoqoftë, deve ka me shumicë: por ngjashmëria mbaron me kaq. Një errësirë e qëllimshme mbase; një bishtnim nga vetja; një frikë nga poderja, përnderimi, gazetatat, ndikimi; një punë e vogël, jeta e përditshme,

diçka që fsheh më shumë sesa të nxjerrë në dritë; një seri kontaktesh të rastit me kafshë të pafajshme dhe paqësore, dhe me zogj që të falin prehje t'i shohësh; një mal për shoqëri, veç jo një mal i vdekur por një që ka sy (pra me liqene); ndonjëherë deri edhe një dhomë në një han plot njerëz, ku je i sigurt se të marrin për tjetërkënd dhe ku mund të flasësh pa teklif me të gjithë – kjo është “shkretëtira”: oh, është boll e vetmuar, besomëni! Kur Herakliti u tërhoq në oborret dhe nën portikët e tempullit gjigand të Artemisë, kjo “shkretëtirë” ishte më dinjitoze, e pranoj: përse *nuk kemi* tempuj të tillë? – (mbase i *kemi*: po mendoj për studion time më të bukur, në *Sheshin San Marko*, në pranverë merret vesh, dhe në mëngjes, mes orës dhjetë dhe dymbëdhjetë). Ajo prej nga arratisëj Herakliti, është ende po ajo gjë nga *e cila* arratisemi tashti ne: potencia dhe llafet demokratike të Hefesëve, politika e tyre, risitë e tyre mbi “perandorinë” (e Persisë, merret vesh), domedumet e tyre prej “të sotmeje” – sepse ne filozofët kemi nevojë sidomos për qetësi përpara *një* gjëje: sidomos përpara çdo “të sotmeje”. Ne përnderojmë heshtjen, ftohtësinë, fisnikërinë, largësinë, të shkuarën, pra gjithçka para të cilës shpirti nuk ka nevojë të mbrohet, të kyçet brenda – diçka me të cilën mund të flitet, pa folur *me zë të lartë*. Mjaf-ton vetëm të dëgjosh tingullin që ka një shpirt kur flet: çdo shpirt ka tingullin e vet, e do tingullin e vet. Ai atje duhet të jetë sigurisht një agjikator, dua të them një kokëbosh, një tigan bosh: ajo që hyn aty, çfarëdo qoftë, del prej aty e zymtë dhe e rënduar, e rënduar nga jehona e boshllëkut të madh. Njëri aty rrallë flet pa u ngjirur: vallë i është marrë zëri nga gjithë ato *mendime*?

Kjo gjë do ishte e mundshme – nëse pyesim fiziologët – por kush mendon me *fjalë*, mendon si orator dhe jo si mendimtar (dhe zbulon se në thelb nuk mendon gjëra, nuk mendon konkretisht, por vetëm në lidhje me gjërat, dhe që mendon në të vërtetë *veten* dhe dëgjuesit e tij). Ky i treti përkundrazi flet në mënyrë të bezdisshme, na hyn nën hundë, ia ndjejmë firomën – pa dashje mbyllim gojën, edhe pse na flet nëpërmjet një libri: toni i stilit të tij zëvendëson arsyen – ai nuk ka kohë, mezi i beson vetes, i gjen fjalët o sot o kurrë. Një shpirt amà, që është i sigurt në vetvete, flet me zë të ulët; e do diskrecionin, lë që ta presin. Një filozof njihet nga shman-gia e tri gjërave shkëndritëse e të zhurmshme, lavdia, sundimtarët dhe gratë: dhe me këtë nuk është e thënë se ato nuk vijnë tek ai. I druhet çdo drite tepër të qartë: prandaj i druhet kohës së tij, edhe “ditës” së tij. Në këtë gjë është si hije: sa më shumë që bie dielli aq më e madhe bëhet. Për sa i përket “përvujtërisë” së tij, ai duron, siç duron errësirën, edhe njëfarë vartësie dhe eklipsi: dhe për më tepër u tutet dëmeve të shkaktuara nga vetëtimat, sprapset i shushatur përpara brishtësisë së një peme tepër të izoluar dhe të ekspozuar, mbi të cilën çdo kohë e keqe i shfryn mërzitë e veta dhe çdo mërzë kohën e vet të keqe. Instinkti i tij “amësor”, dashuria e fshehtë për çka rritet brenda tij, e drejton tek kondita ku çlirohet nga detyra për të menduar *për veten*; në të njëjtin kuptim sikurse instinkti i nënës, tek gruaja, e ka konsoliduar deri më sot gjendjen e vartësisë së gruas në përgjithësi. Fundja nuk kërkojnë shumë këta filozofët, motoja e tyre është: “Kush zotëron, zotërohet” – dhe jo, siç nuk do të lodhem kurrë së përsërituri, falë një virty-

ti, falë një vullneti të meritueshëm vetëpërmbajtjeje dhe thjeshtësie, por sepse zoti i tyre suprem *këtë* pretendon prej tyre, dhe e pretendon urtësisht dhe pa mëshirë; si ai që ka për zemër vetëm një gjë, dhe vetëm për atë mbledh dhe kursen gjithçka, kohë, forcë, dashuri, interes. Ky lloj njeriu nuk ka qejf të shqetësohet nga armiqësitë, dhe as nga miqësitë; harron dhe përçmon me lehtësi. Beson se është gjë e shëmtuar të bësh martirin; “të vuash për të vërtetën” – është diçka që i duhet lënë ambiciozëve dhe heronjve të palkut skenik të shpirtit dhe atyre që kanë kohë për të humbur (përkundrazi ata, filozofët, kanë diçka për të *bërë* për të vërtetën). Përdorin në mënyrë të matur fjalë të mëdha, thuhet, se vetë fjala “e vërtetë” iu ndjell krupë: na paska një tingull kumbues... Për sa i përket mandej “dëlirësisë” së filozofëve, është e qartë se pjellshmëria e kësaj lloj mendjeje qëndron mirëfilli në një sferë tjetër nga ajo e fëmijëve; dhe mbase diku tjetër është edhe mbijetesa e emrit të tyre, pavdekësia e tyre e vogël (me modesti edhe më të vogël shpreheshin në Indinë e lashtë mes filozofëve: “Përse i duhen pasardhësit atij, shpirti i të cilit është bota?”. – Këtu dëlirësia nuk buron prej ndonjë skrupulli asketik apo urrejtjes për shqisat, ashtu sikundër nuk është dëlirësi ajo e atletit ose e kalorësit që u ruhet grave: më shumë është vullneti i instinktit të tyre dominues, të paktën gjatë periudhës së shtatzënisë filozofike të avancuar. Çdo artist e di sa të dëmshme janë raportet seksuale në gjendjet e tensionit dhe të përgatitjes së madhe shpirtërore; për më të fortët dhe për më të sigurtët instinktivisht mes tyre, ky nuk është rasti i një përvoje – përvoje të vështirë, – por është

thjesht instinkti i tyre "amëson" i cili që të përfitojë vepra në masë, përdor këtu pa mbajtur anë (me të gjitha rezervat dhe shtesat e tjera të forcës) *fuqinë* dhe jetën kafshërore: forca më e madhe përdor atëherë më të voglën. Tani mund ta diskutojmë përsëri Shopenhauerin në dritën e këtij interpretimi: spektakli i së bukurës vepronte qartësisht tek ai si një cytës çlirues mbi *forcën kryesore* të natyrës së tij (forcën e reflektimit dhe e një vështrimi më të thelluar); kështu që kjo mandej shpërtheu dhe u bë përnjëherësh zot i vetëdijes. Por kjo nuk përjashton aspak mundësinë që ajo ëmbëlsi dhe plotësi, tipike e gjendjes estetike, të mund të përftohet pikërisht nga përbërësi "sensualitet" (nga i njëjti burim rrjedh ai "idealizëm" karakteristik i vajzave në moshën e pubertetit) – dhe është e mundur, që për rrjedhojë, sensualiteti të mos përjashtohet nga prania e konditës estetike, siç pandehte Shopenhaueri, por të shfigurohet dhe të mos hyjë më në vetëdije si cytës seksual. (Mbi këtë zanafillë do të rikthehem një herë tjetër, në lidhje me problemet akoma më delikate, të *fiziologjisë së estetikës* që deri më sot nuk e kemi prekur as zbuluar kurrë.)

9.

Njëfarë asketizmi, një dorëheqje e rreptë dhe e paqtë, spontane, siç e kemi parë, bën pjesë tek kushtet e favorshme të një spiritualiteti shumë të lartë dhe në të njëjtën kohë te pasojat e tij më të natyrshme: kësodore qysh në krye të herës nuk do ketë arsye për t' u nrekulluar nëse ideali asketik është trajtuar gjithmonë me ndonjë para-

pritje pikërisht nga filozofët. Në një kundërprovë historike serioze, lidhja mes idealit asketik dhe filozofisë shfaqet deri edhe më e ngushtë dhe e ngjeshur. Mund të thuhet se vetëm falë *fijeve orientuese* të këtij ideali filozofia ka mësuar të hedhë mbi tokë hapat dhe çapat e saj – mjerisht, akoma kaq e pasigurt, mjerisht, me një shprehje kaq të pakënaqur, mjerisht, kaq e gatshme për të rënë dhe për të ngelur me barkun përtokë, kjo sakate mallëngjyese me këmbët kërrabë! Filozofisë, në fillim, i ka ndodhur ajo që u ndodh të gjitha gjërave të mira – për një kohë të gjatë nuk patën guximin të ishin vetvetja, shikonin gjithmonë rrotull vetes, se mos ndonjëri donte t’u ndihte dhe kishin deri edhe frikë nga të gjithë ata që i vështronin. Le t’i numërojmë me radhë impulset dhe virtytet e veçanta të filozofit – shtysa e tij drejt dyshimit, impulsi i tij drejt mohimit, drejt pritjes (impuls “efektiv”), impulsi analitik, i kërkimit, i hetimit, impulsi për të guxuar, për të krahasuar, për të ekuilibruar, vullneti i tij për asnjësi dhe objektivitet, vullneti i tij për çdo gjë që është “*sine ira et studio*”* -: a nuk e kemi kuptuar vallë se këto impulse dhe këto virtyte të marra së bashku kanë sfiduar për një kohë shumë të gjatë, nevojat kryesore të moralit dhe të ndërgjegjes? (Për të mos folur mandej për *arsyen* në përgjithësi që Luteri e quante akoma “Zonja Urtësi e urta lavire”). Që një filozof, në rast se do të kishte mbërritur deri te ndërgjegjja do të duhej të ishte ndjerë pikërisht si “*nitimur in vetitum*”** i tëri dhe i bëri – dhe pra që ruhej mirë nga “të ndjerit vetveten”, nga mbërritja te vetëdija?... Si u tha, e njëjta

* Lat.: pa zemërim e pa zell

** Lat.: tërheqja pas së ndaluarës

gjë ndodh për gjërat e mira, për të cilat sot jemi krenarë; edhe pse e matur me metrin e grekëve të lashtë, e gjithë qenia jonë moderne, në masën që nuk është dobësi, fuqi dhe vetëdije e fuqisë, nuk duket tjetër përpos *hybris* dhe pafesi: pasiqë pikërisht gjërat e kundërta të atyre që sot nderojmë, kanë pasur nga ana e tyre, për një kohë shumë të gjatë, ndërgjegjen dhe Zotin që i ruante. I gjithë qëndrimi ynë përballë natyrës është *hybris*, dhuna që i bëjmë natyrës me ndihmën e makinave dhe të gjenisë së shpikjes, kaq të shkujdesur, të inxhinierëve dhe të teknikëve; *hybris* është pozicioni ynë kundrejt Zotit, dua të them, kundër çfarëdo mbretërie etiko-finalistike të fshehur pas leqeve të mëdha të rasisë, – mund të themi, si Karli Sypatrembur në luftë me Luigjin e XI, “je combats l’universelle araignée”***; *hybris* është qëndrimi ynë ndaj vetes; ngaqë mbi veten ne orvatemi të bëjmë eksperimente që nuk do i lejonim kurrë mbi kafshë të tjera, dhe seksionojmë të kënaqur dhe gjithë kërshtëri shpirtin duke hapur mishin e gjallë: të qenit i sëmurë është mësimdhënës, dhe padyshim më mësimdhënës se të qenit i shëndoshë – sot *agjentët patologjikë* na duken edhe më të domosdoshëm se cilido shaman a “shpëtimtar”. Sot ne i bëjmë dhunë vetes, ne arrëthyesit e shpirtit, ne hetues dhe të pandehur, sikur jeta të mos ishte tjetër pos thyerje arrash; pikërisht me këtë, ditë pas dite, duhet të bëhemi domosdoshmërisht gjithnjë e më të vënshtëm në pyetje dhe më të denjë për të shtruar pyetje; dhe pikërisht për këtë, vallë, a edhe më të denjë për të jetuar?... Të gjitha gjërat e mira kanë

*** Fr: unë luftoj merimangën e përbotshme.

qenë dikur gjëra të këqija; çdo mëkat zanafillor është transformuar në një virtytit zanafillor. Për shembull, martesat ngjau për një kohë të gjatë si një fyerje ndaj të drejtës së komunitetit; dikur paguhej një gjobë për të qenë kaq mendjemadh sa të merrje një grua të gjithën për vete (është rasti i *jus primae noctis*,**** ende sot në Kamboxhia privilegj i priftërinjve, këtyre ruajtësve të "zakoneve të mira të hershme"). Ndjenjat e buta, dashamire, falëse dhe mëshiruese – vlera e të cilave u rrit aq shumë sa u bënë, në fund, gati "vlera në vetvetë", për një kohë shumë të gjatë patën kundër pikërisht përçmimin e vetes: vinte turp nga mirësia si sot nga vrazhdësia; (cit. *Përtej të mirës dhe të keqes*). Nënshtrimi ndaj të drejtës: oh me sa shumë kundërshti që fiset aristokrate, kudo mbi tokë, kanë hequr dorë nga ana e tyre prej *hakmarrjes* dhe i kanë lënë të drejtës fuqi mbi ta! "E drejta" ka qenë për një kohë të gjatë një *vetitum*,***** një krim, një risi, u shfaq me dhunë, si dhunë ndaj të cilës u përshtatën pa iu ardhur turp nga vetja. Çdo hap sado i vogël mbi tokë është fituar me çmimin e torturave fizike dhe shpirtërore: të gjithë këtë pikëvështrim "që jo vetëm avancimi, por përparimi, lëvizja dhe transformimi kanë pasur nevojë për martirët e tyre të panumërt", e kam nxjerrë në pah tek *Agu i mëngjesit*. "Asgjë nuk është fituar më shtrenjtë, thuhet aty, se ajo pak arsye njerëzore dhe ndjenjë lirie që përbën sot krenarinë tonë. Por kjo krenari është shkaku për të cilin sot

**** Lat.: e drejta e natës së parë. E drejta e padronit për të shkuar me gruan e sapomartuar natën e parë të martesës duke zëvendësuar burrin legjitim.

***** Lat.: gjë e ndaluar.

na është e pamundur të kemi të njëjtat ndjenja të atyre epokave të pamata të "moralitetit të zakoneve", që i paraprinë "historisë universale", si krye-histori reale dhe vendimtare që ka ngulitur karakterin e njerëzimit: ku vuajtja ishte virtyt, mizoria virtyt, falsiteti virtyt, hakmarrja virtyt, mohimi i arsyes virtyt; dhe përkundrazi mirëqenia konsiderohej rrezik, etja për dije rrezik, paqja rrezik, mëshira rrezik, të qenit të mëshiruar një fyerje, marrëzia hyjni, *gjymtimi* mungesë eticiteti dhe realitet i mbarsur me rrënim!..."

10.

Në të njëjtin libër shpjegohet se nën çfarë *barre* përcmimi iu desh të jetonte racës më të lashtë të soditësve – i përcmonin po aq sa më parë ua kishin pasur frikën! Soditja u shfaq në tokë fillimisht me figurë të maskuar, e dykuptimtë në pamje, me një zemër të keqe dhe shpesh me një kokë prore në vramendje; mbi këtë nuk ekziston asnjë dyshim. Ajo çka është joveprore, përsiatëse, joluftarake tek burrat soditës, shkaktoi rreth tyre, për shumë kohë, një mosbesim të thellë: kundër kësaj nuk ekzistonte derman tjetër përpos futja e *frikës* nga *vetja*. Dhe nga kjo gjë brahmanët e hershëm merrnin vesh shumë! Filozofët më të hershëm ditën t'i japin ekzistencës dhe dukjes së tyre një kuptim, një qëndrueshmëri dhe një sfond, falë të cilave njerëzit nxunë t'u *tuten*: dhe po ta shqyrtojmë këtë gjë me saktësi më të madhe, kjo rrodhi nga një nevojë akoma më thelbësore, pra nga nevoja për të fituar frikën dhe përnderimin. Pasi që ata i gjenin brenda vetes të gjithë gjykimet e vlerës

të drejtuara *kundër* vetes, duhej të mposhtnin çdo lloj dyshimi dhe rezistence kundër "filozofit në vetvete". Dhe ata, burrat e një epoke të frikshme, e bënë këtë me mjete të frikshme: mizoria kundër vetes, ndëshkimi i përgjetur i vetes – qe arma themelore e këtyre eremitëve dhe rinuesve të mendimit të etur për fuqi, që duhet të dhunonin në krye të herës perënditë dhe traditën në mënyrë që të mund t'i *besonin* ata vetë risitë e tyre. Më kujtohet historia e famshme e mbretit Viçvamitra, i cili si rezultat i një vetë-martirizimi mijëravjeçar, kishte përftuar një vetëdije të atillë fuqie dhe një besim të atillë saqë ndërmoi ndërtimin e një *qielli të ri*: simbol i mbrapshtë i historisë më të lashtë dhe më moderne të filozofëve mbi tokë – kushdo që ndërtoi ndonjëherë një "qiell të ri", forcën e gjeti vetëm në *ferrin e tij*... Që t'i përqendrojmë në formula të shkurtra të gjitha këto të dhëna faktike: shpirtit filozofik i është dashur gjithmonë, para së gjithash, të maskohet dhe të fshihet në tipat e *paravendosur* të njeriut soditës, si prift, magjistar, falltar, njeri i fesë në përgjithësi, për të *qenë* disi edhe makar i *mundshëm*: *ideali asketik* i ka shërbyer për një kohë të gjatë filozofit si formë sipërfaqësore, si kusht mundësie për të ekzistuar. Që të mund të ishte filozof ai duhej të jepte një shembull të këtij ideali, që të mund ta jepte këtë shembull duhej të *besonte tek ai ideal*. Pozicioni i izoluar i filozofëve, që e mohon në mënyrë tipike botën, e urren jetën, nuk i beson shqisave, madje nuk ka të tilla, dhe që është mbajtur i ngulitur deri në ditët e sotme, aq sa ka fituar pothuajse vlefshmërinë e një *qëndrimi filozofik* ideal – është më së pari një pasojë e kushteve të pavolitshme ku filozofia në përgjithësi ka lindur

dhe është afirmuar: përderisa, filozofia në fakt nuk do kishte qenë *absolutisht e mundur* për një kohë shumë të gjatë, pa një mbështjellje dhe një veshje asketike, pa një keqkuptim asketik të vetes. Për t' u shprehur në mënyrë më të qartë dhe evidente: *prihti asketik* ka qenë deri më sot forma larvale më e shpifur dhe e errët, e vetmja mbi të cilën filozofia e pati të lejueshme të gjallonte dhe të hiqej zvarrë... A ka *ndryshuar* situata realisht? Insekti me flatra shumëngjyrëshe dhe i rrezikshëm, ai "shpirt" që kjo vemje fshihte në vetvete, a e ka braktisur përfund me të vërtetë fshikëzën e vet dhe a ka dalë në dritë falë një bote më me diell, më të nxehtë, më të kthjellët? A kemi sot kaq shumë krenari, kaq shumë guxim, kaq shumë trimëri, vetësiguri, vullnet shpirti, vullnet përgjegjësie, *liridashje*, që mbi tokë "filozofi" të jetë realisht - i *mundshëm*?...

11.

Dhe vetëm tani, pasi e kemi vëzhguar *prihtin asketik*, do t'i qasemi seriozisht problemit tonë: çfarë do të thotë ideali asketik? - vetëm tani ai bëhet "serioz"; në fakt gjendemi pikërisht para *përfaqësuesit të mirëfilltë të seriozitetit*. "Çfarë do të thotë çdo seriozitet?" - mbase e kemi sakaq mbi buzë këtë pyetje edhe më themelore: një pyetje për fiziologët, siç është e qartë, por që, për momentin, e anashkalojmë. Vetë prihti asket tek ai ideal ka jo vetëm besimin e tij, por edhe vullnetin, fuqinë, interesin e tij. E *drejta* e tij për ekzistencë bazohet dhe rrëzohet tek ai ideal: s'kemi pse habitemi, pra, nëse këtu gjendemi përpara një kundërshtari të tmerrshëm,

gjithë nëse ne jemi kundërshtarët e atij ideali? Një kundërshtar që lufton për ekzistencën e tij kundër mohuesve të këtij ideali?... Nga ana tjetër, sigurisht nuk është e mundur, me shikim të parë, që një qëndrim-marrje kaq e interesuar për problemin tonë mund të jetë dobiprurëse për të; zor se prifti asket do të bëhet makar dhe vetëm mbrojtësi fatlum i idealit të tij, për të njëjtën arsye për të cilin një grua ndesh, zakonisht, një dëshitim, kur zë të mbrojë “gruan në vetvete” – dhe akoma më pak do të mund të jetë vëzhgues dhe gjykatës objektiv në maksimumin e kundërshtisë të ngritur këtu. Duhet madje ta ndihmojmë – gjë kjo që është sakaq më e dukshme – të mbrohet mirë kundër nesh, më shumë sesa të druemi se do të na mundë... Mendimi, përreth të cilit debatohet këtu, është *vlerësimi* i jetës sonë nga pikëvështrimi i priftërinjve asketë: kjo jetë (me gjithçka ku merr pjesë, “natyra”, “bota”, e gjithë sfera e shndërrimit dhe e rrënimit) lidhet nga ata me një ekzistencë krejtësisht të ndryshme, të cilën e përfshin dhe të cilës i kundërvihet, përpos kur *mohon* veten: në këtë rast, në rastin e një jete asketike, jeta shërben si urë drejt ekzistencës tjetër. Asketi e trajton jetën si një rrugë të gabuar që duhet ripërshkuar, së prapthi, deri tek fillimi i saj, ose si gabim që hidhet poshtë – që do të *duhet* të hidhet poshtë nëpërmes aksionit: ngaqë ky kërkon që t’i bashkohemi atij dhe imponon, ku mundet, vlerësimin e *vet* të ekzistencës. Çfarë do të thotë kjo? Një kriter vlerësimi kaq i përbindshëm nuk është shkruar në historinë e njeriut si fakt i jashtëzakonshëm dhe si kuriozitet: është një nga realitetet faktike më të gjera dhe më jetëgjata që kanë ekzistuar ndonjëherë. I lexuar nga një yjësi e

largët, shkrimi me të madhe i ekzistencës sonë tokësore mbase mund të na çojë tek përfundimi i gabuar se toka është *ylli asketik* par excellence, një strofkë për krijesa të pakënaqura, mendjemëdha dhe të krupshme, të paafta për t'u çliruar nga një mërzi e thellë me veten, me tokën, me jetën, por të afta përkundrazi për t'i bërë vetes të gjithë të keqen e mundshme, për kënaqësinë e të bërit keq – mbase kënaqësinë e tyre të vetme. Le të shqyrtojmë sesi prifti asketik shpërfaqet rregullisht, botërisht dhe gati në çdo epokë; nuk bën pjesë tek asnjë racë e veçantë; lulëzon kudo; lind nga çdo shtresë shoqërore. Jo se e ka kultivuar dhe përhapur modulën e vlerësimit me trashëgiminë: është e vërtetë pikërisht e kundërta – një instinkt i thellë ia ndalon në fakt, në tërësi, riprodhimin. Duhet të jetë një nevojë e dorës së parë ajo që bën të rritet dhe të lulëzojë prapë e prapë ky lloj *armiqësor ndaj jetës* – duhet të jetë pikërisht një *interes i vetë jetës* që bën që një tip i tillë vetë-kontradikte të mos zhduket. Sepse një jetë asketike është një vetë-kontradiktë: këtu dominon një *ressentiment* i pashoq, ai i një instinkti të pangopur dhe i një vullneti për fuqi që do të donte të bëhej zot, jo mbi një gjë të jetës, por mbi vetë jetën, mbi kushtet e saj më të thella, më të forta dhe më të nëndheshme; këtu kemi orvatje që të përdoret forca për të dëmtuar burimet e forcës; këtu shikimi plot vrer i zilisë drejtohet edhe kundër mirëqenies fiziologjike; dhe në veçanti kundër shprehjes së saj, bukurisë, haresë; ndërsa *kërkohet* dhe shijohet dështimi, përtharja, dhimbja, fatkeqësia, shëmtia, lëndimi i qëllimshëm, heqja dorë nga vetja, vetë-fshikullimi, vetë-flijimi. E gjithë kjo është paradoks në shkallën më të

lartë: këtu gjendemi përballë një dyzimi, që *don* të jetë dyzim, që vetëkënaqet për këtë vuajtje dhe bëhet gjithmonë e më i sigurt për veten e triumfues në atë masë që *zvogëlohet* presupozita e tij, vitaliteti fiziologjik. "Triumfi, pikërisht në agoninë e fundit": nën këtë emblemë ekstravagante ka luftuar ngahera ideali asketik; në këtë mister të ndjelljes, në këtë imazh ekstaze dhe torture ka njohur dritën e vet më të çelët, shpëtimin e vet, fitoren e vet përfundimtare. *Crux, nux, lux** – aty të tria janë një.

12.

Po ta pranojmë se ky vullnet i mishëruar kontradikte dhe kundër-natyre kandiset të filozofojë: mbi çfarë do ta lëshojë hovin e arbitraritetit të vet të brendshëm? Mbi atë çka me sigurinë maksimale ndihet si e vërtetë, si reale: do të kërkojë *gabimin* pikërisht atje ku instinkti autentik jetësor në mënyrën më të pakushtëzuar të mundshme vendos të vërtetën. Si bënë, për shembull, asketët e filozofisë Vedanta, që e poshtëruan lëndën në iluzion, sikundër dhimbjen, shumësinë, të gjithë antitezën konceptuale "subjekt" dhe "objekt" – i trajtuan si gabime, asgjë përveç se gabime! Heqja dorë nga besimi te Uni vetjak, mohimi i "realitetit" vetjak – çfarë triumfi! – tashmë jo vetëm mbi shqisat, mbi dukjen; një lloj triumfi shumë i lartë, një dhunë dhe një mizori të drejtuar kundër *arsyes*: epsh që vjen, si i tillë, në çastin kulmor kur përcmimi asketik për veten, dhe vetëpërqeshja e *arsyes* shpall: "*Ekziston një mbretëri e së vërtetës dhe*

* Lat.: Kryq, bërthamë, dritë.

e qenies, por pikërisht arsyeja është e përjashtuar prej aty!" ... (E thënë me nënvizim: prapë qoftë edhe në konceptin kantian të "karakterit intelegjibël* të gjërave" ka ndonjë mbetje nga kjo krisje epsharake prej asketi, që vdes t'ia kundërvënë arsyen arsyes, ngaqë "karakter inteligjibël" do të thotë te Kanti një modalitet specifik i gjërave ku intelektin koncepton vetëm se për intelektin gjëja është *krejt dhe plotësisht e pakuptueshme*.) – Dhe ne, pikërisht si njohës, nuk duhet të tregohemi mosmirënjohës kundër këtyre përmbysjeve të vendosura të perspektivave dhe vlerësimeve të zakonshme, me të cilat shpirti është sulur shumë gjatë kundër vetes në mënyrë blasfeme dhe sterile të dukshme: të shohësh njëherë në mënyrë kaq ndryshe, të *duash* të shohësh ndryshe është vetëm një stërvitje dhe përgatitje jo e vogël e intelektit me "Objektivitetin" e tij të përjetshëm – objektivitet i kuptuar jo si "soditje e çinteresuar" (që si e tillë është një jo-koncept dhe një nonsens), por si aftësia për të *pasur në dorë*, për të bërë dhe zhbërë pro-në dhe kundra-n vetjake: kështu që të mësohet si të përdoret për njohjen pikërisht *larmia* e perspektivave dhe e interpretimeve emotive. Zotërinj filozofë, tash e tutje të ruhemi më mirë nga kjo mitologji e lashtë dhe e rrezikshme konceptuale, që ka vendosur një "subjekt njohës të kulluar, pa vullnet, pa dhimbje, përtej kohës"; të ruhemi nga tentakulat e këtyre koncepteve kontradiktore si "arsye e kulluar", "spiritualitet absolut" "njohje e vetes": – këtu kërkohet gjithmonë të mendohet një sy që nuk mund të mendohet, një sy që nuk mund të ketë bash asnjë drejtim, ku duhen ndërprerë, duhet të mungojnë forcat aktive, interpretuese, falë të cilave vetëm të pamët

bëhet një shikim i diçkaje: këtu kërkohet pra gjithmonë një nonsens dhe një jo-koncept syri. Ekziston *vetëm* një vështrim perspektiv, *vetëm* një "njohje" perspektive; dhe *sa më shumë* afekte që i lëmë të flasin mbi diçka, *sa më shumë* sy, sy të ndryshëm që dinë të veprojnë brenda nesh, brenda së njëjtës gjë, aq më i plotë do të jetë "koncepti" ynë për të, "objektiviteti". Por me eliminuar në përgjithësi vullnetin, me i heqë afektet në tërësinë e tyre, gjithë nëse qenka e mundur: si? A nuk do të thotë kjo *ta tredhësh* intelektin?...* Në origjinal është „intelligibler“, që do të thotë, i rrokshëm vetëm prej intelektit, pra i përnjohshëm intelektualisht, në fakt i rrokshëm nga koncepti, pra i entit.

13.

Por le të kthehemi mbrapsht. Një vetë-kundërshti e tillë, si ajo që duket se përshfaqet tek asketi, "jetë kundër jetës" – gjë kjo absolutisht e qartë – në një pikëvështrim psikologjik dhe jo më fiziologjik, duket si nonsens. Ajo mund të jetë vetëm në *dukje* kontradiktë; duhet të jetë njëfarë shprehje provizore, një interpretim, një formulë, një sistemim, një ekuivok psikologjik mbi diçka natyra e vërtetë e të cilës nuk u kuptua për një kohë të gjatë, për shumë kohë nuk u përçanësua *në vete* – një fjalë dhe asgjë tjetër, e ndërkalur në *hendekun* e lashtë të njohjes njerëzore. Që t'i ekspozojmë shkurtimisht faktet kundër realitetit të tij: *ideali asketik lind nga instinkti i profilaksisë dhe i vetë-mbrojtjes së një jete në degjenerim*, që përpiket me çdo mjet që ka në dorë të ruajë pozicionin e vet dhe lufton për ekzistencën e vet; ai sinjalizon një depresion

fiziologjik dhe një shterim, kundër të cilit luftojnë padà dhe me mjete e shpikje të reja instinktët më të thella dhe ende të paprekura të jetës. Ideali asketik është një nga këto mjete: pra është pikërisht e kundërta e asaj që mendojnë adhuruesit e këtij ideali – jeta lufton në të dhe nëpërmjet tij me vdekjen dhe *kundër* vdekjes, idcali asketik është një artificë në *ruajtjen* e jetës. Fakti që ky mandej mundi t’i dominonte dhe t’i zaptonte njerëzit deri në atë pikë që na mëson historia, dhe pikërisht aty ku u afirmua civilizimi dhe zbutja e njeriut, përbën një të vërtetë të madhe faktike: *kondita e sëmurë* e tipit njerëzor deri më sot, të paktën të tipit njerëzor të zbutur, lufta fiziologjike e njeriut me vdekjen (më saktë: me mërzinë e jetës, me lodhjen, me dëshirën “e fundit”), prifti është edhe dëshira e mishëruar e të qenit-tjetër, e të qenit-tjetërkund, dhe në të vërtetë grada më e lartë e kësaj dëshire, zjarri i saj tipik dhe pasioni i saj: por pikërisht *fuqia* e të dëshiruarit të asaj është zinxhiri që e prangos këtu; pikërisht në këtë mënyrë ai bëhet instrument i detyruar për të punuar për krijimin e kushteve më të favorshme të të qenit këtu dhe të qenit-njeri – pikërisht me këtë *fuqi* mban në ekzistencë të gjithë tufën e të dështuarve të çdo lloji, e të pakënaqurve, e të keqtrajtuarve nga fati, e të papërshtaturve, e fatkeqëve, e atyre që *e pësojnë vetveten*, duke iu paraprirë instinktivisht si një bar. Më keni kuptuar saora: ky prift asket, ky armik i dukshëm i jetës, ky *mohues*, bën pjesë pikërisht te forcat më të mëdha *konservatore* dhe *krijuese në sens pohues* të jetës... Nga çfarë vjen kjo gjendje e sëmurë? Që njeriu është më i sëmurë, më pak i sigurt, më i ndryshueshëm, më pak i vendosur se çdo kafshë tjetër, mbi këtë s’ka

dyshim – *ai* është kafsha e sëmurë: dhe nga çfarë buron kjo? Është e sigurt se, më shumë se të gjithë kafshët e marra së bashku, njeriu ka guxuar, rinovuar, sfiduar, provokuar fatin: njeriu, ky eksperimentues i madh i vetvetes, i pakënaqur, i pangopur, që lufton me kafshët, natyrën dhe hyjninë për supremacinë e mbrame, kjo qenie gjithmonë dhe akoma e pazbutur, përjetësisht e realizueshme, që nuk gjen më paqe përballë hovit të vetë forcës së vet, aq sa e ardhmja e vet e nguc pashtershëm në mishin e çdo të tashmeje si një mamuze – si të mos jetë një kafshë kaq e guximshme dhe e pasur, dhe e ekspozuar më gjatë ndaj rrezikut, edhe thellësisht më e sëmurë se të gjitha kafshët e tjera?... Njeriu është velur nga të gjitha këto, mjaft shpesh, bien epidemi të kësaj velje – (si për shembull përreth 1348-ës, në kohën e valles së vdekjes): por edhe kjo neveri, kjo lodhje, kjo mërzi me veten – gjithçka përfton tek ai një fuqi të tillë sa bëhet përnjëherësh një lidhje e re. Jo-ja që ai i thotë jetës, nxjerr në dritë, si për magji, një shumësi po-sh më të rafinuar: madje, kur *plagoset*, ky mjeshtër i shkatërrimit, i vetëshkatërrimit – është pikërisht vetë plaga që e detyron të jetojë.

14.

Sa më normale që të jetë kondita e sëmurë e njeriut – dhe nuk mund ta vëmë në dyshim normalitetin e këtij fakti – aq më tepër duhen vlerësuar rastet e rralla të forcës shpirtërore dhe fizike, *rastet fatlume* të qenies njerëzore, aq më rreptësisht duhen mbrojtur të arrirët nga atmosfera më e pizmosur, ajo e të sëmurëve. Por a

e bëjmë ne këtë?... Të sëmuret janë rreziku më i madh për të shëndoshët; rrënimi për të fortët *nuk* vjen nga më të fortët, por nga më të dobët. A dihet kjo?... Duke folur në përgjithësi, nuk është absolutisht frika e njeriut ajo për të cilën duhet uruar një pakësim: kjo frikë i detyron në fakt të fortët të jenë të fortë, dhe sipas rasteve, të tmerrshëm – ajo mban në këmbë tipin e arrirë njerëzor. Ajo çka duhet pasur frikë, ajo që vepron në mënyrë më fatale se çdo fatalitet tjetër, nuk i bie të jetë frika e madhe, por *neveria* e madhe përballë njeriut; sikurse dhe *mëshira* e madhe për njeriun. Sikur një ditë ato të kryqëzoheshin, diçka fort e mbrapshtë do të vinte përnjëherësh dhe pashmangshëm në botë, “vullneti i mbramë” i njeriut, vullneti i tij për asgjë, nihilizmi. Dhe për këtë rruga është e shtruar. Ai që nuk ka vetëm hundën për të nuhatur, por ka edhe sy e veshë, nuhat sot kudo që shkon, diçka si një atmosferë çmendine dhe spitali – flas, siç e do arsyeja, për rajonet kulturore të njeriut, për çdo lloj “Evrope” që do të lindë në të ardhmen në tokë. *Të ligjtë* janë rreziku i madh për njerëzit: *jo* të këqijtë, *jo* “kafshët e presë”. Ata që janë goditur qysh në fillim nga fatkeqësia, të poshtëruarit, të shkatërruarit – ata *më të dobët*, janë ata që më shumë se të tjerët e minojnë jetën mes njerëzve, që helmojnë dhe problematizojnë, në mënyrën më të rrezikshme, besimin tonë tek jeta, tek vetë ne. Ku mund t’i shpëtosh atij shikimi të mjegulluar që të ngjit një trishtim të thellë, dhe atij shikimi të kthyer mbrapa të atij që është i gjymtë ngahera, shikim që tradhton faktin se si një njeri i tillë flet me vete – atij shikimi që është një psherëtimë! “Të mund të isha një tjetër çfarëdo!” – kështu psherëtimin ky

shikim: "Por nuk ka shpresë: Unë jam ai që jam, si mund të çlirohem nga vetja? Dhe vërtet – *jam velur nga vetja!*". Në këtë truall vetëpërçmimi, kënetë e vërtetë, rritet çdo bar i keq, çdo bimë helmuese, dhe gjithçka është kaq e rrezikshme, dhe gjithçka është kaq e vogël, kaq e fshehur, kaq e rreme dhe kaq e sheqerosur. Këtu gëlojnë krimbat e ndjenjës së hakmarrjes dhe mërisë; këtu ajri kutërbon nga gjëra të fshehura dhe të parrëfyeshme; këtu thuret pa ndërprerje rrjeti i komplotit më djallëzor – komploti i atyre që vuajnë kundër atyre që janë të mirëformuar dhe fitimtarë, këtu pamja e fitimtarit *urrehet*. Dhe sa shumë gënjeshtër për të pranuar se kjo urrejtje është urrejtje! Ç'vërshim fjalësh të mëdha dhe gjestesh të mëdha, çfarë arti "shpifjesh" të ndershme! Ç'përkushtim i sheqerosur, xhelatinoz, i përvuajtuar pluskon në sytë e tyre! Por çfarë duan në të vërtetë? Të paktën të përshfaqin drejtësinë, dashurinë, urtësinë, superioritetin, kjo është ambicia e këtyre "më të poshtërve", e këtyre të sëmurëve! Dhe sa të zotin që të bën kjo ambicie! Le të admirohet veçanërisht zotësia e falsifikatorëve me të cilën imitojnë tiparet e virtytit, edhe tingëllimin, tingëllimin e artë, të virtytit. E kanë marrë me qira, krejt për vete, virtytin, këta të dobët, të pashërueshëm dhe të sëmurë, mbi këtë nuk ka asnjë dyshim: "Vetëm ne jemi të mirët, të drejtët – kështu thonë – vetëm ne jemi *homines bonae voluntatis*".* Vërtiten mes nesh si qortime të mishëruara, si paralajmërime kundër nesh, a thua se shëndeti, tiparet e bukura, forca, krenaria dhe sensi i fuqisë janë sakaq në

* Lat.: njerëzit me vullnet të mirë

vetvete gjëra mëkatore, që një ditë duhen paguar, duhen paguar hidhur: oh, sa të gatshëm janë, në fund fare, të *vënë në punë* spiunët, sa shumë të etur janë nga dëshira për t'u bërë *kasapë*. Mes tyre janë të shumtë në numër individët e babëzitur për hakmarrje të maskuar si gjykatës, që kanë gjithmonë në gojë fjalën "drejtësi" si pështymë helmuese, gjithmonë me një grimasë mbi gojë, gjithmonë të gatshëm për të pështyrë mbi gjithçka që nuk ka një shikim të pakënaqur dhe shkon rrugës së vet me shpirt të paqtuar. Mes tyre nuk mungon as ajo racë absolutisht e krupshme e mendjemëdhenjve, e aborteve të gënjeshtërtë, që nuk priren për asgjë tjetër përpos që të kalojnë për "shpirtra të bukur" dhe të *vënë në shesh*, të mbështjellë me vargje dhe pelena të tjera, sensualitetin e tyre të gjymtë si "dëlirësi zemre": raca e onanistëve moralë dhe e atyre që "i bëjnë qejfin vetes". Vullneti i të sëmurëve për të përfaqësuar një formë *çfarëdo* të superioritetit, instinkti i tyre për shtigje të shkurtër që çojnë tek një tirani mbi të shëndoshët – ku nuk mbërrin ky vullnet për fuqi, tipik pikërisht i më të dobtëve! Dhe në veçanti gruaja e sëmurë: askush nuk ia kalon në rafinimin për dominim, në shtypje, tiranizim. Gruaja e sëmurë, në fakt, nuk kursen asgjë të gjallë, asgjë të vdekur, ringjall gjërat e varrosura më thellë (bogatët thonë: "gruaja është hienë"). Mjafton të shihet jeta e fshehtë e çdo familjeje, e çdo grupi, e çdo komuniteti: kudo lufta e të sëmurëve kundër të shëndoshëve – luftë memece, e bërë kryesisht me pluhura toksike, me shpime gjilpërash, me grimasa durimi hipokrit dhe dinak, e hera herës edhe me atë mënyrë të vepruari fariseje të të sëmurit që reciton më me qejf se asgjë tjetër

“indinjatën fisnike”. Deri tek dhomat e shenjta të shkencës do të donte të dëgjohej lehja e çjerrë e injinjatës së qenve të sëmurë, gënjeshtër helmuese dhe tërbimi i këtyre “fisnikëve” farisenj (ju kujtoj prapë lexuesve që kanë veshë, atë apostullin berlinez të hakmarrjes, Eugen Dyhring, që në Gjermaninë e sotme përdor në mënyrën më të padenjë dhe të neveritshme tamamet e moralit: Dyhringu, kryehorri i moralit në ditë të sodit, deri edhe mes të ngjashmëve të tij, antisemitëve). Këta janë të gjithë njerëzit e *ressentiment*, këto janë qenie fiziologjikisht fatkeqë dhe të brejtura nga krimbi, një mbretëri e tërë tokësore hakmarrjeje të nëndheshme, të pashtershme, të pangopshme në shfryrjet e saj të dhunshme kundër fatlumëve, si në maskaradat e hakmarrjes, në pretekstet e hakmarrjes: kur do mbërrinin vallë në triumfin e tyre të sprasëm, më të rafinuar e sublim të hakmarrjes? Pa pikë dyshimi në momentin kur t’ia dalin që të bëjnë të rrëshqasë në ndërgjegjen e fatlumëve mjerimin e tyre, madje mbarë mjerimin e përgjithshëm: në mënyrë që këta të fillojnë, një ditë të bukur, të turpërohen nga lumturia e tyre dhe t’i thonë njëri-tjetrit: “sa turp të jesh i lumtur, ka tepër mjerim!” ... Por nuk mund të ketë ekuivok më të madh dhe fatal se ai që do kishim sikur të lumturit, të arrirët, të fortët në shtat e shpirt, të fillonin kështu të dyshonin për të drejtën e tyre për lumturi. Mjaft me këtë “botë të përmbysur”! Mjaft me këtë ngordhje të turpshme të ndjenjës! Që të sëmurët të mos i bëjnë të shëndoshët të sëmuren – dhe kjo do ishte një ngordhje e tillë – duhet të jetë perspektiva maksimale në tokë – por për këtë dhe para së gjithash është e nevojshme që të shëndoshët të rrinë të

ndarë nga të sëmuret, të mbrojtur deri edhe nga shikimi i të sëmurëve, që të mos shkëmbehen me të sëmuret. A do të ishte detyra e tyre që të shërbenin mbase si infermierë a mjekë?... Por ata nuk do mund ta hidhnin poshtë e mohonin detyrën e tyre në mënyrë më të keqe se kjo – ajo që është eprane nuk duhet të degradohet në instrument të asaj që është poshtërane, patosi i distancës duhet t'i mbajë të ndara, në përjetësi, edhe detyrat! E drejta e tyre për të ekzistuar, privilegji i kambanës me tingull të kulluar mbi atë të stonuarën, të çjerrën, është, në të vërtetë, një mujë herë më i madh: ata janë dorëzanët e vetëm të së ardhmes, vetëm ata kanë detyrime për të ardhmen e njerëzimit. Ajo çka munden ata, ajo çka duhet ata, nuk është e gjendjes së të sëmurëve me e mujtë a me e dashtë: por në mënyrë që ata të munden atë çka thjesht duhen, si do mundeshin me qenë vallë të lirë me qenë mjekët, ngushëlluesit, "shpëtimtarët" e të sëmurëve?... Pra ajër i pastër! Ajër i pastër! Dhe të rrimë larg nga të gjitha çmendinat dhe spitalet e qytetërimit! Pra, shoqëri e mirë, shoqëri e jona! Ose, nëse s' bëhet ndryshe, vetmi! Por sidoqoftë, rrini larg avujve të ligë të qelbësirës së brendshme dhe brejtjes së fshehtë të të sëmurëve!... Që të mund të mbrohemi të paktën një fije, miq, nga dy mortajat më të këqija që mund të na godasin pikërisht ne – nga neveria e madhe për njeriun! nga mëshira e madhe për njeriun!...

15.

Nëse është kuptuar, në tërë thellësinë e vet – dhe dëshiroj që pikërisht këtu të shkohet deri në fund, të kupto-

het thellësisht – në ç’masë *nuk* mund të jetë absolutisht detyrë e të shëndoshëve ajo e ndihmës ndaj të sëmurëve, e shërimit të të sëmurëve, do jetë kuptuar njëherit edhe një nevojë tjetër – ajo pra që mjekët dhe infermierët të jenë ata vetë të sëmurë: dhe në këtë pikë do të mbajmë të shtrënguar në të dyja duart domethënien e priftit asket. Duhet ta konsiderojmë pra priftin asket si shpëtimtar të paracaktuar, bari dhe mbrojtës i grigjës së sëmurë: vetëm kështu do të mund ta kuptonim misionin e tij historik. *Dominimi mbi lënguesit* është mbretëria e tij, tek ajo e shtyn instinkti i tij, tek ajo qëndron i vetmi art i tij, mjeshtëria e tij, lloji i tij i lumturisë. Duhet të jetë i sëmurë ai vetë, duhet të jetë thellësisht i afërt ndaj atij që është i sëmurë dhe fatkeq, për ta kuptuar – për t’u kuptuar prej tij; por duhet të jetë edhe i fortë, akoma më zot i vetes se të tjerët, pra kompakt në vullnetin e tij për fuqi, që të mund të jetë përkrahje, rezistencë, mbështetje, bashkëveprim, korrigjues, tiran, zot për të. Duhet ta mbrojë grigjën e tij – kundër kujt? Kundër të shëndoshëve nuk ka dyshim, si edhe kundër zilisë ndaj të shëndoshëve; duhet të jetë kundërshtari i natyrshëm dhe përçmuesi i çdo shëndeti dhe i çdo fuqie të palatuar, të stuhishme, të shfrenuar, të vrazhdë, të dhunshme dhe grabitqare. Prifti është forma e parë e kafshës më *delikate*, që përçmon më lehtë nga sa urren. Nuk do të shmangë dot së bëri luftë kundër kafshëve grabitqare, një luftë dinakërie, (të “shpirtit”) më shumë sesa të dhunës, siç është e dukshme – arsye për të cilën, në ndonjë rast, do të jetë i detyruar të përpunojë në vetvete gati një tip të ri kafshe preje, ose të paktën ta përfaqësojë – një monstruoze itet të ri kafshëror, ku ariu polar, pantera e akullt dhe e

zhdërvjellët në pritë, dhe sigurisht jo më pak dhelpira, duken të lidhura në një unjësi sa tërheqëse aq dhe të tmerrshme. Kudo që e lyp nevoja, do të shfaqet mes llojeve të tjera të grabitqarëve me hijen e rëndë të një ariu, dinjitoz, inteligjent, të akullt, sipëran në mënyrë mashtruese, si një kasnec dhe një zëdhënës fuqish misterioze, mendjendarë për të mbjellë kudo që mundet, mbi këtë truall, dhimbje, mosmarrëveshje, vetë-kundërshti, edhe tepër i sigurt për artin e tij të dominimit, në çdo moment, të *atyre që lëngojnë*. Nuk ka dyshim se ai mbart me vete melheme dhe balsame; por për të qenë mjek duhet më parë domosdo të lëndojë; dhe ndërsa e paqton dhimbjen e shkaktuar nga plaga, *infekton njëherazi vetë plagën* – në fakt është i aftë sidomos të kjo gjë, ky magjepsës dhe zbutës kafshësh të egra, në rrethin e të cilit gjithçka që është e shëndetshme bëhet medoemos e sëmurë dhe gjithçka që është e sëmurë bëhet medoemos e butë. Në të vërtetë e mbron mjaft mirë grigjën e tij të sëmurë, ky bari i çuditshëm – e mbron edhe kundër vetes, kundër asaj ligësie, asaj zemërze dhe asaj djallëzie që bëjnë fole deri edhe brenda grigjës dhe kundër gjithçkaje që është tipike e të gjithë të pamundurave dhe të sëmurëve; ai lufton me inteligjencë, vrazhdësi dhe fshehtësi kundër anarkisë dhe kundër vetëshkatërrimit gjithmonë në prag për të lindur në grigjë, ku vazhdon të grumbullohet gjithmonë e më shumë ai material i rrezikshëm eksploziv dhe shpërthyes që është *ressentiment*. Çminimi i këtij eksplozivi, duke shmangur hedhjen në erë të bariut apo grigjës, kjo është kryevepra e tij e vërtetë por edhe dobia e tij më e madhe: po të donim ta përmbyllim në një for-

mulë jashtëzakonisht të thukët vlerën e ekzistencës priftërore, duhet thënë patjetër: prifti është *ndryshuesi i drejtimit për ressentiment-in*. Të gjithë ata që vuajnë, në fakt, kërkojnë në mënyrë instinktive një shkak të dhimbjes së tyre; më saktë akoma, një autor ose, për të qenë më të saktë, një autor përgjegjës – shkurt, një qenie të gjallë çfarëdo, mbi të cilën t'i shkarkojnë me një pretekst çfarëdo faktikisht ose hamendësisht pasionet e tyre; sepse shfryrja e pasioneve personale është përpjekja më e madhe e çlirimit, pra e *trullosjes* së atyre që vuajnë, narkotiku i saj i dëshiruar në mënyrë të pavullnetshme kundër dënimeve të çdo lloji.

“Dikush duhet të jetë përgjegjës për faktin se unë jam keq” – ky tip arsyetimi është tipik i çdo të sëmurit, dhe madje, sa më i fshehur që ngelet për ta shkakun i vërtetë i të qenit keq, ai fiziologjik, (- ai mund të qëndrojë në një sëmurje të *nervous sympathicus* ose në një sekrecion të tepërt të fshikëzës së vrerit, ose tek mungesa në gjak e sulfateve dhe fosfateve, ose në një gjendje presioni të nënvetes që e pengon qarkullimin e gjakut si dhe një degjenerim vezor e të tilla). Të gjithë ata që vuajnë janë tmerrësisht të gatshëm dhe të pasur me iniciativa në gjetjen e justifikimeve për emocione të dhimbshme, ata kënaqen edhe me zilinë e tyre, përumben në mendime, rrëmojnë në rropullitë e së shkuarës dhe të së tashmes së tyre, në kërkim të historive të errëta dhe të dyshimta, ku mund të shullëhen lirisht në një dyshim torturues dhe të trullosen në helmin e vetë ligësisë së tyre – nxjerrin cullake plagët më të lashta, përgjaken duke hapur çibanët tashmë të mbyllur; e transformojnë në keqbërës mikun, gruan, birin dhe gjithë ata që kanë

më afër vetes. "Vuaj: dikush duhet ta ketë fajin" – këtë mendon çdo dele e sëmurë. Por bariu i saj, prifti asket, i thotë: "Është e vërtetë, delja ime! dikush e ka fajin: por ky dikush je ti vetë, ti dhe vetëm ti je fajtorja – ti dhe vetëm ti je fajtoresh për veten tënde!" ... – Kjo është e guximshme sa mjafton dhe e rreme sa duhet: por të paktën kështu mbërrihet diçka, kështu, siç u tha, drejtimi i *ressentiment*... ndryshohet.

16.

Tashmë mund të kuptohet sipas gjykimit tim, ajo çka të paktën ka *tentuar* nëpërmjet priftit asketik instinkti terapeutik i jetës dhe qëllimi për të cilin i është dashur t'i shërbejë një tiranie të përkohshme objektivisht aq paradoksale dhe paralogjike si "faji", "mëkati", "shturja" "mallkimi": për t'i bërë pra, pjesërisht të *padëmshëm* të sëmurët, për t'i detyruar të pashërueshmit për veteliminim, për t'i adresuar të sëmurët jo rëndë vetëm e vetëm kundër vetes, duke e drejtuar *ressentiment*-in e tyre prapa ("vetëm një gjë është e nevojshme")²⁶ dhe për të *shfrytëzuar* kështu instinktun e ligës të çdo vuarjtësi në kuadrin e vetëdisiplinës, të vetëkontrollit, të vetëtejkimit. Është e qartë se nuk mund të bëhet absolutisht fjalë për një "mjekim" të këtij lloji, një mjekim thjesht emotiv, një *shërim* autentik të të sëmurit në sens fiziologjik; as nuk mund të pohohet se këtu instinkti i jetës ka pasur si synim dhe qëllim shërimin. Nga njëra anë, njëfarë përqendrimi dhe organizimi i të sëmurëve (termi më popullor për ta përcaktuar është "Kishë"), nga tjetra, një vënie provizore në shërbim të atij që

është më i shëndetshëm, të atij që është i strukturuar më përsosmërisht, hapja për pasojë e një *honi* mes të shëndoshit e të sëmurit – kjo për një kohë të gjatë, që gjithçka. Dhe që shumë! *Shumë fare!*...

Në këtë ese, siç e shihni, po nisem nga hipoteza që, për sa u takon lexuesve që më nevojiten, nuk jam i detyruar ta provoj paraprakisht – pra që “mëkatësia” e njeriut nuk është një e dhënë faktike, por më shumë vetëm një interpretim i një të dhëne faktike, pra i një shqetësimi fiziologjik – një shqetësim i parë përmes një perspektive moralo-religjioze që nuk ka më asnjë vargan mbi ne. – Fakti se dikush *ndihet* “fajtor”, “mëkatar”, sigurisht që nuk përbën akoma një provë se ai ka të drejtë që ndihet i tillë; njësoj sikundër dikush nuk është i shëndoshë thjesht sepse ndihet i tillë. Le të kujtojmë proceset e famshme të shtrigave: atëbotë gjykatësit më të mprehtë dhe mëshirëplotë nuk ushqenin asnjë dyshim se gjendeshin në prani të një faji; “shtrigat” *vetë nuk e dyshonin këtë* – e prapë faji nuk ekzistonte! – Më lejoni ta shtjelloj këtë hipotezë: unë nuk e pranoj për asnjë çast “dhimbjen e shpirtit” si fakt real, por vetëm si një interpretim (interpretim shkakësor) të dhënash faktike deri më sot jo saktësisht të formulueshme; si diçka, pra, që është akoma krejt në ajër dhe shkencërisht jo bindëse – në të vërtetë vetëm një fjalë e mbufatur në vend të një pikëpyetjeje të thatë – të thatë si gozhdë. Nëse dikush nuk arrin t’i dalë në krye “një dhimbjeje të shpirtit”, kjo nuk varet, për ta thënë trashë, nga “shpirti” i tij; por përkundrazi gjasat janë që të varet më shumë nga stomaku (për ta thënë trashë, siç kam thënë: gjë me të cilën nuk shpreh dëshirën për t’u dëgjuar dhe kuptuar

trashë...). Një njeri i fortë dhe i mirë-formuar i tret përvojat e veta (përfshi të bërat dhe të pabërat e tij), siç tret vaktet, edhe pse është i detyruar të kapërdijë kafshata të hidhura. Nëse nuk arrin "t'i dalë në krye" një përvoje, kjo lloj mostretjeje është po aq fiziologjike sa çdo mostretje tjetër – dhe në të vërtetë shpesh vetëm një pasojë e atyre të tjerave. Mund ta përqafosh një teori të tillë, dhe prapë, e thënë *entre nous**, të jesh pa lënë gjë mangët kundërshtari më i fortë i çdo materializmi...

17.

A është amà përnjëmend mjek, ky prift asket? – E kemi marrë vesh sakaq se deri në ç' masë është e lejueshme ta quajmë mjek, sado që ai vetë ka qejf të ndihet "shpëtimtar", dhe vdes që ta nderojnë si "shpëtimtar". Ai lufton veç dhimbjen në vetvete, të keqen e atyre që vuajnë dhe jo shkakun e tyre, jo gjendjen e vërtetë të sëmurë – kjo duhet të përbëjë vërejtjen tonë thelbësore kundër terapisë priftërore. Por nëse vihem i njëherë në atë perspektivë që vetëm prifti e zotëron dhe e njeh, do të jetë e vështirë me i vendosë kufij admirimit për gjithçka që ka parë, kërkuar dhe gjetur. Lehtësimi i dhimbjes, "ngushëllimi" i çdo lloji – kjo duket si vetë gjenia e tij; me sa shumë naivitet e ka interpretuar detyrën e tij ngushëlluese, me sa shumë mungesë skrupujsh dhe me sa shumë guxim i ka zgjedhur mjetet e përshtatshme! Mund të përcaktohet krishtërimi, në mënyrë të veçantë, si dhoma e madhe e thesarit të mjeteve më shpirtërore

* Niçes i pëlqen frëngjishtja: mes nesh.

të ngushëllimit; shumë ngushëllim, mëshirë, nar-
 kotizim grumbullohen në të, të shumta janë rreziqet e
 mëdha dhe guximet e pamata të marra në sy për këtë
 qëllim, e shumë është finesa e hollë, finesa orientale
 me të cilën ai, në mënyrë të veçantë ka nuhatur se me
 ç'loj stimulsh pasionalë mund të mposhtet, qoftë dhe
 përkohësisht, depresioni i thellë, lodhja e rëndë, trish-
 timi i zi i atij që është psikologjikisht i gjymtë. Meqë, në
 përgjithësi, në të gjitha religjionet është bërë fjalë sido-
 mos për të luftuar një farë lodhjeje dhe rëndimi që është
 bërë epidemik. Paraprakisht mund të supozohet si diç-
 ka e mundshme që në rajone të caktuara të tokës, herë
 mbas here, një *sens depresioni fiziologjik* duhet medo-
 mos të bëjë zap masa të mëdha, që amà, për mungesë
 njohjesh fiziologjike nuk hyn si i tillë tek vetëdija, këso-
 dore "shkaku" i tij, dermani i tij, mund të kërkohet dhe
 provohet vetëm në rrugë psikologjiko-morale (në fakt
 kjo është formula ime më e përgjithshme për atë që,
 përgjithësisht, përcaktohet "religjion"). Një ndjenjë e
 këtillë depresioni mund të ketë origjina nga më të ndry-
 shmet: mund të jetë rezultati i kryqëzimit të racave
 tepër heterogjene (ose i klasave - klasat sociale shpre-
 hin gjithmonë edhe diferenca origjine dhe race: "dhim-
 bja kozmike" evropiane "pesimizmi i shekullit XIX"
 është thelbësisht rezultati i një përzierje të beftë dhe të
 pakuptimtë klasash); si rezultat i një emigrimi të gabuar
 - një racë që ka qëlluar në një klimë me të cilën nuk ka
 forcën e mjaftueshme për t'u përshtatur (ky është rasti
 i indianëve në Indi); ose si pasojë e një plakjeje a një
 dobësimi të racës (pesimizimi parizien duke filluar nga
 1850-ta); apo si një dietë jo korrekte (alkoolizmi i Mes-

jetës; marrëzia e *vegetarians* që gjithsesi kanë autoritetin e tyre prej Kristofori xhentëlmen shekspirian); apo si pasojë e një prishjeje të gjakut, malarie, sifiliz, e të ngjashme (depressioni gjerman pas luftës 30 vjeçare, që gërbuli gjysmën e Gjermanisë me sëmundje të tmerrshme e që ia përgatiti kështu terrenin servilizmit gjerman dhe burracakërisë gjermane). Në këtë rast gjithmonë ka orvatje, në shkallë të gjerë, për një *luftë kundër ndjenjës së depresionit*; le të informohemi pra shkurtimisht mbi praktikat dhe format e saj më të rëndësishme. (Po lë këtu plotësisht mënjanë, çka duket sheshit, të folurit për luftën tipike të *filozofëve*, zakonisht, gjithmonë të njëhershëm, kundër ndjenjës së depresionit, – është një luftë mjaft interesante, por tepër absurde, tepër e shpërfillshme në fakt, tepër e ngjashme me një pëlhurë merimange, tepër prej bjerraditësish: për shembull, kur duan të tregojnë se vuajtja është gabim, me hamendësimin naiv se vuajtja *duhet* të zhduket mu në momentin kur zbulohet gabimi që fshihet aty – por, pa shih pa shih! ajo vetëm për t’u zhdukur që s’zhduket...) Ai depresion dominues luftohet *në radhë të parë* me mjete që e reduktojnë ndjenjën e jetës në përgjithësi në një nivel fare të ulët. Mundësisht, kurrnjë vullnet më, kurrnjë dëshirë më; shmangia e çdo gjëje që shkakton pasion, që bën “gjak” (mosngrënia e kripës: higjiena e fakirit); mos-dashuri; mos-urrejtje, mos-trazim, mos-hakmarrje; mos-pasurim; mos-punë; lypje lëmoshe; mundësisht asnjë grua, ose sa më pak gra që është e mundur; parimi i Paskalit «*il faut s’abêtir*»*, i

* Fr.: Duhet me u bagtizue.

parë nga një perspektivë spirituale. Rezultati, i thënë në terma psikologjiko-moralë, "shkëputja nga vetja", "shenjtërimi", thënë në terma fiziologjikë: hipnotizimi – përpjekja për ta çuar njeriun për afërsisht tek ajo që për çdo specie kafshërore është *letargjia dimërore*, për shumë bimë të klimave të nxehta *letargjia verore*, një minimum shpenzimi energjetik dhe metabolizmi, ku jeta mezi vazhdon të qëndrojë në këmbë, pa e mbërritur akoma pragun e ndërjegjes. Për këtë qëllim është shpenzuar një sasi e pabesueshme energjie njerëzore – vallë a më kot?... Nuk mund të ketë pikë dyshimi se këta *sportsmen* të "shëndetit", me të cilët gëlon gati çdo epokë e çdo popull, kanë gjetur vërtetë një çlirim të sinqertë nga ajo gjë të cilën e luftonin me një *training* aq rigoroz – në raste të panumërta ata janë *shëlbyer* realisht nga ai depresion i thellë fiziologjik, falë ndihmës së sistemit të tyre të mjeteve hipnotike: arsye për të cilën metodika e tyre njihet mes fakteve më të përgjithshme etnologjike. Kësodore është gjë pavend që ta konsiderojmë këtë plan për ta vdekur elementin trupor dhe dëshirat, mes simptomave të marrëzisë (siç ia kënda të bëjë një sorollopi ngordhalaq "mendimtarësh të lirë" dhe Kristoforësh fisnikë ngrënës *roast-beef*-ësh). Aq më i sigurt është përkundrazi fakti se metodika e tyre i çel udhën gjithfarë shqetësimeve mendore, "dritave të brendshme", si për shembull në rastin e "hezikastëve" të Malit Atos, halucinacioneve optike dhe akustike, shpërthimeve dhe ekstazave epshore të sensualitetit (*Historia e Shenjtes Terezë*). Interpretimi që u bëhet këtyre gjendjeve të sensualitetit nga ata që vuajnë prej tij ka qenë gjithmonë kulmi i falsitetit fanatik, gjë që

shpjegohet vetiu. Theksi i mirënjohjes më të përvulur, që tejshihet sakaq te *vullneti* për një interpretim të këtij lloji nuk duhet lënë aspak pas dore. Gjendja supreme, *shpëtimi* vetë, ajo qetësi dhe ajo hipnozë totale e arritur më në fund, është për ta gjithmonë mister në vetvete, që nuk mund të shprehet as me simbolet më të mëdha, si një prag dhe një hyrje tek fundi i gjërave, një çlirim nga çdo iluzion, si "dija", "e vërteta", "qenia", si një arrati nga çdo qëllim, nga çdo dëshirë, nga çdo bërje, një e përtejme e së mirës dhe së keqes. "E mirë dhe e keqe" - thotë budisti - "janë të dyja zinxhirë: të dyja kanë qenë të dominuara nga e Përsosura"; "Fakt dhe jo fakt" - thotë besimtari i Vedantave, "nuk i sjellin asnjë dhimbje; njësoj si i urti e shkund nga vetja të mirën dhe të keqen; asnjë veprim nuk e mundon më mbretërinë e tij; përtej së mirës dhe së keqes, përtej këtyre dy gjërave ai ka shkuar": një konceptim ky, tipik për tërë botën indiane, sa brahmanike aq edhe budiste. -(As në mënyrën indiane të të menduarit, as në atë kristiane, ai "çlirim" nuk ngjan i *arritshëm* me virtytin, me një përmirësim moral, sado lart që ta vendosin vlerën hipnotike të virtytit: dhe kjo qoftë e dhënë si e sigurt - nga ana tjetër i përgjigjet thjesht realitetit të gjërave. Fakti se mbeten të vërteta mbi këtë pikë, mund të konsiderohet mbase si fragmenti më i mirë i realizmit në tri fetë më të mëdha, që përndryshe janë thellësisht të moralizuara. "Për ata që dinë nuk ka detyrime...". "Shpëtimin nuk e sjell *përfitimi* i virtyteve: pasi që ky qëndron në të qenit njësh me brahmanin, i paaftë për asnjë përftim perfeksioni; aq më pak *zhveshja* nga mëkatet, pasiqë brahmani, të qenit njësh me të cilin është ajo çka përbën shpëtimin, është

përjetësisht i pastër” –këto pasazhe nga komenti i Çankaras, janë përmendur nga *njohësi* i parë i vërtetë i filozofisë indiane në Evropë, miku im Paul Dojzen.)²⁷ Le ta nderojmë pra “shpëtimin” tek fetë e mëdha; përndryshe e kemi pak të vështirë të qëndrojmë seriozë përpara vlerësimin të *gjumit të thellë* të këtyre pesimistëve të këputur që janë tepër të lodhur qoftë edhe për të ëndërruar – ndaj *gjumit të thellë*, pra, si shkrimje tek brahmani, si përfitim i *unio mystica*** me Zotin. “Kur ta ketë zënë gjumi krejt” –pohon në lidhje me këtë “shkrimi” më i lashtë dhe më i pënderuari – “e të ketë mbërritur qetësinë absolute, në mënyrë që të mos shohë asnjë imazh ëndrre, atëherë, o i shtrenjtë, ai është i bashkuar me Qenien, ka hyrë brenda vetes – i mbështjellë me Unin në njohje absolute, nuk ka më asnjë vetëdije për atë që është e brendshme dhe e jashtme. Mbi këto ura s’kalon as dita, as nata, as pleqëria, as dhimbja, as vepër e mirë, as vepër e keqe.” “Në gjumë të thellë” – thonë mandej besimtarët e kësaj feje, më e thella nga tri fetë e mëdha – “shpirti ngrihet dhe del nga ky trup, depërton në dritën supreme dhe kësodore shfaqet në figurën e tij: ai është rrjedhimisht vetë shpirti suprem, që sillet duke bërë hoka, duke luajtur e duke u argëtuar, me gra, me karroca ose me miq; mendimet e tij nuk kthehen më mbrapsht tek ajo shtojcë trupore me të cilën është ngjitur *prâna* (fryma jetësore) si kafsha që tërheq karrocën”. Megjithatë edhe këtu, si në rastin e “shpëtimit”, do të mbajmë parasysh faktin se në fund, qoftë edhe me madheshtinë e ekstravagancës orientale, edhe këtu shprehet vetëm një vlerësim i ng-

** Lat.: Bashkimin mistik.

jashëm me atë të të qartit, të ftohtit, të ftohtit porsit grek, por të vuajturit Epikur: sensi hipnotik i hiçit, qetësia e gjumit më të thellë, shkurt *mungesa* e dhimbjes – kjo mund të përfaqësojë për ata që vuajnë dhe për ata që janë rrënjësisht të pakënaqur sakaq të mirën sipërane, vlerën e vlerave, kjo *duhet* vlerësuar nga ata pozitivisht, duhet ndjerë si *pozitivja* në vetvete. (Sipas vetë logjikës së ndjenjave, hiçi, në të gjitha fetë pesimiste, quhet *Zot*.)

18.

Një mpirje e tillë hipnotike e ndjeshmërisë, e aftësisë për të ndjerë dhimbje, që presupozon sakaq forca më të rralla, para së gjithash kurajë, përçmim të opinionit, “stoicizëm intelektual”, është më pak e shpeshtë se një *training* tjetër kundër gjendjeve depresive i cili, sidoqoftë, është më i lehtë: *veprimtaria mekanike*. Nuk ka dyshim që, falë kësaj, një ekzistencë e dhimbshme ndihet e lehtësuar në mënyrë të konsiderueshme; ky fakt përvijohet sot, me njëfarë pandershmërie, me emrin “bekimi i punës”. Lehtësimi qëndron te kjo: që interesi i atij që vuan, shmanget rrënjësisht nga vuajtja – në monopolizimin e pandërprerë të ndërgjegjes nga veprimi, arsye për të cilën tek ajo mbetet pak hapësirë për dhimbjen: pasi është *e ngushtë*, kjo oda e ndërgjegjes njerëzore! *Veprimtaria mekanike* me gjithçka që e shoqëron – sikundër rregullsia absolute, bindja e përpiktë dhe e pamenduar, rutina kronike e mënyrës së jetesës, mbushja e krejt kohës, njëfarë lejimi, madje njëfarë detyrimi, për

* Lat.: shpërfillje për veten.

të qenë "pavetor", për harrim të vetes, "*incuria sui*"*: me çfarë radikalizmi dhe me sa finesë ka ditur me e përdorë prifti asket gjithë këtë në luftën kundër dhimbjes! Pikërisht në rastet kur kishte të bënte me vuajtës të shtresave të ulëta, me skllevër të punës ose të burgosur (ose me gratë, që në fakt, janë kryesisht të dy gjërat së bashku, skllave të punës dhe të burgosura), i mjaftonte diç më shumë se njëfarë aftësie në ndryshimin e emrave dhe në ripagëzim për t'u treguar atyre në gjërat e urryera, një të mirë, një lumturi relative – pakënaqësia e skllavit për fatin e tij megjithatë *nuk* është shpikur nga priftërinjtë. – Një mjet akoma më popullor në luftën kundër depresionit është paracaktimi i një *gëzimi të vogël*, që është i lehtë për t'u arritur dhe mund të kthehet në rregull; kjo terapi përdoret shpesh së bashku me ato që përmendëm qëparë. Forma më e shpeshtë, nën të cilën rekomandohet gëzimi si ilaç është gëzimi *i të shkaktuarit* gëzim (si të bësh mirë, të dhurosh, të rrisësh, të ndihmosh, të kandisësh, të ngushëllosh, të mburrësh, të lavdërosh); duke këshilluar "dashuri për tjetrin". Prifti asket këshillon në fund të fundit një nxitje të instinktit më të fortë dhe më vital, edhe pse të dozuar me shumë kujdes – të *vullnetit për fuqi*. Lumturia e "epërsisë më të vogël", që rrjedh nga bamirësia, nga të qenit i dobishëm, nga ndihma, nga elozhimi, është terapia më e pasur e ngushëllimit që përdorin zakonisht të gjymtët fiziologjikisht, gjithë nëse këshillohen mirë: në rastin e kundërt, duke iu bindur natyrisht të njëjtit instinkt bazal, i bëjnë njëri-tjetrit keq. Një hetim mbi origjinat e krishterimit në botën romake, na tregon shoqata për kujdesin ndaj më të varfërve dhe të sëmurëve, tarafe të

përzishme, të rritura në shtresat më të ulëta të shoqërisë së kohës, ku zbatohet me vetëdije kjo terapi kryesore kundër depresionit, pra gëzimi i vogël, ai i përfitimit të ndërsjellë – vallë a ishte kjo atëherë diçka e re, një zbulim i vërtetë? Me “komunitet”, “caenacula”^{**}, ky vullnet për fuqi, i stimuluar kësodore, qoftë edhe minimalisht, do të arrijë në mënyra shprehjeje të reja dhe më të plota. *Organizimi në kope*, në luftën kundër depresionit, përbën një hap dhe një fitore thelbësore. Me rritjen e komunitetit maturon, edhe për individët, një interes i ri, që mjaft shpesh e ngre përtej momentit krejt personal të pakënaqësisë vetjake, të përçmimit të *vetes* (“*despectio sui*” të Zhëlinksit). Në dëshirën për t’u çliruar nga pakënaqësia konfuzë dhe nga sensi i dobësisë, të gjithë ata që janë të sëmurë ose priren kah sëmundja gjakojnë instinktivisht për një organizim në kope; prifti asket e pikas këtë instinkt dhe e nxit; aty ku ekzistojnë grigja, ka qenë instinkti i dobësisë që e ka dashur grigjën, dhe mprehtësia priftërore që e ka organizuar. Nuk duhet harruar, në fakt, se të fortët priren të *përçahen* me po atë nevojë natyrale me të cilën të dobët priren të *përbashkohen*; nëse të parët bashkohen, kjo ndodh vetëm në perspektivë të një aksioni të përbashkët ofensiv dhe të një kënaqjeje të përbashkët të vullnetit të tyre për fuqi, jo pa rezistenca të mëdha nga ana e ndërgjegjes individuale; të tjerët, përkundrazi, përbashkohen, *duke shijuar* pikërisht këtë bashkim – pasiqë duke bërë kështu instinkti i tyre është shumë i kënaqur, sa instinkti i atyre që kanë lindur “zotër” (pra i llojit të vetmuar

^{**} Lat.: rrethe ku hahesh.

të njerëzve pretarë) është i irrituar dhe i shqetësuar, tekembramja, nga organizimi. Në fund të çdo oligarkie – e gjithë historia na e mëson – fshihet gjithmonë epshi i *tiranisë*; çdo oligarki dridhet vazhdimisht për shkak të tensionit që i duhet çdo anëtar i të përveçëm për ta dominuar këtë epsh. (Kjo lloj sjelljeje, për shembull, është greke: njëqind pasazhe të Platonit e dëshmojnë, të Platonit që i njihnte të ngjashmit e vet – sikurse vetveten...)

19.

Mjetet e priftit asket, të cilat i kemi njohur deri më tash – mpirja e ndjenjës së jetës, energjia mekanike, gëzimi minimal, sidomos metoda e “*duaje fqinjin tënd*”, organizimi në kope, zgjimi i sensit të fuqisë së komunitetit çojnë, për pasojë, te neveria e individit për veten që eklipsohet nga kënaqësia e tij për mbrothësinë e grupit dhe janë, të para në një optikë moderne, instrumentet e tij të *pafajshme* në luftën kundër pakënaqësisë: le të shqyrtojmë tani atë më interesanten, metodën “*fajtores*”. Kjo metodë synon një gjë: të shkaktojë *aberrim të ndjenjës* – që përdoret si mjeti më efikas kundër gjendjes së tyre të shurdhët, të gjatë, paralizuese të dhimbjes; kjo është arsyeja përse naiviteti priftëror ka qenë i pashtershëm në përsiatjen e kësaj çështje: “*Me çfarë mjeti shkaktohet aberrimi i ndjenjës?*” ... Kjo tingëllon e rëndë: është e qartë se do ishte shumë më e këndshme dhe mbase më e pëlqyeshme për veshin sikur të thosha: “Prifti asket e ka përdorur gjithmonë në avantazh të vetin *entuziazmin* që përmban çdo emocion i fortë”. Por ç’*e mirë* na vjen po të lehtësojmë akoma veshët e varur të të femër-

zuarve tanë modernë? Ç' të mirë bëjmë ne nga ana jonë, po t'i lëshojmë qoftë edhe një hap peksnifjanizmit* të fjalëve të tyre? Për ne psikologët, kjo do ishte sakaq një *peksnifjanizëm në veprim*, pavarësisht faktit se do të na vijë ndot prej tij. Në fakt, psikologu e bazon sot *shijen e mirë* të tij - (të tjerë do thoshin: ndershmërinë e tij), nëse ka kund ndonjë bazë, te kundërvënia ndaj asaj mënyre të foluri të *moralizuar* paturpësisht që sot leros çdo gjykim modern mbi njerëzit dhe mbi gjërat. Të mos të mashtrohemi në lidhje me këtë: ajo që përbën shenjën dalluese më tipike të shpirtit modernë, të librave modernë, nuk është gënjeshtria, por *pafajësia* që është pjesë e pandershmërisë së tyre intelektuale. Nevoja për ta vënë në dukje gjithandej këtë "pafajësi" - kjo përbën mbase pjesën më të neveritshme të punës sonë, të gjithë asaj pune në vetvete të pashmangshme, me të cilën duhet të ngarkohet sot një psikolog; është pjesë e rrezikut tonë të *madh* - është një udhë, që mbase na çon pikërisht *ne* tek neveria e madhe... Nuk kam asnjë dyshim për atë çka vetëm librat modernë do të shërbenin (gjithë nëse do të mbesin, gjë për të cilën sigurisht nuk kemi pse tutemi), dhe gjithë nëse ekziston një pasardhje e pajisur me një shije më të rreptë, më të vrazhdë, më të *shëndoshë*) - për çka do shërbente ose mund të shërbente *gjithçka që është moderne*: mund të shërbejë si emetik** - dhe kjo falë ëmbëlsimit dhe falsitetit të tyre moral, falë feminizmit të tyre thellësisht intim, që përkufizohet me qejf si "idealizëm", e që madje e be-

* Që shtiret si dashamirës e njeriu me moral të lartë. Sipas Seth Peksnifjanit, personazh tek romani *Martin Çazëlluiti* (1843), i Dikensit.

** Ilaç që shërben për të vjellë.

son se është. Të diturit tanë të sotëm, "të mirët" tanë nuk gënjejnë – është e vërtetë: por kjo *nuk* i nderon ata! Gënjeshtria e vërtetë, gënjeshtria autentike, e vendosur, "e ndershme" (mbi vlerën e saj mund të dëgjoni Platonin)²⁸ do ishte për ta diçka tepër e rreptë, diçka tepër e fortë; ajo do të lypte atë që nuk është legjitime të pretendohet prej njerëzve, pra që të hapin sytë mbi veten, që të dinë ta bëjnë, në veten e tyre, dallimin mes "së vërtetës" dhe "së rremes". Atyre iu shkon vetëm *gënjeshtria e pandershme*; gjithçka që sot e vë në lojë një "njeri të mirë" është absolutisht e papërshtatshme për çfarëdo qëndrimi tjetër përpos atij të një gënjeshtari të pandershëm, gënjeshtari absolut, por jo më pak edhe të pafajshëm, sy-kaltër, virtuoz. Këta "njerëz të mirë" - sot janë të gjithë thellësisht të moralizuar dhe, për sa i takon ndershmërisë, janë të shtrembëruar e të gjymtuar përjetësisht: cili prej tyre do ta duronte akoma një të vërtetë "rreth njeriut"!... Ose, për ta bërë më konkrete pyetjen: kush prej tyre do të toleronte një *biografi* të vërtetë!... Dy shembuj: Lord Bajroni hartoi një jetëshkrim tepër personal, por Tomas Mauri ishte "tepër i mirë" për një gjë të tillë: ai i hodhi në zjarr letrat e mikut të tij.²⁹ Të njëjtën gjë thuhet se ka bërë dr. Guineri, zbatuesi i testamentit të Shopenhauerit: pasi edhe Shopenhaueri kishte shkruar diçka *kundër* vetes ("εις εαυτόν"). Amerikani virtuoz Thejër,³⁰ biograf i Bethovenit, e ndërpreu papritur punën e tij: pasi kishte mbërritur deri në njëfarë pike të kësaj jete të thjeshtë dhe të nderuar, nuk arriti ta duronte më... Morali: cili njeri me mend në krye do të shkruante akoma një fjalë të ndershme mbi veten? – do të duhej t'i përkiste në këtë rast Urdhrit të Shen-

jtë të Kokëshkretësisë. Na premtohet një autobiografi e Rikard Vagnerit:³¹ kush dyshon te fakti se do të jetë biografi e *grykueshme*?... Të kujtojmë akoma tmerrin kozmik që ngjalli në Gjermani prifti katolik Jansen³² me përshfaqjen e tij, të përciptë dhe naive përtej çdo imagjinate, të lëvizjes gjermane të Reformës; çfarë do të ndodhte vallë, sikur dikush të na rrëfente një Luter autentik, pa delirësinë morale të një prifti fshati, pa erzin e sheqerosur dhe të respektueshëm të historianëve protestantë, por përkundrazi me kurajën e paepur të një Taine, që vrundullon prej *forcës së karakterit* dhe jo prej një tolerance të kujdesshme të forcës?... (E thënë me germa të mëdha, gjermanët kanë prodhuar së fundmi me sukses tipin klasik të kësaj tolerance – mund t’ia atribuojnë vetes qysh tash, mund t’i atribuojnë vetes lavdin: në personin e Leopold Rankes së tyre, ky *advocatus* klasik, i lindur, i çdo *causa fortior*,* ky esnaf mes të gjithë esnafëve “oportunistë”.)

20.

Por sakaq duhet të më keni kuptuar. – Thënë shkurt: a nuk është kjo, tekembramja, një arsye e mjaftueshme që ne psikologët sot të mos largohemi kurrë prej njëfarë mosbesimi *kundrejt vetes sonë*?... Mbase edhe ne jemi ende “shumë të mirë” për zanatin tonë, mbase jemi edhe ne viktimë, preja, të sëmurët e kësaj shijeje të moralizuar të kohës, sado që mund të ndihemi përçmues të saj – mbase ajo na infekton akoma edhe ne. Nga

* Lat.: shkak më i fortë.

çka paralajmëronte ai diplomati, duke u folur të ngjashmëve të tij? "Të mos u besojmë, zotërinj, sidomos reagimeve tona të para! - thoshte - *Janë gati gjithmonë të mira...*" Po kështu duhet t'u flasë sot çdo psikolog të ngjashmëve të tij... Dhe kështu kthehemi tek problemi ynë, që në të vërtetë kërkon nga ne njëfarë rreptësie, njëfarë mosbesimi, sidomos kundrejt "reagimeve të para". *Ideali asketik në shërbim të një aberrimi ndjenje të paraven-dosur* - kush e mban mend atë që thashë më përpara, ka për ta ditur sakaq pjesërisht, përmbajtjen, e përqendruar në këto dhjetë fjalë, të asaj çka do të ekspozohet. Ta shkëpusësh sojin njerëzor nga të gjithë ushqyesit e tij, ta zhysësh në tmerre, akull, flakë dhe ëndje, aq sa ta bësh të izolohet nga të gjitha, si më një të shtënë rrufeje, nga të gjitha gjërat foshnjake dhe vogëlsitë e pakënaqësisë, e topitjes, e humorit të keq: cilat rrugë çojnë te ky destinacion? Dhe cilat prej tyre janë më të sigurtat?... Të gjitha emocionet e mëdha, e kanë në fund këtë fuqi, gjithë nëse shpërthejnë papritur - zemërimi, frika, kënaqësia, hakmarrja, shpresa, triumfi, dëshpërimi, mizoria; dhe në të vërtetë prifti asket ka marrë pa tjetër në shërbimet e tij tërë lukuninë e qenve t'egjër që janë brenda njeriut duke ndërsyer herë këtë, herë atë, gjithmonë me të njëjtin qëllim për ta shkundur njeriun nga trishtimi i tij, për t'i dhënë arratinë, dhimbjes së tij shurdhane, mjerimit të tij ngurrues, dhe gjithmonë, dosido, edhe me një interpretim dhe një "justifikim" religjioz. Dhe mandej çdo aberrim ndjenje, i këtij lloji, merr shpagë mandej, kjo dihet - e bën të sëmurin më të sëmurë - dhe prandaj ky lloj dermani ndaj dhimbjes, i matur me një kriter modern, është një lloj "fajtor".

Diktati i barazisë, kërkon megjithatë që të emfatizojmë faktin se ky derman është aplikuar me *ndërgjegje të qetë*, që prifti asketik e ka dhënë këtë ilaç me besim shumë të thellë në dobinë e tij, madje në domosdoshmërinë e tij – dhe shumë shpesh ka përfunduar gati në kolaps para dhimbjes që ka krijuar vetë; si dhe që revanshet e dhunshme fiziologjike të këtyre aberrimeve, mbase deri edhe çekuilibrimet e shpirtit, në fund nuk e kundërtho- në të gjithë sensin e kësaj lloj terapie: ngaqë kjo, siç e kemi treguar ndërkaq më sipër, *nuk synonte* të shëronte sëmundjet, por të luftonte hidhërimin e depresionit, ta lehtësonte, ta mpinte. Edhe *kështu* qëllimi është arritur. Nota bazë që prifti asketik i ka lejuar vetes, për të luajtur çdo lloj muzike agonistike dhe ekstatike mbi kor- dat e shpirtit njerëzor, është përmbushur – siç e dinë të gjithë – me përdorimin e *ndjenjës së fajit*. Në esenë e mëparshme e kam treguar ndërkaq gjenezën e kësaj ndjenje – si pjesë e psikologjisë kafshërore dhe asgjë më shumë: aty viheshim përballë ndjenjës së fajit, si- methënë, të gjallë. Vetëm në duart e priftit, artist i vër- tetë i ndjenjës së fajit, ajo ka marrë formë – dhe çfarë forme! “Mëkati” – sepse ky është emri i variantit të ri priftëror të “ndërgjegjes së keqe” kafshërore (i mizorisë së kthyer kah vetja) – ka qenë ngjarja më e madhe, deri më sot, në historinë e shpirtit të sëmurë: tek ai kemi kryeveprën më të rrezikshme dhe fatale të interpretimit religjioz. Imagjinoheni njeriun, që në një mënyrë apo një tjetër vuan vetiu, por në shkallë fiziologjike, gati si një kafshë e mbyllur në kafaz, pa e ditur përse, me çfarë qëllimi, i dëshiruar për arsye – arsyet janë një çlirim – i dëshiruar edhe për medikamente dhe për narkotikë, që

në fund këshillohet me atë që di dhe di madje edhe atë çka është e fshehur – dhe ja! fiton përmendjen, fiton nga magjistari i tij, prifti asket, përmendjen e *parë* të “shkakut” të vuajtjes së tij: duhet ta kërkojë në *vetvete*, në një *faj*, në një copë të shkuare, duhet ta kuptojë vetë vuajtjen e tij si një *gjendje ndëshkimi*... Fatkeqi ka dëgjuar, ka kuptuar: tani është si pula, përreth të cilës është shënuar një vizë. Nga ky rreth vizash nuk arrin të dalë më: i sëmuri është bërë “mëkatari”... Dhe tash, për nja dy shekuj, nuk do të çlirohemi nga ky i sëmurë i ri, nga “mëkatari” – po a do të çlirohemi ndonjëherë? – kudo që ta hedhësh shikimin, do të jetë gjithmonë shikimi hipnotik i mëkatarit, që shkon gjithmonë në një drejtim të vetëm (në drejtimin e “fajit”, si shkak i *vetëm* i vuajtjes): gjithmonë ndërgjegjja e keqe, kjo “shtazë e krupshme”, thënë me gjuhën e Luterit; gjithmonë e shkuara e ripërtypur, veprimi i shtrembëruar, “syri i vrerosur” për çdo veprim; gjithkund *vullneti* për të keqkuptuar dhimbjen, keqvlërësimi i saj në ndjenjat e fajit, frikës prej ndëshkimit; gjithkund kamxhiku, këmisha e forcës, trupi i drobitur nga agjërimi, ndërkryerja; gjithkund mëkatari që e fut veten në rrotën e mekanizmit mizor të një ndërgjegjeje të shqetë, e prirë nga epshi i sëmurë; gjithkund dhimbja memece, frika e skajshme, agonia e zemrës së martirizuar, spazmat e një lumturie të panjohur, thirrja për “shëlbim”. Në të vërtetë, falë kësaj mënyre të vepruari, depresioni i lashtë, rëndimi dhe lodhja janë *kapërcyer* rrënjësisht, jeta është bërë sërish *shumë* interesante: vigjilente, përjetësisht vigjilente, e pagjumë, e zjarrtë, e karbonizuar, e zhbërë, e prapë jo e lodhur – kështu i dukej njeriut, “mëkatarit”, që është

nismuar me këto mistere. Ky kryemagjistar i vjetër i luftës kundër pakënaqësisë, prifti asketik – kishte fituar qartazi, mbretëria e tij kishte ardhur: njerëzit sakaq nuk ankoheshin më kundër dhimbjes, lëngonin nga etja për dhimbje; “më shumë dhimbje, më shumë dhimbje!” - kjo qe britma, për shekuj e shekuj, e dëshirës së dishepujve dhe të nismuarve të tij. Çdo aberrim ndjenje që ishte i dhimbshëm, gjithçka që bënte copë e grimë, rrëzonte, grinte, rrëmbente dhe çonte në ekstazë, fshehtësia e vendeve të torturës, zgjuarsia e vetë ferrit – gjithçka qe zbuluar tashmë, pikasur, shfrytëzuar, gjithçka ishte në shërbim të magjistarit, gjithçka, nga ai çast, i shërbente fitores së idealit të tij, idealit asketik... “Mbretëria ime nuk është e kësaj bote”³³ – vazhdonte të thoshte si në fillim ashtu dhe tani: – por a e kishte ende të drejtën të fliste kështu?... Gëtja ka thënë se ekzistojnë vetëm tri-dhjetë e gjashtë situata tragjike:³⁴ Nga kjo merret vesh, nëse nuk e dini sakaq, se Gëtja nuk qe një prift asket. Prifti – njeh më tepër...

21.

Për sa i përket të gjithë kësaj lloj terapie priftërore, llojit “fajtor”, çdo fjalë kritike është sipërfaqësore. Po fakti që prifti asket e ka zakon t’ua rekomandojë, si në këtë rast, këtë aberrim ndjenje të sëmurëve të tij (me emrat më të shenjtë, dihet, dhe në të njëjtën kohë i pushtuar nga shenjtëria e qëllimit të tij), a i ka sjellë realisht *dobi* ndonjë të sëmuri, a do të kishte vallë dëshirë të mëtonte një pohim të tillë? Të paktën duhet të merreshim vesh mbi fjalën “dobi”. Nëse mtesa është që me atë të pohohet

se një sistem i tillë trajtimi e ka *përmirësuar* njeriun, nuk kam asgjë kundër; vetëm shtoj se për mua “i përmirësuar” ka të njëjtin kuptim si “i zbutur”, “i dobësuar”, “i dekurajuar”, “i rafinuar”, “i qullosur”, “i tredhur” (pra gati e njëjta gjë si “i dëmtuar” ...). Por kur ke të bësh kryesisht me krijesa të sëmura, të pakënaqura, të depressionuara, një sistem i tillë e bën, në çdo rast, të sëmurin edhe *më të sëmurë*, edhe në qoftë se e bën “më të mirë”; mjafton të pyesësh psikiatrët se cilat janë pasojat e aplikimit metodik të torturave shëlbyese, të detyrimeve dhe konvulsioneve shpëtuese. Mjafton të pyesësh edhe historinë: sa herë që prifti asket ua ka aplikuar këtë trajtim të sëmurëve, sëmundja vetëm sa ka fituar terren, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, në gjerësi dhe në thellësi. Dhe “rezultati” cili ka qenë? Një sistem nervor i shkatërruar, përpos sëmundjes ekzistuese; dhe kjo te më i madhi sikurse te më i vogli, tek individët sikurse te masat. Pas *training*-ut të pendesës e të shpëtimit të shpirtit gjejmë epidemi shumë të mëdha epileptike, më të mëdhatë që njeh historia, si ato të balerinëve të Shën Vitos dhe të Shën Gjonit në Mesjetë; si fazë tjetër e pasojave të saj gjejmë paralizat e tmerrshme dhe depressionet kronike, me të cilat, në disa raste, përmbysset temperamentit i një populli ose i një qyteti (Gjenevë, Bazel) njëherë e përgjithmonë, në të kundërtën e vet – dhe këtu duhet konsideruar edhe histerizmi i shtrigave, diçka e ngjashme me somnambulizmin (tetë shpërthime të mëdha epidemike vetëm mes 1564-ës dhe 1605-ës) – gjejmë mes pasojave ato delire vetëvrasëse kolek-

* It.: rroftë vdekja.

tive, britma e tmerrshme e të cilëve "*evviva la morte!*"* u dëgjua në tërë Evropën, e ndërprerë nga idiosinkrazi herë epsharake herë të furishme shkatërruese: veç kësaj, po ai gërshetim afektesh, me po ato ndërhyrje dhe po ato kërcime, vihet re edhe sot kudo, në çdo rast atje ku doktrina asketike e mëkateve arrin për të disatën herë sukses të madh. (Neuroza fetare *duket si formë e "shfaqjes së djallit"*: nuk ka asnjë dyshim. Çfarë është? *Quaeritur.****) Përgjithësisht, ideali asketik dhe kulti i tij sublim-moral, ky sistemim shumë gjenial si dhe shumë i shpenguar e shumë i rrezikshëm i çdo metode të aberrimit të ndjenjës, nën mbrojtjen e qëllimeve të shenjta, është i shkruar me germa të mëdha në mënyrë të tmerrshme dhe të paharrueshme në tërë historinë e njeriut, dhe për fat të keq, *jo vetëm* në historinë e tij... Nuk do të dija ç'gjë tjetër të tregoja që e ka sulmuar *shëndetin* dhe efikasitetin e racës së evropianëve me kaq shumë destruktivitet si ka bërë ky ideal; pa e tepruar minimalisht ai mund të jetë *fataliteti i vërtetë* në historinë shëndetësore të evropianit. E shumta, mund të bëni një krahasim posaçërisht me ndikimin gjerman: dua të them për helmimin e Evropës nga alkooli, çka deri më sot është mbajtur në një hap me epërsinë politike dhe raciale të gjermanëve (- atje ku ata shtien gjakun e tyre, shtien edhe vesin e tyre). - I treti në rend përparësie është për t'u shënuar sifilizi - *magno sed proxima intervallo.****

** Lat.: ankohet

*** Lat.: që vjen fill më pas në radhë, por pas një intervali të madh.

22.

Prifti asketik ka korrumpuar shëndetin e shpirtit, kudo që ka ardhur në pushtet, e për pasojë ka korrumpuar edhe shijen *in artibus et litteris** – dhe akoma e korrupton – “Për pasojë?” – Shpresoj që të mos hasen vështirësi për të ma lejuar këtë “për pasojë”; të paktën nuk do ta tregoj këtu. Një përmendje e vetme: i referohet librit themelor të literaturës së krishterë, modelit të saj të njëmendtë, “librit në vetvete”. Akoma në mesin e ma-dhështisë greko-romake, që ishte edhe një madhështi librash, në pranë të një bote të lashtë shkrimesh që nuk kishin rënë akoma në dekadencë e rrënim, në një kohë kur mund të lexoheshin akoma disa libra për zotërimin e të cilave sot do të jepeshin në shkëmbim gjysma letërsish, plebeizmi dhe mendjemadhësia e agitatorëve të krishterë – i quajnë Etërit e Kishës – guxonte sakaq të dekretonte: “Edhe *ne* kemi letërsinë klasike, nuk kemi nevojë për atë të Grekëve” – duke bërë me shenjë krenarisht drejt librave të tyre me legjenda, letrave të apostujve dhe traktateve të tyre të vogla apologjetike, pak a shumë në të njëjtën mënyrë si lufton sot “ushtria e shpëtimit” angleze, me një letërsi të ngjashme, kundër Shekspirit dhe “paganëve” të tjerë. Siç mund ta kuptoni fare lehtë, unë nuk e dua *Dhjatën e Re*; gati më turbullon fakti se jam kështu vetëm me shijen time përballë kësaj vepra letrare shumë të çmuar dhe tepër të vlerësuar (shija e dy mijëvjeçarëve është kundër meje): por ç’rëndësi ka!

* Lat. : në artet dhe letrat.

“Ja ku jam, nuk mund të bëj ndryshe”, – kam guxim për shijen time të keqe. *Dhjata e Vjetër* – po, është një gjë krejt tjetër: *Dhjata e Vjetër* meriton çdo respekt! Aty gjej burra të mëdhenj, një peizazh heroik dhe, gjë shumë e rrallë mbi tokë, naivitetin e pakrahasueshëm të një zemre të fortë; dhe për më tepër, gjej një popull. Tek e *Reja*, përkundrazi, kurr gjë përpos manovrash të vogla sektesh, kurr gjë përpos rokokoshë të shpirtit, kurr gjë tjetër përpos pikëvështrimesh fluturake, marrakotjesh, thjesht atmosferë kuvendi, pa harruar një duhmë – nganjëherë – me ëmbëlsi buklike, tipike e epokës (*si edhe* e provincës romake) dhe që nuk është aq hebraike sa është helenistike. Përvujtëria dhe mendjemadhësia në çdo faqe; një vërshim i ndjenjës që gati të budallalleps; histeri pasionale por pa pasion; pantomimë e dhimbshme; është e qartë që këtu mungon çdo edukim i mirë. Si është e mundur të bësh kaq shumë zhurmë mbi veset e vogla vetjake, siç bëjnë këta burrecë të përsheptshëm! Asnjëri nuk merakoset për këtë; as Zoti. Gjithë këta njerëz të vegjël province, në fund, duan edhe “kuroren e jetës së përjetshme”: por me çfarë qëllimi? Për çfarë? – Nuk mund të jesh më fyes se kaq. Një Pjetër “të pavdekshëm”: kush do ta duronte? Kanë një ambicie që të bën për të qeshur; këta ripërtypin faktet e tyre më intime, budallallëqet, trishtimet dhe merakët e tyre të ngeshme, a thua sikur vetë universi ta kishte për detyrë të vetë-bezdisëj; po si nuk lodhen së përfshiri vetë Zotin në fatkeqësitë më të vogla që i godasin. Dhe kjo kokë-më-kokë e përjetshme me Zotin, sa pa shije! Kjo bezdisje fizikisht e pacipë e Zotit, hebraike dhe aspak hebraike!... Në Azinë Lindore ekzistojnë “popullsi pagane” të vogla

e të përçmuara, nga të cilat këta të krishterët e parë do kishin mundur me mësue diçka thelbësore, pak *takt* në adhurim; këto kombe nuk ia lejojnë vetes, siç dëshmojnë misionarët e krishterë, të shqiptohet as emri i zotit të tyre. Kjo më duket delikate mjaftueshëm; sigurisht që është tepër delikate jo vetëm për të krishterët “e parë”: për ta kuptuar kontrastin, mund të kujtojmë Luterin, më “shprehiplotin” dhe më mendjemadhin fshatar që ka pasur Gjermania, por edhe tonin luteran tek i cili ky ndihej shumë i përfaqësuar gjatë kokë-më-kokës së tij me Zotin. Kundërvënia e Luterit ndaj shenjtorëve mesjetarë të Kishës (dhe në mënyrë të veçantë ndaj “papës, *kurvës së drejt*”) që në fund të fundit, pa hije dyshimi, kundërvënia e një bujku të bezdisur nga etiketa e mirë e Kishës, ajo etiketë përkushtimore e shijes hieratike, që pranon si *Sancta Sanctorum*** vetëm më të konsakruarit dhe më të rezervuarit kurse bujqit i lë jashtë. Pikërisht në këtë vend dhe njëherë e përgjithmonë, ata nuk duhet të flasin – por Luteri, fshatari, e mendonte ndryshe, kjo nuk i dukej *gjermane* mjaftueshëm; donte para së gjithash të fliste drejtpërsëdrejti, të fliste në vetë të parë, “pa ceremoni” me Zotin e tij... Dhe kështu bëri. – Ideali asketik, mund ta keni marrë vesh, kurrë dhe në asnjë vend nuk ka qenë një shkollë e shijes së mirë, e aq më pak e mirësjelljes – në rastin më të mirë ka qenë një shkollë për mënyrat e sjelljes priftërore: në fakt përmban në vetvete diçka armiqësore për vdekje ndaj të gjitha rregullave të mirësjelljes – mungesë mase, përçmim për masën, është vetë ai një «*non plus ultra*»***.

** Lat.: shenjtë të shenjtëve.

*** Lat.: që s'ka më tej.

23.

Ideali asketik ka prishur jo vetëm shëndetin dhe shijen, por ka korrumpuar edhe një gjë të tretë, një të katërt, një të pestë, një gjë të gjashtë – do të ruhem mirë nga të thënët *sa* (nuk do arrija kurrë në fund!). Këtu nuk do të nxjerr në dritë atë që *ka prodhuar* ky ideal; por më tepër vetëm *domethënien* e tij, atë çka lë të kuptohet, atë çka është e fshehur pas tij, nën të, tek ai, shprehja provizore, konfuzë, e tejmbushur me pyetje dhe me keqkuptime e së cilës është ai. Dhe vetëm në lidhje me *këtë* qëllim nuk kam mundur t' u kursej lexuesve të mi një shikim mbi pamatësinë e rezultateve të tij, edhe të rezultateve të tij fatale: për ta përgatitur, pra, me aspektin më të mbramë dhe të tmerrshëm që ka, për mua, problemi i domethënies së atij ideali. Çfarë do të thotë, në fakt, *fuqia* e këtij ideali, *pamatësia* e fuqisë së tij? Për ç'arsye i është dhënë kaq shumë hapësirë? Përse nuk i është kundërvënë rezistenca më e mirë? Ideali asketik shpreh një vullnet: *ku* gjendet vullneti *i kundërt*, ku shprehet *ky ideal i kundërt*? Ideali asketik ka një *qëllim* – ky është mjaft i përbotshëm sa që i bën të gjitha interesat e tjerë të ekzistencës njerëzore, të duken në krahasim me të, meskinë dhe të kufizuar; i finalizuar për këtë qëllim të vetin, ai interpreton në mënyrë të pamëshirshme epokën, njerëz e popuj, nuk toleron asnjë interpretim tjetër, asnjë qëllim tjetër, hedh poshtë, mohon, miraton, konfirmon vetëm në kuptimin e interpretimit *të tij* (– dhe a ka pasur gjëkund një sistem interpretativ të menduar në mënyrë më të plotë?); ai nuk i nënshtrohet asnjë fuqie, madje beson në supremacinë e tij mbi çdo pushtet,

mbi përparësinë e tij absolute ndaj çdo pushteti - beson se mbi tokë nuk ekziston asnjë fuqi që s' duhet të marrë në mënyrë ekskluzive një domethënie nga ana e tij, një të drejtë ekzistence, një vlerë, si instrument i veprës së tij, si udhë dhe mjet drejt synimit të tij, drejt një qëllimi unikal... Ku është e kundërta e këtij sistemi të mbyllur vullneti, synimi dhe interpretimi? Përse mungon e kundërta?... Ku është "qëllimi unik" tjetër?... Më thonë, amà, se ai nuk mungon, që jo vetëm ka bërë një luftë të gjatë dhe fitimtare kundër atij ideali, por që sakaq e ka mposhtur atë ideal në të gjitha gjërat më të rëndësishme: e gjithë shkencë jonë moderne qenka dëshmia e kësaj - kjo shkencë moderne që, si një filozofi tipike e realitetit, beson, në mënyrë të dukshme, vetëm tek vetvetja, zotëron, në mënyrë të dukshme, guximin e vetvetes, vullnetin e vetvetes dhe deri më sot ka arritur t'ia dalë mjaft mirë pa Zotin, përtejsinë dhe virtytet mohuese.

Ndërkohë një rrumpallë e tillë dhe kaq shumë llafe agitatorësh nuk më lëvizin as qimen: këta trumbetues të realitetit janë muzikantë të këqij, ndihet mjaft qartazi se zërat e tyre nuk vinë nga aq thellë sa duhet, me gojën e tyre nuk flet honi i ndërgjegjes shkencore - pasiqë sot ndërgjegjja shkencore është një hon -, fjala "shkencë" në gojë të tilla trumbetuesish nuk është asgjë tjetër pos një prostitucion, një abuzim, një pacipësi. Pikërisht e kundërta e asaj që pohohet këtu, është e vërtetë: shkencë sot nuk ka asnjë besim në vetvete, për të mos folur për një ideal mbi veten - dhe aty ku ajo akoma arrin të jetë pasion, dashuri, zjarr, dhimbje, nuk është sigurisht ideali i kundërt i atij ideali asketik, por më tepër

forma e tij *përfundimtare* është më *aristokrate*. Ju duket e çuditshme?... Edhe mes të diturve të sotëm ekzistojnë shumë njerëz të mirë modestë që punojnë, kënaqen me qoshkun e vet dhe, për faktin se kënaqen, herë pas here rivendikojnë me shumë pak modesti *detyrën* për t'u kënaqur, sot, sidomos te shkenca – pasi pikërisht në këtë fushë do të kishte shumë gjëra të dobishme për të bërë. Nuk kam asnjë vërejtje; më pak se kurrë do të doja ta helmoj gëzimin që kanë këta punëtorë të ndershëm për zanatin e tyre. Por me faktin se tash, në shkencë, punohet rëndshëm dhe se ekzistojnë punëtorë të kënaqur, *nuk* është aspak e vërtetuar që shkenca, si tërësi, ka sot një qëllim, vullnet, ideal, besim të madh të pasionuar. Siç kam thënë, shtrohet çështja e kundërt: aty ku nuk është shpërfaqja më e rishtë e idealit asketik – bëhet fjalë për ato raste të rralla, të kërkuara, të përzgjedhura ku gjykimi i përgjithshëm mund të ndryshohet – sot shkenca është një strofkë për çdo lloj burracakërie, mungese besimi, brejtje ndërgjegjeje, *despectio sui*, ndërgjegjeje të keqe – ajo është *shqetësimi* i vetë mungesës së idealit, dhimbja për mungesën e dashurisë së madhe, pamjaftueshmëria e një modestie të *pavullnetshme*! Zotësia e të diturve tanë, zelli i tyre i pakuptimtë, djegia që i bëjnë qiriut të trurit të tyre nga dy anët, edhe vetë mjeshtëria e tyre artizanale – sa shpesh e gjitha kjo merr kuptimin e një parandalimi që i bëjnë vetes për të parë diçka! Shkenca si mjet i vetë-anestetizimit: *e dinit këtë?*... I lëndojmë ata – kushdo që frekuenton të diturit e di – qoftë edhe vetëm me një fjalë të pafajshme; i bëjmë armiq të diturit tanë në momentin kur besojmë se iu bëjmë nder, i bëjmë të lozin nga fiqiri thjesht ngase

nuk e patëm *finesën* për të gjetur me kë kishim të bënim, në të vërtetë, kishim të bënim, me të *vuajtur*, (që nuk duan t'i rrëfejnë vetes atë çka janë realisht), me njerëz të përçudnuar dhe të pavetëdijsëm që kanë frikë nga një gjë e vetme: *me mbërritë tek ndërgjegjësimi*.

24.

Dhe tani le të shohim anën tjetër, një nga ato rastet e rralla për të cilat ju flisja, idealistët e fundit që ekzistojnë sot mes filozofëve dhe të diturve: a kemi vallë tek ata *kundërshtarët* e kërkuar të idealit asketik, *kundër-idealitet* e tij? Në të vërtetë, ata e *besojnë* veten si të tillë, këta "mosbesues" (pasi kështu janë të gjithë); duket se pikërisht ky është kusuri i tyre i fundmë i besimit, me qenë kundërshtarë të këtij ideali, aq seriozë janë mbi këtë pikë, aq të pasionuara bëhen fjalët e tyre, gjestet e tyre në lidhje me këtë - dhe prandaj u dashka të jetë e vërtetë, ajo që besojnë ata? Ne "njohësit" jemi bërë pak nga pak mosbesues kundrejt çdo lloj besimtari; dyshimi ynë na ka stërvitur pak nga pak të nxjerrim përfundime të kundërta me ato që kanë nxjerrë më parë njerëzit; simethënë, sa herë që forca e një besimi duket shumë në pah, jemi mësuar të nxjerrim si përfundim një dobësi të vërtetueshmërisë - madje *pagjasinë* e asaj që besohet. As ne nuk mohojmë se "besimi të shpëton": *pikërisht për këtë arsye* mohojmë se besimi *provon* diçka - një besim i fortë, që të jep lumturinë, shkakton dyshim mbi objektin e atij besimi, nuk e vendos "të vërtetën" e tij, vendos njëfarë probabiliteti - të *iluzionit*. Çfarë ndodh pra në këtë rast? - Këta mohues dhe vetmitarë

të sotëm, këta fanatikë të një gjëje të vetme, të nevojës, pra, për një pastrim intelektual, këta shpirtra të fortë, të rreptë, të përkorë, heroikë, që janë nderi i epokës sonë, të gjithë këta ateistë të zbehtë, anti-kristianë, imoralistë, nihilistë, këta skeptikë, "efektikë," *veremlinj* të shpirtit (gjë kjo që është e zakonshme, në njëfarë kuptimi, për të gjithë, pa përjashtuar kënd), këta idealistë të fundit të njohjes, të vetmit tek të cilët sot është e gjallë dhe e mishëruar ndërgjegjja intelektuale - dhe mëtojnë, në të vërtetë, se janë sa më larg që është e mundur nga ideali asketik, këta "shpirtra të lirë, shumë të lirë": e prapë do të më duhet t'u zbuloj atyre, atë që as vetë nuk mund ta shohin - ngaqë janë tepër afër - ky ideal është në të vërtetë edhe ideali i tyre, ata e përfaqësojnë sot atë dhe mbase askush tjetër, ata vetë janë produkti i tij më i spiritualizuar, suaza e tij më e përparuar e luftëtarëve dhe eksploratorëve, forma e tij më kanosëse e joshjes, më shpirtbutë, më pak e kapshme - nëse në njëfarë mënyre jam një zgjidhës enigmash, dua të jem me këtë pohim!... Ata janë akoma fort larg nga të qenit shpirtra të lirë: ngaqë ata i besojnë akoma të vërtetës... Kur kryqtarët e krishterë n'Orient u përplasën me urdhrin e pamposhtur të Hashishinëve, atë urdhër shpirttrash të lirë *par excellence*, gradat më të ulëta të të cilëve jetonin në një bindje të paarritur ndonjëherë nga asnjë urdhër oshënar, ata morën disi edhe udhëzime mbi atë simbol dhe atë besëlidhje sakramentale, që u rezervojë vetëm gradave më të larta, si *secretum* i tyre: "Asgjë nuk është e vërtetë, gjithçka lejohet" ... E pra, kjo ishte *liria* e shpirtit, me atë edhe besimi tek e vërteta *likuidohej*... Një shpirt i lirë evropian, i krishterë, a është *humbur* ndonjëherë në

këtë pohim dhe në *pasojat* e tij *labirintike*? A e njeh vallë nga *përvoja* minotaurin e kësaj shpelle?... E dyshoj dhe, për më tepër, e di se gjërat janë ndryshe. Asgjë nuk është saktësisht më e huaj për këta monofanatikë, për këta të *ashuquajtur* “shpirtra të lirë”, se liria dhe çlirimi në atë kuptim; në asgjë tjetër nuk janë të lidhur më ngushtë, fanatizmi i tyre absolut në besimin tek e vërteta nuk ka të krahasuar. Të gjithë këtë mbase e njoh nga shumë afër: atë përkohësinë e përndërueshme filozofike, tek e cila të çon një besim i tillë, atë stoicizëm të intelektit, që përfundon duke i ndaluar vetes jo-në po aq rreptësisht sa edhe po-në, atë *dëshirën* për të qëndruar të ndalur përpara efektikes, para *factum brutum*,* atë fatalizëm të “*petits faits*”** (*ce petit fataliste*,*** e përkufizoj unë), ku shkencë franceze kërkon sot njëfarë primati moral mbi atë gjermane, atë dëshirën për të hequr dorë nga çdo interpretim (për të përdhunuar, doktoruar, shkurtuar, nëpërkëmbur, mbushur, shpikur, falsifikuar dhe për të bërë gjithçka që është pikërisht *thelbi* i çdo interpretimi) – e gjitha kjo, e parë gjerësisht, shpreh aq asketizëm të virtytit, sa shpreh çfarëdo mohimi i sensualitetit (në fund, është vetëm një *modus* i këtij mohimi). Ajo çka e çon atë pastaj tek ai vullnet absolut për të vërtetën, është *besimi tek vetë ideali asketik*, edhe pse si shpirt i imperativit të tij të pandërgjegjshëm – të mos vetëmashtrohemi në lidhje me këtë – është besimi në një vlerë *metafizike*, në një vlerë *në vetvete të së vërtetës*, sikundër vetëm ai ideal garanton dhe bën të vlefshme (mbahet në këm-

* Lat.: fakti bruto.

** Fr.: faktet e vogla.

*** Fr.: ky fatalist i vogël.

bë dhe rrëzohet bashkë me atë ideal). Nuk ekziston, po të gjykojmë rigorozisht, asnjë shkencë pa "hipotezat" e saj, mendimi i një shkence të tillë është i pakonceptueshëm, paralogjik: një filozofi, një "besim", duhet të paraekzistojë gjithmonë, që ta aftësojë shkencën të nxjerrë prej saj një drejtim, një kuptim, një cak dhe një metodë, një *të drejtë* ekzistence. (Kush e mendon ndryshe, kush për shembull, merr përsipër ta konsiderojë filozofinë "mbi baza mirëfilli shkencore", duhet më parë, me këtë qëllim, të *ktthejë përmbys* jo vetëm filozofinë, por edhe vetë të vërtetën: fyerja më e madhe e erzit që mund të ekzistojë në lidhje me dy vashëza kaq të denja!) Po, nuk ka dyshim - dhe këtu ia lë fjalën *Shkencës gazmore* cit. libri i pestë - : "Njeriu i vërtetë, në atë domethënie të guximshme dhe ekstreme që është parakushti i besimit të shkencës, *pohon në këtë mënyrë një botë të ndryshme* nga ajo e jetës, e natyrës dhe e historisë; dhe përderisa *pohon këtë "botë të ndryshme"*, si? nuk u dashka ta mohojë antitezën e saj këtë botë, botën *tonë*?... Sidoqoftë është *besim metafizik* ai mbi të cilën bazohet besimi ynë tek shkencën - edhe ne, subjektet e sotme të njohjes, ne ateistët dhe antimetafizikët, edhe ne e marrin akoma zjarrin *tonë* nga ajo flakë që e ka ndezur një besim mijëravjeçar, ai besim i krishterë që ishte përndryshe besimi i Platonit, për të cilin Zoti është e vërteta dhe e vërteta është *hyjnore*... Por si mund të ndodhë kjo, nëse pikërisht ky besim vjen duke u bërë gjithmonë e më i pabesueshëm, kur asgjë më nuk shpërfaqet si hyjnore në mos gabimi, verbëria, gënjeshtria - kur vetë Zoti shpërfaqet si *gënjeshtria jonë më e gjatë*"... Në këtë pikë është e domosdoshme të ndalemi e ta mendojmë

situatën më gjatë. Vetë shkencë *ka nevojë* tashmë për një justifikim (çka nuk do të thotë aspak se ekziston një i tillë për të). Në këtë kontekst mjafton t'u drejtohem filozofëve më të hershëm dhe atyre më modernë: tek të gjithë mungon një vetëdije se sa nevojë ka për një justifikim vetë vullneti për të vërtetën, dhe ky është një boshllëk në çdo filozofi - po kjo përse ndodh? Sepse ideali asketik deri më sot i ka *dominuar* të gjitha filozofitë, sepse e vërteta është vendosur si qenie, si Zot, si gjykata më e lartë e apelit; sepse të vërtetës nuk i është *lejuar* kurrë të jetë një problem. Kjo "lejuar", a kuptohet? - Qysh nga momenti kur mohohet besimi te Zoti i idealit asketik, shtrohet *një problem i ri*: ai i vlerës së të vërtetës. - Vullneti për të vërtetën ka nevojë për një kritikë - me këtë përkufizojmë vetë detyrën tonë -, vlera e së vërtetës *dihet të vihet njëherë në diskutim* në rrugë eksperimentale. (Kush mëton se qeshë tepër konciz, mund të rilevojë pasazhin e *Shkencës gazmore* me titull: "Në ç' masë edhe ne jemi ende të devetë", ose më mirë akoma të gjithë librin e pestë të kësaj vepre, sikundër edhe parathënien e librit *Agu i mëngjesit*).

25.

Jo! Mos m'u vardisni me shkencë teksa po kërkoj antagonistin natyral të idealit asketik, teksa pyes: "Ku është vullneti i kundërt, ku shprehet *ideali i kundërt* i tij?". Në lidhje me këtë, shkencë është shumë larg nga të qenit e pavarur mjaftueshëm; në çdo aspekt shkencë ka nevojë më parë për një ideal vlere, për një fuqi prodhuese vlerash, në *shërbimin* e të cilës *të mund të besojë* tek vetja - ajo

vetë nuk prodhon kurrë vlera. Raporti i saj me idealin asketik në vetvete nuk është aspak antagonist; përkundrazi, ajo madje përfaqëson akoma thelbësisht forcën impulsive, në procesin e brendshëm të zhvillimit të atij ideali. Kundërvënia dhe lufta e saj nuk i referohen, nëse konsiderohen më vëmendshëm, idealit vetë, por vetëm veprave të tij të jashtme, shfytyrimeve të tij, lojës së tij me maska, ashpërsimit të tij kalimtar, ngurtësimin, dogmatizimit të tij – kthehet të çlirojë jetën, duke mohuar elementet sipërfaqësore tek ai. Të dyja këto dukuri, shkencë dhe ideal asketik së bashku, kanë në fakt të njëjtën bazë – e kam qartësuar sakaq – pra, mbi të njëjtin mbivlerësim të së vërtetës (më saktë: mbi vetë besimin tek *pamundësia* për të vlerësuar dhe kritikuar të vërtetën), dhe pikërisht për këtë ato janë *domosdoshmërisht* aleate – kështu që, gjithë nëse sulmohen, duhet të sulmohen dhe duhet të vihen në diskutim së toku. Një zhvlerësim i idealit asketik mbart pashmangshëm me vete edhe një zhvlerësim të shkencës: prandaj duhen hapur sytë në kohë dhe duhen mprehur veshët! (*Arti*, po flas provizorisht, pasi do të kthehem në një moment tjetër dhe më gjatë mbi këtë temë, – arti, ku pikërisht *gënjeshtra* shenjtërohet dhe *vullneti për iluzion* e ka nga ana e vet ndërgjegjen e mirë, i kundërvihet shumë më rrënjësisht se shkenca idealit asketik: këtë e pat kuptuar instinkti i Platonit, armikut më të madh të artit që ka pasur deri më sot Evropa. Platoni *kundër* Homerit: ky është i tëri antagonizmi i vërtetë – nga njëra anë, ai që i “qëndron përtejse” me dëshirë, shpifësi i madh kundër jetës, nga ana tjetër, hyjnizuesi i saj i pavullnetshëm, natyra e *artë*. Vënia e artit në shërbim të idealit

asketik është, për këtë arsye, *korruptivimi* më autentik që mund të ekzistojë dhe, për fat të keq, një nga më të zakonshmit: sepse asgjë nuk është më e korruptueshme se artisti.) Edhe nga pikëvështrimi fiziologjik, shkenca ka të njëjtën bazë me idealin asketik: njëfarë *varfërimi i jetës* është premisa si për njërën, ashtu dhe për tjetrën – emocionet e ngrira, tempo-ritmi i ngadalësuar, dialektika në vend të instinktit, *sertësia* e stampuar mbi fytyrat dhe gjestet (sertësia, kjo simptomë e pakëqkuptueshme e një metabolizmi të lodhur, e një jete që lufton dhe rraskapitet). Le të konsiderojmë periudhat e një populli ku i dituri na shfaqet në plan të parë: janë epoka lodhjeje, shpesh mugullimi, dekadence – forca gurgulluese, besimi tek jeta, besimi tek *e ardhmja* janë zhdukur. Epërsia e mandarinëve nuk nënkupton kurrë asgjë të mirë: aspak ndryshe nga ardhja e demokracisë, e arbitrimit të paqes në vend të luftës, e barazisë së të drejtave për gratë, e fesë së mëshirës dhe të çfarëdo simptome tjetër të jetës që rrënohet. (Shkenca e pame si problem: çfarë do të thotë shkencë? Në lidhje me këtë shih parathënien e *Lindja e tragjedisë*). – Jo! kjo “shkencë moderne” – hapini mirë sytë! – është tash për tash aleatja *më e mirë* e idealit asketik, dhe kjo pikërisht për faktin se është më e pavetëdijshmja, më pak e vullnetshmja, më e fshehta dhe më e nëndheshmja! Deri më sot kanë luajtur të njëjtën lojë, “të varfrit në shpirt” dhe kundërshtarët shkencorë të atij ideali (të ruhemi mirë, kjo e thënë kalimthi, nga të menduarit se këta janë e kundërta e atyre, diçka si të *pasurit* në shpirt – *nuk* janë *aspak*, unë i kam quajtur veremlinjtë në shpirt). Fitoret e famshme të këtyre të fundit: janë fitore, nuk ka dy-

shim – por mbi çfarë? Tek ata ideali asketik nuk është mposhtur fare, madje është bërë më i fortë, pra më i pakapshëm, më spiritual, më i rrezikshëm, sepse shkenca ka shkatërruar gjithmonë e më shumë pa mëshirë, ka shkatërruar një mur, një kundërfortesë që i qe vënë në shpinë dhe që ia bënte më të pagdhundur pamjen. Me të vërtetë mendoni se mposhtja e astronomisë teologjike do të thotë mposhtje e atij ideali?... A është bërë vallë njeriu më pak nevojtar për një zgjidhje të përtej-jetshme të enigmës së tij ekzistenciale, sepse kjo ekzistencë, qysh prej atëherë, paraqitet më e rëndomtë, më e padobishme, më sipërfaqësore në rendin e dukshëm të universit? Nga Koperniku e këndeje vetëzvogëlimi i njeriut, *vullneti* i tij për t’u vetëzvogëluar, a nuk përparon vallë në mënyrë të pandalshme? Për fat të keq, besimi i tij në dinjitetin, unicitetin, pazëvendësueshmërinë e tij në skemën hierarkike të qenieve, është zhdukur – ai është bërë *kafshëror*, tekstual, i pacilësueshëm dhe një kafshë e pazbutur, ai që në besimin e tij të dikurshëm ishte gati Zoti (“i biri i Zotit”, “Njeriu-Zot”)... Nga Koperniku e këndeje, njeriu duket sikur ka përfunduar mbi një sipërfaqe të përthyer – tashti rrokulliset gjithnjë e më shpejt larg nga pika qendrore – ku? në hiç? drejt “ndjenjës gërryese të hiçit të vet”?... Dale! kjo do të ishte rruga e drejtë - drejt idealit të *lashtë*?... Çdo shkencë (dhe aspak vetëm astronomia mbi efektet demoralizuese dhe degjeneruese të së cilës Kanti ka bërë atë rrëfimin për t’u mbajtur mend se “ajo e asgjëson rëndësinë time”), çdo shkencë sot, si ajo natyrore, si ajo *jo natyrore*, – kështu e përkufizoj autokritikën e njohjes – priret të heqë tek njeriu sensin e respektit që ka pasur deri më sot për

veten, thua se nuk ishte tjetër përpos një mendjemadhësi e çuditshme; gati mund të thuhet se ajo e bazon krenarinë e vet, formën e saj të vrazhdë të ataraksisë stoike në mbajtjen pranë vetes të këtij vetë-përçmimi të njeriut të fituar me mund, si pohimi i saj i mbramë dhe më serioz i vetë-vlerësimit (dhe me të drejtë, në fakt: pasi ai që përçmon, sidoqoftë është dikush që “nuk e ka harruar çmuarjen” ...). Por a përfshin e gjithë kjo ndonjë përpjekje reale kundër idealit asketik? A besohet akoma realisht dhe seriozisht (siç kanë imagjinuar, për njëfarë periudhe kohe, teologët), që *fitorja* e Kantit mbi dogmatizmin teologjik (“Zot”, “liri”, “shpirt”, “pavdekësi”) e ka dëmtuar njëfarësoj atë ideal? – dhe këtu tashti nuk duhet të na interesojë nëse Kanti vetë ka pasur diçka të tillë qoftë edhe në qëllimet e tij. Fakti është se duke u nisur nga Kanti çdo lloj transhendentalisti ka luajtur për të fituar – janë emancipuar nga teologët: çfarë fati! – ai u ka treguar atyre atë arterien e fshehtë falë të cilës mund të ndjekin në mënyrë autonome dhe me dinjitetin më të madh “dëshirat e zemrës së tyre”. Kësodore, kush do të mund t’i qortonte vallë agnosticistët nëse këta, si adhurues të së panjohurës dhe të së mistershmes në vetvete, adhurojnë tani *vetë pikëpyetjen e tyre* si të ishte Zoti? (Ksavier Dodani flet për *ravages** që iu ka shkaktuar “l’habitude d’admirer l’inintelligible au lieu de rester tout simplement dans l’inconnu”^{**}; mëton se të lashtët do kishin bërë pa të). Duke supozuar se gjithçka që “njeh” njeriu nuk i kënaq dëshirat e tij,

* Fr.: rrënim.

** Fr.: zakoni për të admiruar të pakonceptueshmen në vend që të rrinë fare thjesht në padije.

por që përkundrazi i kundërshton dhe i terrorizon ato, ç'rrugëdalje hyjnore është ta kërkosht fajin jo tek "të dëshiruarit", por tek "të njohurit"!... "Nuk ekziston asnjë njohje: për *pasojë* - ekziston një Zot": çfarë *elegantia syllogismi**** e re! çfarë *triumfi* i idealit asketik! -

26.

Apo mbase e gjithë historiografia moderne ka pasur në përvuljen e saj një qëndrim të mbushur me më shumë besim tek jeta dhe tek idealet? Pretendimi i saj më fisnik tani është ai për të qenë *pasqyrë*; ajo refuzon çdo teleologji; nuk don të "vërtetojë" më asgjë; refuzon me përbuzje rolin e gjykatësit dhe në këtë gjë ka shije të mirë - pohon aq pak sa mohon, konstaton, "përshkruan"... E gjithë kjo është diçka asketike në maksimum; por, në të njëjtën kohë, dhe në një nivel akoma më të lartë, është *nihiliste*, të mos gabojmë te kjo pikë! Shihet një shikim i trishtë, i vrazhdë, por i vendosur - një sy që *zhibirilon larg*, siç bën një udhëtar i vetmuar në Polin e Veriut (mbase për të mos parë brenda? për të mos parë prapa?...). Këtu është borë, këtu jeta është pa gojë; sorrat e fundit që dëgjohen thonë "Për çfarë?", "Më kot!", "Nada!"* - këtu nuk rritet dhe nuk jep më frute asgjë, maksimumi veç metapolitika pjetërburgase ose "mëshira" tolstoiane. Por për sa i përket tipit tjetër të historianëve, një tip mbase edhe më "modern", një tip i dhënë pas qejfit, epsharak, që ia bën me

*** Lat.: Elegancë silogjizmi. Në kuptimin ironik të përdorimit që i bënin sofistët.

* Sp.: asgjë.

sy si jetës ashtu edhe idealit asketik, që përdor fjalën “artist” si një dorashkë dhe sot ka në dorë marrë menaxhimin e lavdërimit të soditjes: oh, çfarë etje madje edhe për asketë dhe për peizazhe dimërore shkaktojnë këta njerëz të ëmbël plot zgjuarsi! Jo! këta njerëz “soditës” djalli t’i marrë! Aq më me ëndje dua të bredh nëpër ato mjegullat më të zymta, të ftohta dhe gri, me ata historianët nihilistë! – madje, gjithë nëse më duhet të zgjedh, nuk duhet të jetë e rëndësishme për mua t’ia vë veshin edhe dikujt që është absolutisht ahistorik, antihistorik (si Dyhringu, që me kumbimin e zërit të tij dalldis në Gjermaninë e sotme një soj “shpirtrash të bukur” akoma të ndrojtur, akoma të parrëfyer, *species anarchistica*** brenda proletariatit të kulturuar). “Soditësit” janë njëqind herë më të këqij – nuk njoh asgjë kaq krupërdjellëse sa një poltronë e tillë “objektive”, një kodosh të historisë, gjysmë prift, gjysmë satir, *parfum* Renan, që qysh me falseton e mprehtë të miratimit të tij zbulon atë që i mungon, *ku* i mungon, *ku*, në këtë rast, Shorti i ka manovruar gërshërët e tij mizore në mënyrë, ajme!, edhe tepër kirurgjike! Kjo më neverit dhe më bën ta humb durimin: ai që nuk ka asgjë për të humbur, le ta ruajë durimin e tij para këtyre pamjeve – këto shpërfaqje më irritojnë, këta “spektatorë”, më shtien të keq kundër “spektaklit”, edhe më shumë se spektakli (vetë historia, kuptohet), dhe papritur më vijnë kapriçio anakreontike. Kjo natyrë, që i ka dhënë demit brirë, luanit οχιτω οδοντων, me çfarë qëllimi ma ka dhënë mua këmbën?... Për të shkëlmuar, për Shën Anakreontin!

** Lat.: lloj anarkist.

dhe jo vetëm për t'u arratisur, për të shkëlmuar poltronat e krimbur, soditësit burrecë, langaraqësinë prej eunuku përpara historisë, flirtuesit me idealin asketik, drejtësinë hipokrite të impotencës! Ideali asketik ka të gjithë respektin tim për sa kohë që *ai është i ndershëm!* Për sa kohë ai i beson vetes dhe nuk shfaqet në farsa! Por nuk më pëlqejnë të gjithë ato çimkat lozonjare, që kanë ambicie të pangishme në nuhatjen e të pafundmes deri sa e pafundmja merr shije çimkash; nuk i duroj varrezat e lyera me të bardhë, që recitojnë jetën; nuk më pëlqejnë të lodhurit dhe "rrjepacakët", që mbështillen në urtësi dhe shohin "objektivisht"; nuk i duroj agjitorët e veshur si heronj, që i fshehin kokat e tyre prej kashte prapa pretekstit të një ideali; nuk i dua artistët ambiciozë, që do të donin të përshfaqnin asketin dhe priftin, dhe në fund nuk janë tjetër përpos bufonë tragjikë; nuk i duroj askëta spekulatorë të mbramë në idealizëm, antisemitët, që sot i shtrembërojnë sytë e tyre me qëndrimin pa-të-keq kristiano-arian dhe përpiqen të eksitojnë të gjithë elementët gjedhë të popullit me abuzimin, në kufirin e durimit, e një mjeti provokues mjaft me leverdi, qëndrimin moralist (- suksesi i padiskutueshëm i turli sharlatanizmi intelektual në Gjermani, varet nga *ndyrësia* tashmë e pamohueshme dhe sakaq e dukshme e shpirtit gjerman, gjenezën e së cilës unë e kërkoj tek një ushqim ekskluzivisht me bazë gazetash, politike, birre dhe muzike vagneriane, pa harruar atë që është premisa e kësaj diete: para së gjithash, ekskluzivizmi dhe kapadaillëku kombëtar, parimi i fortë, por i ngushtë i "Deutschland Deutschland über alles"; dhe

mandej *paralysis agitans**** i “ideve moderne”). Evropa sot është e pasur me shpirt shpikës sidomos në fushën e stimulantëve, duket se për asgjë tjetër s’ka nevojë përpos që për eksitues dhe alkool: nga kjo rrjedh edhe falsifikimi i përbindshëm i idealeve, këto pije shumë të forta të shpirtit, nga kjo edhe ajri krupëndjellës, kutërbues, i rremë, pseudo-alkoolik, i pranishëm kudo. Do të doja të dija sa ngarkesa me imitime idealiste, me kostume heroike dhe me gjepura pompoze, sa fuçi me përdëllim të ëmbëlsuar alkoolik (firma: *la religion de la souffrance*),**** sa paterica “indinjate fisnike” në mbështetje të këtyre hafijeve të shpirtit, sa komedianë të idealit kristiano-moral duhet të eksportohen sot nga Evropa, në mënyrë që atmosfera e saj të kthehet e pastër... Është krejt e dukshme se, në lidhje me këtë mbiprodhim, çelen mundësi të reja *shkëmbimi*, është e qartë se me idhuj të vegjël ideali dhe me “idealistët” përkatës janë të mundshme “afera” të reja – mos e nënvlerësoni këtë ofertë të hapur! Kush ka guxim të mjaftueshëm për këtë? – është në *duart* tona, “të idealizojmë” të gjithë tokën!... Por përse të flasim për kurajë: këtu ka nevojë për një gjë të vetme, pra për një dorë, një dorë të lirë, një dorë shumë të lirë...

27.

– Mjaft! Mjaft! T’i braktisim këto kuriozitete dhe këto kompleksitete të shpirtit modern, që të shkaktojnë sa

*** Lat. paralizë me dridhje, e njohur sot me emrin sëmundja e Parkinsonit.

**** Fr.: feja e vuajtjes.

të qeshura aq edhe bezdi. Problemi *ynë* mund të bëjë pa to, problemi i *domethënies* së idealit asketik – çfarë ka të bëjë me të djeshmen dhe të sotmen! Këto çështje do t'i trajtoj në një kontekst tjetër në mënyrë shumë më të thelluar dhe më të vendosur (me titullin “Për një histori të nihilizmit evropian”; ju sugjeroj për këtë arsye një vepër që po përfundoj: *Vullneti për pushitetin, Sprovë për një shpërçmuarje të të gjitha vlerave*). E vetmja arsye pse e përmend këtu këtë gjë është se, edhe në sferën shpirtërore, ideali asketik ka gjithnjë, tani për tani, një lloj të vetëm armiqsh realë dhe *dëmtuesish*: pra komedianët, e idealit – pasiqë ata zgjojnë mosbesimin. Përndryshe, kudo që shpirti sot është në punë me seriozitet, me forcë dhe pa falsifikime, në përgjithësi, bën edhe pa këtë ideal (fjala popullore për këtë abstinencë është “ateizëm”) - *pa llogaritur vullnetin e saj për të vërtetën*. Por ky vullnet, ky kusur ideal, nëse doni të më besoni, është po ai ideal në formulimin e tij më të rreptë, më shpirtëror, absolutisht ezoterik, i çliruar nga çdo superstrukturë e jashtme, dhe prandaj jo dhe aq kusuri i tij, sesa *bërthama* e tij. Ateizmi i pakushtëzuar, i ndershëm (- dhe thithim vetëm ajrin e tij, ne njerëzit më spiritualë të kësaj ere) nuk qëndron, pra, në kundërshti me atë ideal, në atë masë sa ngjan ashtu; ai përkundrazi, është vetëm një nga fazat e tij të fundme të zhvillimit, një nga format e tij përfundimtare dhe nga rrjedhojat e tij të brendshme – është *katastrofa*, që ngjall respekt, e një edukimi të rreptë dymijëvjeçar me të vërtetën, që në fund ia ndalon vetes *gënjeshtrën e besimit te Zoti*. (E njëjta ecuri zhvillimi në Indi – në mënyrë krejt të pavarur,

e për pasojë në gjendje me vërtetue diçka – i njëjti ideal që çon tek i njëjti konkluzion; pika vendimtare është mbërritur pesë shekuj para erës evropiane, me Budën, ose më saktë me filozofinë Sankhiame që u përhap mandej nga Buda dhe u transformua mandej në fé.)

Çfarë, e shtroj si pyetje me rigorozitetin më të madh të mundshëm, ka *triumfuar* në të vërtetë, mbi Zotin e krishterë? Përgjigja gjendet tek *Shkenca gazmore*: “Vetë moraliteti i krishterë, koncepti i vërtetësisë i marrë në një kuptim gjithmonë e më rigoroz, finesa e etërve rrëfytes të ndërgjegjes kristiane, e përkthyer dhe e sublimuar në ndërgjegjen shkencore, në pastërtinë intelektuale me çdo çmim. Të vëzhgosh natyrën, si të ishte një provë e mirësisë dhe e mbrojtjes së një zoti; të interpretosh historinë në nderim të një arsyeje hyjnore, si dëshmi konstante e një rendimi etik të botës dhe e do qëllimeve etike përfundimtare; të interpretosh përvojat vetjake intime siç i kanë interpretuar mjaft gjatë njerëzit e devotshëm, a thua se gjithçka qenkësh një rendim, gjithçka qenkësh një shenjë, gjithçka qenkësh e sajuar dhe e paravendosur për dashurinë dhe për shpëtimin e shpirtit: gjithçka që tashmë *ka kaluar*, e ka ndërgjegjen *kundër* vetes, për të gjitha ndërgjegjet më të mprehta konsiderohet e pavend, e pandershme, e gënjeshtërt, muhabet femrash, dobësi dhe burracakëri; falë këtij rigoroziteti, në mos tjetër, ne jemi saktësisht evropiane të mirë dhe trashëgimtarë të tejkalimit më të gjatë dhe më të vlefshëm të Evropës” ... Të gjitha gjërat e mëdha asgjësohen vetë, me një *akt* vetë-eliminimi: kështu do ligji i natyrës, ligji i “vetë-tejkalimit” të ne-

vojshëm në esencën e jetës - britma "*patere legem, quam ipse tulisti*"* përfundon gjithmonë duke mbërritur vetë legjislatorin. Kështu ka rënë krishterimi *si dogmë*, për shkak të vetë moralit të tij; kështu edhe krishterimit *si moral* i mbetet të rrënohet - të rrënohemi ne - jemi në pragun e *kësaj* ngjarjeje. Pasi vërtetësia kristiane ka nxjerrë një përfundim pas tjetrit, do të nxjerrë në fund edhe *përfundimin e saj më radikal*, atë kundër vetes; por kjo ndodh kur ajo pyet veten "*cila është domethënia e çdo vullneti për të vërtetën?*"... Dhe në këtë moment e cek edhe njëherë problemin tim, problemet tona, miqtë e mi të *panjohur* (- meqë akoma nuk *di* ku kam ndonjë mik): ç'kuptim ka vallë e gjithë qenia *jonë*, nëse nuk do të thotë se brenda nesh ai vullnet për të vërtetën është bërë i ndërgjegjshëm për veten *si problem?*... Falë këtij vetë-ndërgjegjësimi të vullnetit për të vërtetën, morali - nuk ka asnjë dyshim - *do të përfundojë duke shkuar progresivisht në rrënim*: kjo është ajo shfaqje e madhe me njëqind akte, që u rezervohet dy shekujve evropianë që po vijnë, më e tmerrshmja, më problematikja dhe mbase edhe më shpresëdhënësja nga të gjithë shfaqjet...

28.

Nëse përjashtohet ideali asketik, atëherë njeriu, *kafsha* njeri, nuk ka pasur deri më sot asnjë kuptim. Ekzistenca e tij mbi tokë nuk ka pasur asnjë qëllim; "përse pra u dashka njeriu?" - ka qenë një pyetje pa përgjigje; *vullneti* për njeriun dhe tokën mungonte; pas çdo fati

***** Lat.: O atë përse hoqe dorë prej meje. (britma e Krishtit në kryq).

të madh njerëzor kumbonte, si refren një "më kot!" akoma më i madh. Ideali asketik nënkupton pikërisht këtë: se diçka *mungonte*, se njeriu ishte i rrethuar nga një *boshllëk* shumë i madh - ai nuk dinte të përligjte, të shpjegonte, të afirmonte veten, *vuante* për problemin e domethënies së vet - Vuante në gjithfarë mënyrash, madje ishte, në radhë të parë, një kafshë e *sëmurë*: amà problemi i tij nuk ishte *vetë* vuajtja, porse fakti se nuk kishte përgjigje për britmën e dhimbshme: "*përse me vujtë?*" Njeriu, kafsha më e guximshme dhe më e velur nga dhimbja, *nuk* e mohon vuajtjen në vetvete; e *do*, madje e kërkon, gjithë nëse i tregohet një *domethënie* e vetë vuajtjes, një "përse" i të vuajturit. Absurditeti i vuajtjes, *jo* vuajtja, ka qenë mallkimi që ka rënduar deri më sot mbi njerëzimin - *dhe ideali asketik i caktoi një kuptim!* Deri më sot ka qenë kuptimi i vetëm; një kuptim çfarëdo është më mirë se asnjë kuptim; nën çdo pikëvështrim, ideali asketik ka qenë "*faute de mieux*"* *par excellence* që ka ekzistuar ndonjëherë deri më sot. Tek ai, dhimbja *interpretohej*; boshllëku i pamasë u duk i mbushur; iu mbyll porta çdo nihilizmi vetëvrasës. Është jashtë çdo dyshimi se interpretimi solli me vete dhimbje të re, më të thellë, më intime, më toksike, më brejtëse për jetën: ai e vendosi çdo dhimbje në perspektivën e *fajit*... Por pavarësisht të gjitha këtyre - njeriu kështu u *shpëtua*, pati një *kuptim*, nuk qe më, duke filluar nga ai çast, një gjethe n'ërë, një shakà e absurdit, e "mos-kuptimit", tashmë mund të *donte* diçka - dhe sidomos nuk kishte rëndësi se në çfarë drejtimi, me cil-

* Fr.: Ajo që zgjedh në mungesë të diçkaje më mirë. Kur s'ke pulën ha sorrën, thotë populli.

indo qëllim, me cilindo mjet të donte: *vullneti vetë kishte shpëtuar*. Nuk mund të fshehim absolutisht se çfarë, realisht, e shpreh tërë këtë vullnet që e kishte nxjerrë nga ideali asketik linjën e tij: kjo urrejtje kundër njerëzores, akoma më tepër kundër asaj që është kafshërore, akoma më shumë kundër asaj që është lëndë, kjo lemeri e shqisave, për vetë arsyen, tmerri nga lumturia dhe bukuria, kjo dëshirë me dalë nga gjithë çka është paraqitje, mutacion, shndërrim, vdekje, dëshirë, nga vetë të dëshiruarit - e gjithë kjo do të thotë, guxojmë të bëhemi të vetëdijsëm - një *vullnet për hiçin*, një urrejtje ndaj jetës, megjithatë, është dhe mbetet një *vullnet!*... Dhe për të thënë, duke e përmbyllur, atë që kam thënë në fillim: njeriu do të dojë më mirë *hiçin*, sesa të mos dojë fare...

JETA E NIÇES MES VERËS SË 1886-ËS DHE VJESHITËS SË 1887ËS. 1886, *fund qershori - fund shtatori, Sils-Maria*

Pas një qëndrimi të shkurtër në Koira, Niçja e kalon verën në Sils-Maria. Shtypja e *Përtej së mirës dhe së keqes* ia zë kohën deri në fund të korrikut (për leximin e *bo-cave* e ndihmon, si gjithmonë, Gasti). Njohja me Helen Ciemern. Gastit: “Komike! mbrohu sa të duash kundër emancipimit femëror: prapë mbërriti deri tek unë një ekzemplar tipik femre të kulturuar, zonjusha Helen Ciemern (që i ka bërë të njohur Shopenhauerin anglezëve) – besoj madje se ka përkthyer veprën *Schopenhauer si eduktor*. Natyrisht hebreje: është e jashtëzakonshme, në ç’masë kjo racë e mban tani në duart e saj “spiritualitetin” evropian (sot më ka mbajtur gjatë me muhabet për racën e saj)” (5 korrik). Pas tratativash të zgjatura me Shmajcerin, Fricsh arrin t’i riblejë pjesën e mbetur të shkrimeve të Niçes (5 gusht). Del *Përtej së mirës dhe së keqes*. Overbekut: “Libri *i ri*, një rezultat që nga larg dukej i parritshëm, tani ka mbaruar: kërkesa për të të dërguar një kopje në Bazel është nisur prej do ditësh. Të lutem tani për diçka, mik i vjetër: lexoje, nga fillimi në fund, mos u zemëro dhe mos u largo prej meje – “mblidhi të gjitha forcat”, të gjitha forcat e dashamirësisë tënde për mua, e dashamirësisë tënde të durueshme dhe të provuar njëqind herë – nëse libri të duket i padurueshëm, megjithatë mbase nuk do të jenë të tillë njëqind *detaje* të tij! Mbase ai do të ndriçojë nja dy vende të *Zarathustrës* sim: ky është një libër i *pakuptueshëm* për faktin se buron nga përvoja mirëfilli të brendshme, që unë nuk i ndaj me asnjë.

Sikur të mundja të të jepja një ide të ndenjës sime të *vetmisë!* As mes të gjallëve as mes të *vdekurve* nuk gjej diçka me të cilën të ndihem i afërt. Kjo është mizore në mënyrë të papërshkrueshme; dhe vetëm ushtrimi në durimin e kësaj ndjenje qysh kur isha fëmijë ma bën të kuptueshëm faktin se unë nuk ka vdekur ende për këtë arsye. Veç të tjerash, detyra për të cilën jetoj është e qartë para meje – si një *factum* i trishtë në mënyrë të papërshkrueshme, por i shpërfiguruar nga ndërgjegjja se këtu ka *madhështi*, nëse është shoqëruar ndonjëherë ndonjë *madhështi* me detyrën e një të vdekuri” (5 gusht).

Niçja i dërgon Fricshit parathënien përkatëse të *Njerëzor, tepër njerëzor* dhe poezinë përkatëse mbyllëse (16 gusht). Veç kësaj Fricshi nxjerr në shitje tre pjesët e parë të *Kështu foli Zarathustra*, të lidhura së bashku. Më 29 gusht Niçja i dërgon Fricshit “Përçapjen për autokritikë”, për një botim të ri të *Lindjes së tragjedisë*. Fricshit: “Kjo “përpyetje”, bashkë me Parathënien për *Njerëzor, tepër njerëzor*, jep një ndriçim të vërtetë mbi mua – dhe përgatitjen më të mirë për *birin* tim guximtar *Zarathustrën*” (29 gusht). J. V. Vidman recenson *Përtej së mirës e së keqes* tek “Bund-i” i Bernës (16-17 shtator): “Ato ngarkesa me dinamit” thuhet tek recensionin “që u përdorën për të ndërtuar hekurudhën e Gotardit, qenë të sinjalizuara nga një flamur i zi, për të treguar rrezik vdekjeje. Vetëm në këtë kuptim flasim për librin e ri të filozofit Niçe si për një libër të *rrezikshëm*. Në këtë shenjim nuk ka hije qortimi kundrejt autorit dhe veprës së tij, sikundër ai flamur i zi nuk donte ta qortonte atë dinamit... Niçja është i pari që e njuh një rrugëdalje, por

është një rrugë kaq e frikshme sa vërtet të zë frika kur e sheh duke përshkuar shtegun e tij të vetmuar, të pashkelur deri më tash!...". Ndërkaq është gati edhe Parathënia ndaj vëllimit të dytë të *Njerëzor, tepër njerëzor*. Nënës: "Qielli pastë mëshirë për inteligjencën evropiane, gjithë nëse do njeri t'ia largojë inteligjencën hebraike! Më kanë treguar për një matematikan të ri nga Pontresina, që e ka humbur qetësinë e natës nga ngazëllimi dhe entuziazmi që i ka ngjallur libri im i fundit; kur unë i kërkova detaje më të mëdha, rezultoi se bëhej fjalë edhe një herë për një hebre (një gjerman nuk të lë ta shqetësosh në gjumë kaq lehtë)" (19 shtator).

Franc Listi kishte vdekur në Bajrojt më 31 korrik, Niçja i shkruan në lidhje me këtë Malvida fon Majzenbugut: «Kështu plaku List, që merrte erë nga jeta dhe vdekja, hyri në *dhé*, si të themi, në kauzën vagneriane dhe në botën e saj, si t'i përkiste në mënyrë të pandashme dhe të pandreqshme. Më vjen shumë keq për shpirtin e Kozi-mas: është një falsitet më tepër në faturën e Vagnerit, një nga ato keqkuptimet gati të pamposhtshme, mes të cilave sot lavdia e Vagnerit rritet dhe lëshon shumë gjethe. Duke gjykuar nga ajo që kam mësuar deri më tash mbi vagnerianët, vagnerizmi i sotëm më duket se i afrohet pa e vënë re Romës, çka së brendshmi është e njëjta gjë me atë që bën Bismarku së jashtmi" (24 shtator). Kah fundi i shtatorit Niçja largohet nga Sils-Maria i drejtuar në Gjenova.

Tetor, Gjenovë, Ruta Ligure

Niçja qëndron në Ruta së bashku me Paul Lanzkin (me

ekskursione në Gjenova dhe në vendet pranë bregut ligur). Mbi Rutan: "Majtas gjiri i Gjenovas deri tek fari; nën dritare dhe drejt maleve gjithçka është e gjelbër, ezmere, të kënaq syrin. Hoteli Italia është i pastër dhe i mobiluar për qejf: kuzhina është e *slipifur*: akoma s'kam mundur të shoh një kafshë mishi të hajrit. Aq më i çmueshëm është ajri i pastër dhe nuk t'i gërric nervat, sikundër shëtitjet lart mes dy deteve, një pyll pishash me një harlisje gati tropikale. Kemi ndezur deri më tani tre flakadanë: nuk ka asgjë më të bukur se të shohësh kah flakërojnë ndaj qiellit të pastër. Ka një vetmi si mbi një ishull të arkipelagut grek; përreth ka vargmale panumër» (Emili Finit, 2 tetor).

Përgjigje e rezervuar e Burkhardit në dërgimin e *Përtej së mirës dhe së keqes*. Overbekut: "Letra e Burkhardit, e mbërritur prej pak kohe, me trishtoi, megjithëse ishte plot me konsideratën më të madhe për mua. Por tani ç'rëndësi ka kjo?" Doja të dëgjoja "për këtë kam nevojë! më la pa fjalë!". Vetëm në këtë kuptim, miku im i vjetër Overbek, vuaj për "vetminë" time..." (12 tetor).

Niçja punon në parathëniet për botimet e reja të *Agut dhe Shkencës gazmore*. Fund tetori 1886 - fillim prilli 1887, Nisë

Rreth 22 tetorit Niçja është prapë në Nisë. Punon mbi librin e pestë të *Shkencës gazmore*. Fricshit: "Ja pra, para fundit të vitit do të kemi mbaruar gjithçka që kishte paracaktuar të bëja për të mirën e librave të mi të përparshëm. Gjëja e fundit - që po ju dërgoj si dorëshkrim

- është pjesa finale (pjesa e pestë) e *Shikencës gazmore*, që qe projektuar qysh në fillim dhe që atëherë nuk u plotësua për pasojë të një dobësie shëndeti fatale" (fund dhjetori 1886). Overbekut: "Letër e shkëlqyer e Henrisë [sic] Taine, që më merr aq seriozisht sa mund ta dëshiroj; ka një kulturë universale; pasazhet që sinjalizon janë një provë se sa mirë më kupton. Veç tjerash unë jam për të *infiniment suggestif*, dhe për sa i takon gjykimit tim kompleksiv mbi popujt evropianë dhe fuqitë e tyre, është krejt i magjepsur dhe premtan se do t'i shohë sërish këto pika. Ai bën pjesë tek tre lexuesit e mi që lexojnë mes rreshtave" (29 tetor).

Në "Zürcher Zeitung", H. Velti recenson *Përtej së mirës dhe së keqes*. Lexim i komentit të Simplitit dhe të Epiketitetit: "Tek ai vihet qartazi para syve tërë skema filozofike ku është brendashkruar krishterimi... Falsifikimi i gjithçkaje që është reale përmes moralit del këtu në dritë të plotë; psikologji për t'u dhimbsur; filozofi kantandiset në "famullitar fshati". Dhe për të gjitha këto fajtori është Platoni: ai mbetet më e madhja *malheur* i Evropës!" (Overbekut, më 9 janar 1887). Gastit Niçja i shkruan, në lidhje me meditimet e tij të kësaj periudhe: "Sulm i përgjithshëm kundër shkakësisë së tërë filozofisë së shkuar" (21 janar). Në Montekarlo dëgjon për herë të parë preludin e *Parsifalit*: "Vagneri, a kompozoi diçka më të bukur se kjo?" (Gastit, tek e njëjta letër). Niçja lexon Renanin, Sibelin, Montalembertin, dhe zbulon Dostojevskin. "Përpos Stendalit, askush nuk më ka shkaktuar kënaqësi e befasi më të madhe, ja një psikolog me të cilin merrem vesh" (Gastit, 13 shkurt).

Overbekut: “Këtë dimër lexova edhe *Origenes* të Renanit, me shumë ligësi e pak avantazh. E gjithë kjo histori shtetesh dhe *ndjenjash* të Azisë së Vogël më duket e ngrefur në ajër në mënyrë qesharake. Në fund mosbesimi im shtrihet deri tek pyetja nëse në përgjithësi është e mundshme historia. Çfarë dëshirohet të vendoset vallë? – diçka që në vetë çastin e ngjarjes nuk ishte e “fiksuar”?» (23 qershor 1887).

Tërmet në Rivierë: “Jetojmë në pritshmërinë interesante për të shkuar në djall, falë një tërmeti me qëllime të mira që i bën jo vetëm qentë të lehin sa gjerë gjatë» (Overbekut, 24 shkurt). Me bashkëpunimin e Gastit (që është në Venedik) mbaron në mars leximin e bocave të parathënies së *Shkencës gazmore* dhe të *Këngëve të princit Vogelfrei*.

Prill – mes qeshori, Kanobio, Zyrih, Koira, Lenz

Gjithnjë me ndihmën e Peter Gastit përkujdeset për shtypin e librit të pestë të *Shkencës gazmore*. Nga fillimi i majit është në Zyrih dhe sheh Overbekun. Gastit: “Vizita e Overbekut më bëri shumë mirë, pjesa tjetër është – Zyrihu”. 4 maj). Në maj nga Koira një letër prishjeje me Rohden. Frekuenton bibliotekën e Koiras. Lezit (Lenzer Hajde) kompozim i një fragmenti të gjatë mbi “nihilizmin evropian” (e masakruar pastaj nga Peter Gasti dhe Elisabeth Fërster-Niçja në të ashtuquajturën “Vullnet për pushtet”. Me gjasë fillimi i hartimit të *Gjenealogjisë së moralit*.

Mes qershori – fund shtatori, Sils-Maria

Më 12 qershor Niçja mbërrin në Sils-Maria. Mallëngjim për vdekjen e parakohshme të Hajnrih fon Shtajnit: “Një nga krejt të paktit *ekzistenca* e të cilit më ishte gëzim: edhe ai kishte shumë besim tek unë... Kjo ngjarje më dhemb kaq shumë sa vazhdoj të mos e besoj”. (Gastit, 27 qershor). Në korrik thërret nga tipografia dorëshkrimin e *Gjenealogjisë* për t’i bërë do ndryshime; më 30 korrik e ridërgon të korrigjuar në Lajpcig. Pas katërmbëdhjetë vitesh largësi, takim me mikun e rinisë Paul Dojsen dhe nusen e tij në Sils-Maria (shtator)”.

21 shtator – 21 tetor, Venedik

Pas një qëndrimi të shkurtër në Menaxho, në vizitë tek zonja Fin dhe e bija, mbërrin në Venedik, ku rri një muaj me Peter Gastin. Në këtë muaj mbaron shtypja e *Gjenealogjisë së moralit*. Iu dërgon miqve por edhe Hans fon Bylovit *Himnin për jetën*, “për kor të përzier e orkestër”, me fjalë nga Lu fon Salomeja; orkestrimi i kësaj vepre të Niçes është vepër e Peter Gastit: “Duhet të këndohet në ndonjë të ardhme të afërt ose të largët në kujtimin tim, në kujtim të një filozofi që nuk ka pasur dhe, me të vërtetë, as nuk ka dashur të ketë një të tashme”. (Hans fon Bylovit, 22 tetor).

1. Cit. Mateu, 6, 21.
2. Inversion i proverbit «gjithkush është për veten më i afërti» (cit. Terenci, Andria, IV, I, 12).

3. Cit. Goethe, Faust, tek Werke, Zürich, 1949, vëll. V, pjesa I.
4. Nietzsche kishte lexuar në atë kohë, tek biblioteka e Chur, Historinë e qytetërimit në Angli të Baklit; në lidhje me këtë i shkroi Gastit, më 20 maj 1887: «... çudi! doli që Bakli është një nga antagonistët e mi më të fortë».
5. Silas Weir Mitchell (1829-1914), mjek dhe shkrimtar amerikan.
6. Cit. Tukiditi, II, 41.
7. Cit. Tukiditi, II, 39.
8. Cit. Luka, 23, 34.
9. Cit. Mateu, 5, 44.
10. Cit. Letra Romakëve, 13, 1.
11. Cit. Homeri, Iliada, XVIII, 109.
12. Cit. Letra e parë Thesalonikasve, 3, 12.
13. Cit. Dante, Ferri, III, 5-6: «Vetë pushteti hyjnor më ka sajue, / Ma e larta dije, e para dashuni.» [Përkthimi klasik i P. Gjeçit.]
14. «Por ka akoma spektakle të tjera, në atë ditë të gjykimit, të mbramë e të përhershëm, atë ditë të papritur për popujt, atë ditë të përqeshur, kur nga një zjarr i vetëm do kapërdihen një ekzistencë kaq e gjatë e botës dhe gjithë ato breza të saj. Çfarë gjerësie do ketë atëherë spektakli! Ç' mrekulli do shoh! Për çfarë do qesh! Atje poshtë do shijoj! Atje poshtë do galdoj, duke vëzhguar gjithë ata mbretër të mëdhenj – që shpalleshin si të zgjedhur në qiell – tek ankohen në thellësi të errëta bashkë me vetë Jovin dhe me vetë spektatorët e tyre. Duke parë njësoj kryetarët, persekutues të emrit të Tënzot, që shkërmoqen ndër flakë më mizore se ato

me anë të të cilave i sulmuan me përtallje të krishterët! dhe veç kësaj ata filozofë diturakë, të përcëlluar nga zjarri para dishepujve që digjen bashkë me ta, dishepuj që qenë kandisur prej tyre se asgjë nuk i takon Zotit, dhe të cilëve u qenë dhënë prej tyre siguria se shpirtat nuk ekzistojnë ose se nuk do kthehen tek trupat fillimorë! Duke vëzhguar edhe poetët kah gufmojnë jo para tribunalit të Radamantit ose të Minosit, por para tribunalit të një Krishti të pamenduar! Atëbotë do dëgjohen më mirë tragjedianët, me zë më të qartë rreth fatkeqësive të tyre; atëbotë do njihen histrionët, të bërë shumë më të shkujdesur prej zjarrit; atëbotë do duhet fituar karroca, e gjitha zjarmuese në rrotën e përflakur, atëbotë do jenë për sehir atletët, teksa vërvisin shtizën jo në palestra, por në zjarr, veçse nuk do i doja as këto spektakle [duke lexuar visos në vend të vijos], pasi do preferoja të ofroj më mirë një vizion që të ketë të ngime për ata që bënë mizori kundër Zotit. “Ja,” do them “i biri i artizantit dhe i prostitutës, shkatërruesi i Sabatit, Samaritani, ai që ka demonin. Ja ai që bletë prej Judës, ja ai që u rrah me thupër e me grushte, që u turpërua me pështymje, të cilit iu dha për të pirë vrer dhe uthull. Ja ai që dishepujt e hoqën fshehurazi, në mënyrë që të thuhej se qe ringjallur, ose ai që një kopshtar e uli, që të mos i prisheshin marulet nga vajte-ardhjet e shumta të njerëzve që kalonin”. Të pamët e këtyre spektakleve, mundësinë për të galduar për këso gjërash, cili pretor a konsull a kuestor a oshënar do arrijë të ta japë me liberalitetin e tij? Dhe megjithatë këto gjëra, të revokuara nga imagjinata e shpirtit, në njëfarë mënyrë e zotërojmë sakaq nëpërmjet besimit. Fundja cilat janë

ato gjëra, që as syri s'i ka parë as veshi s'i ka dëgjuar as nuk janë ngritur në zemrën e njeriut? Besoj se janë më të pëlqyeshme se cirku, se skena komike dhe tragjike, dhe se gjithçka që shihet në stadiume».

15. Cit. Taciti, *Vjetaret*, XV, 44.
16. Cit. P. Mérimée, *Lettres à une inconnue*, Paris, 1874, vëll. I, f. 8.
17. Cit. E. Dühring, *Sache, Leben und Feinde*, Karlsruhe-Leipzig, 1882, f. 283.
18. Cit. J. Kohler, *Das chinesische Strafrecht. Ein Beitrag zur Universalgeschichte des Strafrechts* [E drejta penale kineze. Një kontribut për historinë universale të të drejtës penale], Würzburg, 1886.
19. Cit. Spinoza, *Ethica*, I, prop. 33. schol. 2.
20. Cit. Herakliti (Diels-Kranz), f. 52.
21. Cit. poezia *An den Mond* [Hënës], bot. cit., vëll. I, f. 71.
22. Cit. Homeri, *Odisea*, I, 32-33.
23. Cit. Stendhal, *Rome, Naples et Florence*, Paris, 1854, f. 30: «La beauté n'est jamais, ce me semble, qu'une promesse de bonheur».
24. Cit. H. Oldenberg, *Buddha. Sein Leben, seine Lehre, seine Gemeinde*, Berlin, 1881, f. 122.
25. Cit. H. Oldenberg, *po aty*, f. 124.
26. Cit. Luka, 10, 42.
27. Cit. P. Deussen, *Das System des Vedânta*, Leipzig, 1883; *Die Sûtras des Vedânta, aus dem Sanskrit übersetzt von P. Deussen*, Leipzig, 1887.
28. Cit. Platoni, *Republika*, 414 b-c («e ndershme» = γενναίον); 382 c; 389 b; 459 c-d; Ligjet, 663 e.

29. Cit. W. Gwinner,
A. Schopenhaueraus persönlichem Umgange
dargestellt, Leipzig, 1862.
30. Cit. a. W. Thayer, L. Van Beethoven's Leben,
Berlin, 1866 sgg.
31. U botua vetëm në 1911n, por Nietzsche e njihte
qysh në periudhë në Baselitsishtypje private, dhe
ai e ndihmoi edhe Vagnerin në korigjimin e
bocave (1868-1870).
32. Cit. J. Janssen, Geschichte des deutschen Volks
seit dem Mittelalter, Freiburg, 1877.
33. Cit. Gjoni, 18, 36.
34. Cit. Goethe, Gespräche mit Eckermann, bot.
cit., vëll. XXIV, ff. 718 sgg., 14 shkurt 1830:
«Goethe flet në vijim për Gozzi... Gozzi ka pasur
opinionin se ka vetëm tridhjetegjashtë situata
tragjike; Schilleri ka besuar se ka më tepër,
megjithëse nuk do kishte arritur kurrë të gjente
as tridhjetë e gjashtë».

Përmbjatja

Parathënie	4
Eseja e parë	15
Eseja e dytë	55
Eseja e tretë	106

VEPRA EZGJEDHUR 6 VEPRA EZGJEDHUR 6


1(430) "17" NIE



13441-10



ISBN 99956-52-77-7



9 789995 652777

1000 lekë / 10€